antologji poetike

LULËKUQET E LIRISË
- Çdo shesh një përmendore

dibran fylli

Shtëpia botuese
"Meshari"

Redaktor
Abdyl Kadolli

Recensentë
Namik Selmani
Rrustem Geci

Kopertina dhe disenji
Durim Fylli

Ilustrimet
Idriz Berisha

Radhitja kompjuterike
uniArtCreative

Shtypshkronja
"Lena Grafik",
Prishtinë, 2015

© autori

Antologji poetike

LULËKUQET E LIRISË

- Çdo shesh një përmendore

Botimet Meshari
Prishtinë,
2015

DËSHMORËT

...prushin e tingujve të këngës së pavdekshme
e ruajtën në bërthamën e shpirtit,
ata nuk i prek vaji i nënave
as rënkimi i etërve,
madhërisht rininë e tyre e mbyllën
në shtigjet e lirisë.

d. fylli



Naim Frashëri 1846-1900

Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin shqipëtar,
Zëmrën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.
*
Shqipëri, të qofsha falë!
Të kam mëm' e më ke djalë...

...me buzagaz burrëror përherë me pamje djaloshare...

Abdullah Konushevci 1958-2013

KUR VRITET BIRI I MADH

Fadil Tallës

Fytyra e tij e qeshur
më ndjek kudo

Pate acar të madh në zemër
Kur vemjet i mbushën rrugët
Ti dole dhe i talle bishat
Që hynin me nxitim në arenë
Zogj të hekurt
Na kërcënonin nga sipër
Kur i binim varrit
Dhe të kërkonim ndjesë
Për jetën e këputur
Ata nuk e dinin
Se ti na mësove ta tallim vdekjen
Ti që s'ishe as njëzet vjeç
Dhe ishe aq i madh

Të zije vend
Ndërmjet tokës e qiellit

DHE IKIM IKIM IKIM

Mbase ikim ikim ikim
Nga dhomat e mbushura ofshamë
Dhe dalim shesheve
Po sheshet janë të lara në gjak
Ndodh largohemi nga rrugët
Që klithin në fytyra fëmijësh
Dhe i mbyllim sytë
Kur Mezia i ngul ushtën
Demit tonë të Zi
Në Mozomazinë e përhumbur
Dheu na rrëshqet nën këmbë

SKICË PËR NJË ELEGJI

Ja
Kjo shtëpi
Ka një të vrarë
Dhe kjo këtu
Dhe kjo pranë saj
Dhe kjo tjetra
Dhe kjo dhe kjo dhe kjo
Ja
Dhe ajo shtëpi
Ka një të vrarë
Dhe ajo atje
Dhe ajo pranë saj
Dhe ajo tjetra
Dhe ajo dhe ajo dhe ajo

VJAZË A DJALË S`KA RËNDËSI

Në Karadak klith një zë fëmije
Nuk dihej se çfarë gjinie.
Vajzë a djalë s`kish rëndësi
E pagëzonin Liridon Liri.

Klithma e tij merrte malin
Në vesh të babait dëgjohej zëri,
Pushka kriste mbi Karadak
Babai i Liridonit a Lirisë merrte hak.

Qyqavica, Llapi e Drenica …
Tok u bashkuan
Me Agim Ramadanin
E thyen gurin, rrëzuan murin

Sali Çeku atdhetar
Në kolonë ishte i parë
Ai në Drenicë çonte armatim
Ushtarët mbusheshin plot frymëzim.

Kosova kallej flakë
Nënat lindnin fëmijë,
I pagëzonin me emra
Flakë, Liridon e Liri.

ZJARRET E DRENISË

Ç'janë këto zjarre dritë
Takim me yjet
Natën kallin flakë
Pushtimin hi.

Zjarr i Ahmet Delisë
Fushës së Arbërisë,
Kushtrim i Azemit
O prite-vrite heu!

Zjarr i Tahir Mehës
Çan rrethimin zi,
Flakë e Adem Jasharit
Drita UÇK !

Ç'janë këto zjarre flakë
Takim me yjet,
Zjarret e Lirisë
Fushës së Arbërisë.

TAHIR SINANI

Një hap në Tropojë
Një në Kosovë,
Tahir Gria
Ku i bie Arbëria?

Një hap në Pashtrik
Dy në Preshevë,
Mic Sokol
Shigjetën hedh.

Një hap në Tiranë
Tre në Tetovë,
Kufijtë e përgjakur
Mat me kokë.

Ku bie hapi, bie nami
Tahir Mal Sinani,
Kushtron Shqipëria
Ka burra Arbëria!

KAPEDANI I GALLAPIT

Ditën e Madhe del nga balada
Hyn në legjendën e kombit
Sy shqiponjë, krahë petriti
Kapedan Zahir Pajaziti.

Vrap e vrap
Jep kushtrimin
Edmondi, Hakifi...
Çanë rrethimin...

Madhështor përballë Grandit
Me kallash në dorë,
Koburen në brez
Lart emblemën UÇK.

Në Grand ngërdheshen horrat
Pinë uiski, luajnë me vota...

JEHUAN KODRAT E LLAUSHËS
Nuhi Gecit, Naser Lanit e Sadik Hazirajt

Mbi ato kodra lule plot
Pushka e trimave po vjell barot,
Plagët e vjetra bien përtokë
Naser Lani thërret, o shokë!

Tri pushkë të zjarrta për armikun
Naseri, Nuhiu me Sadikun,
Tre ushtarë që i deshi toka,
Lulevere çeli kodra.

AFISHJA E KATËRT E POETIT

O vargu im pusho vajin
pusho vajin se na qesh bota
Nuk do të mbetemi prore fëmijë
fëmijë që vetëm do të qajmë e ankohemi
Fluturo o vargu im
fluturo mbi kullat e Jasharajve në Prekaz
dhe lexo afishen e Sat Nokshiqit
Afishen e shkruar me gjak në borë

O Shaban Jashari ngrehu ore nga varri
se prapë po ta rrahin Drenicën
ngrehu ore nga varri
se prapë po t'i burgosin djelmoshat
O Hamzë Jashari ngrehe zërin o burrë
se Drenica është zënë në kërpnaja
se Drenica është pulitur
se Drenica ka humbur udhën në oborr të vet.

Drenica shpresonte se gjaku i saj
se gjaku i saj do të mbillte farën e lirisë
Drenica shpresonte
por shpresat e Drenicës sikur po davariten
O Adem Jashari ngrehu ore nga varri
Ngrehu nga varri e shiko rreth e rrotull
Shiko e fole një fjalë prej stralli
se më ka marrë malli
Por s'e di a dëgjohet ende fjala jote

Dardania e bukur me Drenicën në zemër
është bërë një livadh i shkretë
që e kullosin kuajt e verbër
ku hyjnë e dalin derri e dosa
ku kotet drapri e flen kosa

Ngrehuni ore nga varret
se kanë filluar
shumë hilexhinj e dallaverexhinj
të kullosin mbi varret tuaja
Mbi varret mbi varret mbi varret
Tung vargu im

AFISHJA E FUNDIT E POETIT

Tung vargu im
Shpejto hapin vargu im
Shpejto hapin dhe shko në Prizren
te Marashi te Marashi te Marashi
Gjeje rrapin gjeje rrapin gjeje rrapin
që poeti Sat Nokshiqi ka mbështjellë
me trëndafila shkronja-shkronja

O Prizreni im i bukur o perla e Kosovës
Për një ditë për një ditë
për të vetmen një ditë të lutem
leri harrnat leri pandlat
leri ckandlat leri drogat
leri skutat e zefkut leri modat
leri hokat leri rraqet leri hekurishtat
leri o Prizreni im i dashur dhe
kthe shikimin kah Kalaja

Kah Kalaja që na qëndron mbi kokë
kah kalaja Prizreni im

Ta marrim kalanë maje kodrës
ta marrim kalanë e bekuar
se nga kalaja do të shohim do të shohim
do të shohim Lubotenin
do të shohim Qyqavicën
do të shohim Berishën
do të shohim Bjeshkët e Jezercit
do të shohim Shalën e Bajgorën
do të shohim Zllashën
do të shohim Bjeshkët e Nemuna
e fushat e bekuara të Dukagjinit

Do të shohim Rugovën
do të shohim tërë Dardaninë
Do të shohim diturinë
do të shohim jetën
Do të shohim lirinë
do të shohim jetën
Do të shohim pasurinë
do të shohim Gjithësinë

Tung vargu im

NjË NËNË DHE NJË PËRMENDORE

Nuk mund të marr frymë
Kam dhembje shpirti
Shikimet e lodhura
Më shkasin nëpër njomësinë
E tejdukshme të bronzit.

Një nënë me një tufë lule mështekne
Qëndron e mpirë
S'lëvizin as qerpikët e erës
Vetëm shpirti i saj i madh
Ka një gjëmë të brendshme

Një nënë përballë jetës
I jetoi çastet
Më të lumtura të pleqërisë
Kur djali i saj
Duke trokitur në dyert e atdheut
Hyri në bronz.

Një nënë
Dhe një përmendore
E shkrirë në dashurinë e së nesërmes
Për çdo ditë te sheshi i lirisë
Bisedojnë
Me pëllumbat që s'flasin.

HAPAT E MI PREJ UJI
Meditim i një luftëtari

Po vij
Nëpër një vig tejet të rrezikshëm
Unë jam nisur
Gjendem diku në rrugë
Hapat e mi prej uji vrapojnë
Kah e nesërmja.

Unë domosdo do të kthehem
Ju nuk dini
Por u përngjaj zogjve dykrenorë
Atje ku ndërtova çerdhen
Do ta hap edhe varrin tim
Dua të vdes në atdhe.

Unë do të vij
Sërish do kthehem
Në dhembjen dhe vajin tënd,
Betohem se do të vij një ditë
Sërish do jem me ty
Atdheu im i çmuar.

RRI ME VARGJE DRENICE
Bacë Ademit

Në natën e zjarreve
Bëhem zjarr
Atdheu
E varg për miken.

Shkruaj
Për Kullën e Prekazit
"Bac, u krye!"

Sot jam ushtari yt
Nesër nuk di ku do të jem,

Në cilin cep atdheu
Do të shkruaj,
"Bac u krye!"

Sonte
Shkruaj për ty
Biri im gjeneral,
Të vesha me flamurin
Kuqezi.

Sot u bëre burrë
O sot, o kurrë
Për Atdhe e liri

Njëqind herë
Do të vdisnim
Për t`u bërë Drenicë
Kosovë e Shqipëri.

Sonte u bëra varg Drenice
Shkruaj për fatin tim
Kur kënga
U bë kushtrim
Jetë e liri.

Nesër
A do të lindin nënat
Çdoherë heronj
Për këtë tokë?

Për sa të jemi
Të vetmit zot
E Kastriot
Mbi këtë dhe
Përherë jemi
Denbabaden.

Para Krishtit
Është Itaka ime.

EMËR LIRIE
Kolë Mirditës

Ta them me një emër
Liri, o fjalë e tokës ilire.
Çdo fjalë e ruaj për ty dëshmori im
Të vetmen uratë e mbaj kujtim.

Kur pranverat të sollën aromë lulesh
Sa i deshe se janë aromë kose e malësorëve
Si dielli i nënës rritur të kanë këto këngë,
Shqip më thuaj, dashurinë për cilën mike ma fale
Për cilin atdhe e puthe si kujtim për besë e fe e atdhe?

Eh, si ecnim bashkë me pulëbardhat e detit
Me shqipet fluturuam nëpër secilin cep atdheu
Kaluam gjithandej atdheut e luteshim për uratën
Një ditë të bjerë vetëm shi,edhe shi ëndrrash.

Sa bukur tani rrimë së bashku pranë lapidarit tënd të lirisë
Jemi bërë të dytë lule edhe aromë lirie e dashurie.
Për secilën mike, për secilin vëlla çam sot kam mall
Sot po udhëtoj pak më ndryshe se ti dëshmori im.

Rruga e kombit tani të pret në supet e mia, në sytë tuaj
Ecim të dytë dritës që na bashkove vetëm për një çast.

Agim Ramadani 1963-1999

DIÇKA E NËMUR PARA BJESHKËVE

Le të shkrihet terri kur marshojmë drejt majës
Duke hapur shtigje në bjeshkë e në shpirt
Pranvera e djegur zgjohet në vargun e Nëntorit të tretë
Me plumb filluam nokturno të shkruajmë
Për gjymtyrët e mbetura në fushëbeteja me ujin e ashtit tonë
Për kohën e Skënderbeut e shuajmë etjen
Trimëria në kulmin e ëndrrave hëna u flakëron
Lartësia e mendimit tejkalon breshëritë e plumbave
Kokrrat e mëdyshjes kaherë u bluan
Ndërmjet shtëpive të kallura të Dukagjinit fusha të minuara
Në kurriz fëmije bërrylat e kohës thyhen
Dridhet gëzhoja e lëbyrur e mendimit
Para bjeshkëve të bekuara diçka e nëmur po fshihej.

KUR TË KTHEHEM

Kur të kthehem
Asgjë nuk do të jetë
Siç ishte më parë

Kur të kthehem
Sa do të jem i vetes
Nuk e di
Qentë e lagjes
Në mua do vërsulen
S'do të më njohë askush
Njerëz tjerë do të jenë
Njerëz të gjakut tim

Kur të kthehen
Edhe unë do të jem ndoshta
Një jetë tjetër.

NË MUNGESËN TIME

Tani unë jam hi dhe hije nuk kam
Se kam ndërruar jetë askush nuk e di
Më kërkojnë pyesin ku kam mbetur
Në trupin tënd të brishtë jam shkrirë
Nuk jam tretur

Mars, 1994

LIRIA

M'u shtershin sytë nëse pushoj
Lirinë tënde me ëndërrue,
mallkue qoftë gjaku im
nëse m'vrasin pa luftue.

1996

BALADË LIRIE E KOSOVËS

Posi nga zër' i perëndive
u zgjua kontinenti plak.
Nga cili akt i tragjedive
sot mbi Kosovë kulloi kaq gjak?!
Në ç'kontinent jeton kështu
një popull si mbi rjedhë ujëvare?!
Foshnjat, kaq breza, qiellin blu
e shohin mbi helmetat sllave.
Dhe sot i vranë në prag shtëpie, -
nga tym i predhës u thinj Zoti.
Te syr' i nxjerrë i një fëmije
përmbys po rrotullohet globi.
Prindi puth baltën e varrezës;
qirinjtë luten në pak dritë.
Nëpër çdo rrudhë të Nënë Terezës
rrjedhë lot i nënave për bijtë.
Të vrarë, burrat heshtur flenë
me qiellin e vet mbuluar.
Kapaku i syve u ka rënë
si perde drame e pambaruar.
Te trolli i vet ku shtrijnë shtatin
dëgjojnë…poshtë thellësive
mermerët pelazgjikë u flasin
me emrat e të gjithë ilirëve.
«Dhia» mbi kokën e Lahutës
thërret nga larg mitologjinë :
«Homer, ç'Iliadë me gjëmë të luftës
ke lënë bosh për Dardaninë»?
Nipat e Mujit vrarë mbrëmë

po pëshpërijnë me buzë të ngrirë
(nuk i dëgjuan sa qenë më këmbë,
le t'i dëgjojnë sot të shtrirë) !
Pa frymë hapësirat ngelin.
Gjaku i foshnjës sipër bore
te gjum' i bardhë i Azem Shkrelit
ka ngrirë rubin prej metafore.
Jehoi bubullima malit,
pylli kurorën butë e uli :
Azem Galica ka nxjerrë ballin,
thërret nga larg me zë Herkuli.
Lëviz një breg, drithmon një fushë
e mërmërin një këngë të lashtë :
«Drenicë, e bukura drenushë,
kush po guxon të të vret kaq gjatë»!?
Shota vështron si dritë nga retë
motrën e saj mbi gjak lirie,
këput ylberin nga një bjeshkë
t'ia vërë kurorë nusërie.
Varr i Gjolekës rënë mes trimave
u kumbon pranë-polifoni :
«Kosovë, Labëria ime
udhën një hap e ka tek ti»!
Fishta me dhembjen e pafjetur
për shkjaun-shkja e fisin-fis,
me rapsoditë e tij nën sqetull
del nga një mriz, hyn te një plis.
Këndon lahutë vdekjet e bardha
me ligjërimet e mëdha.
Varur te lisi Sefë Kosharja
tundet pendyl: “Ora ka ra”!..
Ajkuna po ia vazhdon gjëmës

me flokë shkulur pranë të vrarëve:
Fëmija prerë në bark të nënës
bën gjumë nën dhè brenda dy varreve.
Hasan Prishtina zgjoi Veriun.
Vdekjen e tij e lë në hije:
s'sheh më pas vetes kush i shtiu,
vështron Drenicën – kush i shtie!
Kosova, muhaxhire e shekullit,
sheh qiellin e saj të prerë:
te reja e zezë që i derdh breshrin
nxin fraku i zi i zotit Grej.
Rizgjohen fjalët e mëdha
të Abdyl Frashërit profet:
Me gjak shqiptarësh në çdo krah,
Ballkani rri përmbi tërmet !
Gjer kur, Kosovë e Çamëri,
ngarkuar në sup pragun e portës,
do lidhni djepet n'arrati
me meridianët e gjithë botës!?
Në ballë të kombit bërë theror
iu kthye bubullimë heshtja:
gjersa po vdesim orë për orë,
pas vdekjes s'gjendet vetëm vdekja!
Në shkumën e ujëvarës sate
që tundi kombin sot nga rrënja
partitë e shkrehura po zgjaten
të mbushin "bateritë" e rëna.
Mbi plagë të tua tejendanë,
zinxhir i zgjatur – thikë në shpinë,
nxin kontrabandë e shtetit amë
që lidhi Beograd – Athinë.

Tërë hijeshi mban zi për vdekjet,
për vajzat që t'i veshi zia…
(Atdheu – amë, nën këngët greke
feston aheng "Miss Albania")!
Ti gjak virgjin i racës sonë,
në duel me çdo mbretëri:
sa vriteshe në Fushë-Kosovë
ringjalleshe në Çamëri.
Ti, më e denja e të parëve,
ti – më e hijshmja në rritje,
me „Shqipëri" në frymëmarje,
me bukuri në kryengritje.
Djepet – dafina mbi alarme,
dasmat – ylberë mes rrebeshit;
mbi kodrat, lulet e bajames
çelin pranë kokrrave të breshrit.
Dardane mbirë prej legjendës,
rilind te shtat' i lartë i bijve;
nga kumbonarja e xhubletës
të kumbon bronzi i lirive.
Sa ke ushqyer zogjtë e pulës,
mendon një këngë për shqiponjat.
Zhurmat e tankeve pranë udhës
shpejtojnë lindjet te lehonat.
Me besën në pëllëmbë të dorës,
dafinë e parë e Lirisë,
Flamuri në ballkon të Vlorës
armët e tua pati shtizë.
Ti i dhe botës Kostandinin,
Ti që ke nxjerrë Niketë Dardanin,
në ballë – me Hymn të Krishterimit,
nën këmbë, prangat e tiranit.

Prill 1998

LIRIA

... se njeriu qenka një pleh
e liria lule...

Mbiu si një lule erëmirë
Erdhi si një ëndërr e bardhë.
Ajo që aq shumë e pritëm
E ujitëm me lot e gjak.

Nga dritë e saj na u morën sytë.
Zemrat gufuan, u bënë mal.
Flamuri i kuq sakaq në shtizë
Skuqi si asnjëherë më parë.

Emrin e saj Pol Elyari
E shkroi në tokë e në qiell.
Në gjoks si medaljon e vari
Adem Jashari zemërdiell.

Erdhi si një puhizë e lehtë
Përftoi prajshëm si një përrallë.
Ne që dikur digjeshim për të
U sulëm kush më shumë të marrë.

Nga dritë e saj na u lëbyrën sytë.
Zemrat gufuan, u bënë mal.
Flamuri kuq e zi në shtizë
Skuqi si asnjëherë më parë.

VDEKJA E LUFTËTARIT

Thonë se ndërsa po vdiste
nga plagët e marra në fushëbetejë
diku rrëzë Çiçavicës
komandanti Fehmi Lladrovci
paskësh thënë veç një fjalë:

Po shkoj te Ademi. Te Adem Jashari!
Dhe paskësh mbyllur sytë i qetë,
siç i ka hije një luftëtari.

Lamtumirë Fehmi!
Lamtumirë Adem!
Lamtumirë kapedanë!
Me ju Kosova u bind se kishte bij,
me ju e ndjeu veten Nanë!

Nëntor 1998

GRYKË E KAÇANIKUT
MBULUAR ME BORË

Grykë e Kaçanikut mbuluar me borë
Lepenci zvarritet si gjarpër i hollë.

Rrugës patrullojnë uniforma blu,
Me helmetë në sy e helm gjithashtu.

Shtëpizat në shpat pa fjolla tymi,
As borë e bardhë s'e fsheh dot krimin.

Grykë e Kaçanikut mbuluar me borë,
Lart bjeshkës së sharrtë sogjon një grykëhollë.

18 mars 1999

MES DËSHMORËVE TË KOMBIT

Në shtjellën e moteve të shkuara në histori,
moteve shekuj, shekujve mijëvjeçarë,
klithma e shqipes thërret përtej në lashtësi
kohët e moçme të mbretërve pellazgë.

Në shtjellën e moteve të shkuara me vrik,
moteve me kaq shumë plagë, me kaq shumë gjak,
shquan përkrenarja e fiseve të mi ilirikë
ndër luftëra të rrepta, ngritur mbi barbarë.

Në shtjellën e moteve që shkuan mot pas motit
në ato mote ditëndritur, mote të Arbrit trim,
valon pa u ndalur flamuri i Kastriotit
shqiponjë e zezë larë në gjakun sublim.

Në shtjellën e moteve që sollën furtunë dhe stuhi
moteve shqip, moteve ku ranë aq shumë për liri,
zbret në Vlorën e bekuar prej zotit në amshim
ky flamuri ynë, simboli ynë kuqezi!

KOSOVË, LULE GJAKU

Një lule gjaku pikon therorinë e shekujve që shkuan,
barbarinë dhe kohët tinëzare që e shkelën,
atje mes shkreptimës me erë të borës së zbardhuar,
tek gjurmët e bijve, mbetur mes legjendës.

Një lulëkuqe çel në thëllimin e parë,
një shqiponjë horizontesh klithmon lartësish
për kohën e madhe të lirisë fituar me gjak
dhe ëndrrat e burrave trima dhe martirë.

Kosovë, lule gjaku, si më je mes thëllimit,
shtatore e ngritur në qiej perëndish,
baladë e dhimbjes dhe zemrës së trimit,
këngërimë e shpresës dhe fatet e bijve të lirë.

Kosovë, plagë e hapur, shqiptari
djegur zjarr, fushëbetejë prore ti...
djep përkundur rreth kreshnikësh syzjarri,
krenari, lule gjaku që pikon historinë!

AMANETI I ÇLIRIMTARIT
Gjeneral Jashar Salihut

Në vitet pesëdhjetë populli lëngonte
Nga hekura robërie
E toka arbërore shkelej
Nga çizme e egër barbarie
Vritej e dëbohej
Nga trojet e lashta ilire
Djepet rënkonin për ninulla lirie.

Mbi Malësinë e Gjakovës
Doli ylberi me ngjyra
Ndriçoi Rekën e Keqe
Bjeshkët e Nemuna praroi
Në Batushë lindi Jashar Salihu
Edhe djepet kënduan.

U rrit me dashurinë
Për ta parë mëmëdheun e lirë
Asnjëherë s`iu bind
Regjimit të egër serbobarbar
Idealin për atdhe e pat amanet
E mbrojti si çlirimtar.

BALLË PËR BALLË ME TOKËN

Dasmë Shkurti
Ngrin e ndez dej
Me ashkun e mbledhur
Ndër shekuj,
Tek të sjell
Përballë meje, Nuse
Mbuluar nën Vellon
E përbiruar
Mes për mes palcës
Së gjakut tim
Dhe ndërron ngjyrë
Ndërron pamje.

(Le të më falin hyjnitë
Le të më ndjejnë besimtarët).

Unë të dua
Të tërën,
Të bukurën
Si dikur.

Pas të vjen
Pako e së qëndisurës pajë
Ndër mote e mote.
Dhe s'kam
Si të mos pyetëm -
Thua vallë
Brenda saj
Të jenë të gjitha:
Ofshamat e nënave,
Ëndrrat e të rënëve,
Dasmat pa këngë,
Vdekjet pa vaje!?

Të jetë aty
Ai, Gjindi i përrallave tona
I ndrydhur me shekuj!?

(Oh, prapë
Le të më falin hyjnitë,
Le të më ndjejnë besimtarët!)

Ja që të dua
Njësoj si dikur,
Të tërën
Të bukurën.

Me qindra herë
Dhëmbë ukju m'u ngulën
Pabesisht në shpinë
E prapë qëndrova.
Me qindra herë
Ndërkëmbëz tinëzare
Më rrëzoi përtokë
E prapë u ngrita.
Acar akulli siberian
Më shpoi
Tejpërtej trupit,
Po
Prapë gjallë mbeta.

Se të dua, të dua moj
Të tërën,
Të bukurën
Si dikur.

(Edhe një herë
Le të më falin hyjnitë,
Le të më ndjejnë besimtarët).

(17 shkurt 2008)

KITARA

Fshiva avullin e xhamit që më rrethonte
Para meje u shfaq honi i gërmadhës.

Hoqa pambukun në veshë
Dëgjova këngën e qyqes në degë.

Dola nga mbretëria ime e xhamtë
Dhe kërkova kitarën që humba dikur.

Kitara ishte pranë një peme të zhveshur
Duke vajtuar gjëmën e gjetheve të rëna.

1999

GJEMBA SHEKULLI
Ukshin Hotit

Emrin tënd enigmë
Dheu nuk e tret

I ndarë nga muri me grila
Përjeton fatin e vet

Tjetërsohet fat- njeriu
Nga histori e gjembosur

Enigmë mbeti
Vendndodhja jote e njohur

E pashëruara plagë Dardani.

NË MES TË KUFIJVE
Artan Abazit

Një zemër mal
Etjen e kësaj toke shuan me gjak

Deri në pikë të fundit
Bishat nuk ngopen dot

Eshtrat thurin barrikadë
S'ka hyrje - dalje për kobzinjtë

Emri yt qëndron krenar në lindje
Epitafi mbron kufirin në perëndim
Në mes kufijve ruhen kujtimet

Plejadë pavdekësie...

SHTEGTIM PËRJETËSIE
Bekim Berishës-Abesë

Abeja merr ngjyrë diellore
Shtegtimit nëpër Bardh
Rrugës së Mic Sokolit
Në horizontin ngjyrë all.

Abeja
Merr vrull tajfuni
Kullat oshtijnë shpateve,
Një krah shtrin në Tiranë
Tjetrin hedh në Prishtinë.

Kokën mbështet në Kosmaç
Me këmbë kufirin shkel,
Ç'është ky gur mes nesh
Europë he dreq!

AMANETI I SHOKËVE
Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës

Të dashuruar pas rrezes së diellit
Në udhën e rrahur ndër shekuj
Ranë shokët tanë,
Vdekjen me vdekje e mundën
Ditë e natë pranë nesh qëndrojnë
Si yje që nuk shuhen kurrë.
Nderim e lavdi
Ata paçin përjetë
Se amanet na lanë:
Gjakun
Kurrë të mos na ndalet hovi rinor,
Gjuhën
Zemrat të na zbutë e të na forcojë,
Sytë
Horizonteve ta hedhim vështrimin,
Këmbët
Hapin ta kemi të gatshëm për marshim,
Grushtin
Shtrigat t'i shkallmojmë,
Krahët
Agimet e kuqërremta t'i përqafojmë,
Zemrën, oh zemrën,
Kambanë për ditën e madhe.
Heu, kush shkel mbi gjakun e tyre,
Dritë e diellit e verboftë,
Mallkimi i tokës nënë e zëntë!

DËSHMORËVE
Arben Xheladinit dhe Mon Balës

Ata “kanë të drejtë”
Ta ndrydhin vullnetin e popullit.
Ata “kanë të drejtë” të hedhin
Gaz lotsjellës.
Ata “kanë të drejtë”
Të godasin.
Ata “kanë të drejtë”
Të vrasin.
Por populli ka një të drejtë:
T'i rrëzojë ata,
Që e nëpërkëmbin!

SHABAN PALLUZHA

Për një valëvitje flamuri
Gjoksin
Në teh kose e mbështete.
Për një besë burri
Me trimat
Flakë u bëre,
Dritë që s'shuhesh kurrë.
Për një pikë uji,
Për një kore buke
Larë në rreze dielli.
- Plaç o jetë -
Vdekjen e përqafove!
I çmendur nuk ishe,
Me urrejtje robërie,
Me dashuri lirie
Shtatëdhjetë e katër pranvera,
Shtatëdhjetë e katër dimra
I shkrive në përjetësi.
Kush ta përbuzi ëndrrën,
Pa shpresë,
Pa dashuri mbeti,
Peshën e gurit në qafë,
Vargonjtë në këmbë e në duar
Dhe shpirtin e vrarë
Për hise i mori.

Bahri Fazliu 1971-1998

PARA DËSHMORIT

Nëse te dëshmori shohim
vetëm të kaluarën e tij,
ne s'e kemi parë dëshmorin,
por kornizën që e rrethon.
Nëse te dëshmori nuk kemi parë të ardhmen,
ne s'e kemi parë dëshmorin,
por një kufomë.

S'MUND TË NDAHEM NGA LUFTA

Me gjithë mallin që kam për ty, nënë,
me gjithë dhembjen që ke për mua
me gjithë dëshirën që kam për jetë
megjithëqë një vajzë shumë e dua.

Megjithëqë më pëlqen stina e pranverës
megjithëqë dua paqen në botë,
megjithëqë më pëlqen të nxehtët e verës,
megjithëqë me dëshirë do t'rrija mbi tokë.

S'mund të ndahem nga lufta kurrë
S'mund të pajtohem me paqen-robëri
"pashë më pashë do t'i bie ferrit"
për të shtrenjtën tonë liri.

Edhe vdekjen do ta puth,nënë,
kur lufta këtë do ta kërkojë,
edhe nga varri do të ngrihem
luftën kurrë s'do ta pushoj.

TË GJALLËVE

Nëse dëshironi të dini për jetën e dëshmorëve,
mos kërkoni nëpër libra,
aty s'është jeta e tyre,është jehona e saj.

Nëse dëshironi të dini si jetuan dëshmorët,
mos shkoni në shtëpitë e tyre
shikoni robërinë tuaj.

Nëse dëshironi të dini me sa zjarr dashuruan dëshmorët,
mos ndiqni gjurmët e dashurisë së tyre,
ato janë flutura që s'kapen dot.

Nëse dëshironi të dini këngën e dëshmorëve,
mos thërrisni këngëtarin
do të pendoheni nga tingujt e zbrazët.

Nëse dëshironi të dini amanetin e dëshmorëve,
mos pyesni kë kishin afër në çastin e fundit,
secili prej nesh ka qenë prezent.

Nëse dëshironi t'i nderoni dëshmorët,
mos shkoni te varret e tyre për të vendosur lule,
lulet do t'u vyshken në dorë.

Nëse...
Çdo gjë që u intereson të dini për dëshmorët,
ecni në rrugën e tyre,
aty do të gjeni gjeninë e tyre.

PËRBETIMI

Oj Drenicë me fusha e gropa
Kurrë s'durove lot e robëri,
Barbaria të qëllojë me topa
Bijtë e tu të thurën lavdi.

Ky Prekazi i Prekë Kuçit
Hanedan gurrë e trimërisë,
Bacalokët në kullë prej Tuçit
Përtërinë veprën e Ahmet Delisë.

Ballë oxhakut Shaban Jashari
Flet me zemër e po bën be,
Na erdhi dita për së mbari
Ta bëjmë vdekjen si me le!

Hamza në qoshe dredh mustakun
Dhe me turr jashtë po mësyn
Me bombë n'dhëmbë ndaloka tankun
Në gjoks granatat po i shkrin.

Adem trimi një djalë dragua
Ia thotë këngës me piskamë,
Gjakatarët u tmerruan
Nuk i zinte as dera në lamë.

Tri herë doli jashtë rrethimit
Porsi shqipja me krahë të lehtë,
Sa ia ndiente pushkën Kushtrimit
Sërish kthehej në folenë e vet.

Tym e flakë ngrihen në qiell
Përplot gjak na u mbush fusha,
S'dukej hënë e s'dukej diell
Pushoi kënga, u ndal pushka.

U zbardh koka e Qyqavicës
Bari i njomë u nxi nga dheu,
Foli busti i Azem Galicës:
Të lidhim besë si Skënderbeu!

Të gjithë tok të përbetuar
Përmbi varret e lavdisë,
Të ecim rrugës së trasuar
Nga Luftëtarët e LIRISË !

BALADË BASHKËKOHORE
Për Nasimi Elshanin

Sonte
S'di nëna kë ta shikojë në sy
Nusen
Djalin a
Ty?
Ike pa më pyetur
U ktheve për të më treguar si ndodhi,
Pashë
Bashkëjetesa ç'polli!
Tani
Do të ikësh përsëri
Diku,
Ndoshta
Strehim për të gjetur.

Djali do të mbetet
Pa mësuar emrin tënd,
Xhelozia do t'i shtohet
Për fjalën,
Për këngën,
Do t'i shtohet dashuria
Për babanë,
Për nënën.
Sonte
Nëna s'mban zi
Ju kam të gjithëve këtu
(në zemër)
Nusen,
Djalin,
Ty.

EPIGRAM PËR NJË ELEGJI
Për të rënët në Brezftohtë

Me flamur i mbështollëm
T'ua ngrohte plagët,
T'ua ruante shpresat,
T'ua mbronte trupin
Nga rrezatimi shovinist

IDENTITETI
Me Drenicën, Prishtinën dhe Adem Jasharin

Dil Kosovë, dil moj Nënë
Erdhi Komandanti
Te Flamuri Kuqezi,
Mirë se vjen Adem Jashari
Për Atdhe, për Pavarësi!

Jam Ai që Jam
Gjak i gurit
Pishë në Shkëmb,
Me të pavërtetën
Nuk ha as nuk pi
Unë Feniks i Ri.

Jam ai që Jam
Zemërgur, kala Jam
Të zezën Natë
E shitova me Shpatë,
Ashti im nuk është i thatë.

Po hyn në Kullë Komandanti
Gur i Trollit gjak po qet...
Me grykë flet Drenica:
Dheu i Kombit testament,
Me diell e hënë u zgjua Prishtina...

Jam ai që Jam
Pancir nuk kam
Kmishëbardhë jam
Trupin plot plagë e kam
Në durimin e zi...
Unë Kuq pi...

Me djep në shpinë e merr Drenica
Gjeneralin si vetëtimë,
Mirë se të gjeta i thonë Djepit
Babë Shabani e Djalë Hamza
Amaneti përkund veç trima.

Jam ai që Jam
Me kokë e duar
Ndërtova urë...
Mortin e mbështeta për mur
E munda terrin e ferrin
Me Grykëhollë e me Shpatë
Gjarprit ia nxora vrerin.

Dëgjonin Pal Hasi, Mark Boçari
Ballshaj i Shkodrës, Bogdani i Dardhanisë...
Ashti i moçëm, kulla me njëzet e tetë frëngji
Dielli dhe hëna, kroi e Ara me dardha,
Hamshorët hingëllonin në terrin e zi
Drangojtë mbi rrembat e reve fluturonin...

Kohë e minjve, Komandant
Çmendurisht fryjnë erërat
Lëmsha-lëmsha derdhen mbi Drenicë
Trupojnë edhe mbi Prishtinë.
Ata që luajnë valle me të ndjerët
Do të vdesin dhe do të harrohen,
Me miza kali do të zhegohen,

Po, vëlla Komandant
Lisit tonë po i fryjnë
Plasa e gurit gjak po pikon
Nëna djepin po bekon
Po prehen vetëtimat mbi ballin tonë.

Jam ai që Jam
Pip i cungut jam
Rrënjët në tokë i kam,
Plisin e bardhë mbi kokë
Diellin vëlla, hënën motër kam.

Po lukuni e ujqish
Ujqit e zinj, Komandant
Po hungurojnë rreth Kulle
Duan të hyjnë në oborr,
Po venerojnë Arën
Po dëmtojnë Farën
Po duan Lisin e Ballit tim.

Vëlla, o i Lumi Vëlla
Vetullat po më flakërojnë,
O Degë e Dorës sonë
O gejzer i syve tanë,
Ujqit nuk durohen në Arë,
As të Dera e Oborrit tonë.

Kosova, o vëlla, është e lashtë dhe jeton
Nuk është e vërtetë se ata që shkuan
Nuk do të kthen më, nuk është e vërtetë,
Nëna dhe motra e vetme
Janë duke pritur
Karroca e bardhë do t'i kthejë Ata
Dhe nuk do të largohen kurrë më.

Zgjohu Tivar, ngrihu Boçar,
Mbaje krahun Plavë e Guci,
Pi ujë në Detin Jon Pellagoni,
Mirë se erdhe Komandant në Çamëri!

Bilal Xhaferri 1935-1986

KOSOVA

Kosova
Me ndarje dhe nënndarje gjeografike
Me ndarje dhe nëndarje historike
Kosova
Që nga ujërat e kulluara të Ohrit
Deri ne errësirën e minierave të Mitrovicës
Që nga brigjet e kaltra të Ulqinit
Deri në Qelekullën e në fushën e Nishit
Kosova
Fushë e begatshme me fruta e grunore
Që bie erë pranverës e tëra lule molle
Kosova me male kreshnike
Male të zhveshur me pisha e bredhishte
Që e rrahin qiellin me krahë shqipesh
Që e dehin diellin me aromë rrëshire
Që e ndezin qiellin me zbardhëllimë dëbore

Kosova
Krahine shqiptare që në fillim të saj
Tokë e Manastirit
E Prizerenit, e Plavës dhe e Gucisë
Tokë e legjendave legjendare të Gjergj Elez Alisë
Kosova
Legjendë e mbetur në rrugëkryq të historisë
Kosova
Gjithnjë ashtu si gjithnjë
Me dhëmbë të shtrënguar e me shpirt ndër dhëmbë
Kosova
Ku shqiptarët flasin një gjuhë dhe dëgjojnë dy gjuhë
Kosova gjithnjë ashtu.

LAGJJA E TRIMAVE
Familjes heroike të Shaban Jasharit

Ju e përflakët dëborën e Janarit,
akujt e shpirtit na i shkritë me prushin e zemrës.

Shkurtit ia shkurtuat ditët me krisma
e marsi e thirri pranverën e këngëve
nëpër gunën e klithjeve tona.

Lagjja juaj u rrit nëpër dhembjen tonë
kur buzëqeshjet e njoma të fëmijëve ia bëtë kurorë lirisë.

Djepi i këngëve tona prore do t`i përkundë
me plagë të madhe në zemër ditët që do të vijnë.

Me ju qëndresa vuri edhe një herë veten në sprovë,
piramida e dhunës u rrënua me atë gur,
që hodhët në ballin e paturpshëm të kohës.

Edhe kur fryma u ndal, karvani u nis
me Jasharajt krushq të parë e fishekun në grykë
kah dielli i shpresave tona.

Kur të na kthehet, do të vijë me shpirtrat tuaj
të shndërruar në rrezet e shndritshme të përlindjes.

Krismat tuaja shënuan lëvizjen e ditëve
kushtrimi burrëror zgjoi Kosovën deri në Dukagjin.

Tash gjaku juaj do kthehet me flamur fitoresh në dorë!

DËSHIRË E VETME
E LUFTËTARIT TË LIRISË

Sikur të kisha
shtatë mijë duar,
çdonjërën do ta ngritja
kundër armikut.

Sikur të kisha
shtatë mijë jetë,
asnjë s`do të më dhimbsej
për Lirinë.

Sikur të kisha
shtatë mijë zemra,
prapë do të më digjeshin
për bashkimin...

Sikur të jetoja
ndër shtatë mijë mrekulli,
të gjitha do t`i lija
për Atdheun!

TRINGA

Çmendurisht mbrëmë
Vallëzova n'ëndërr
Me Tringën e Smajlit
N'Deçiq n'rrasa guri.
Gërshetin e kishte lidhur
Fort n'këmbëz pushke
E n'dorë i tundej flamuri.
Dedë Gjon Luli qeshte,
Gotën e cakërronte n'gur
E mustaqeve u jepte raki-
Sa n'qejf ishte i miri plak!
Pastaj Smajl Ivezaj bëriti
E martinat nga gryka
Nxorën gjëmë e flakë.
Ne fluturuam me plumba
Mbi Mrizin e Avdisë
Nga baroti u bëmë shqiponja
Deda krah i kuq, unë bisht i zi,
Tringa shkundi xhubletën
Dhe u bë flamur mbi Shqipëri!

9.11.2014

PREKAZ 1999

Sipër oxhakut të djegur
hap krahët mbi zogj
Shqiponja e Flamurit.

Në odën e madhe të pritjes
të ngritur me ngut mbi rrënoja
hyjnë vizitorët të shërohen
nga frika e vdekjes
dhe dalin me hijen e qetë të burrit.

Përballë asaj kulle
një arë e mbjellë me varre të gjallësh
ngarkuar me lule
një kodër e butë
e mbjellë me liri.

Përballë lëndinës me varre të vrarësh
një kodër me lisa të njomë
shtatbukur si Jasharë të rinj.

Prekaz, korrik 1999

MË NDIHMOI FATI

Fati më ndihmoi
ta shoh Kosovën natën
për të mos ia parë
të gjitha plagët.

Në këtë natë gjumëndjekur,
banori i parë që përshëndes
është liria!
Kjo natë kosovare
e lehtë si ëndërr fëmije
përkundur prej malli
që nga lashtësia...

Më ndihmoi fati
ta përqafoj Kosovën natën
për të mos ia parë
të gjitha plagët.

NË BETEJË

Kuajt kalëruan,
Ata që mbetën pa prijësin ikën
Pastaj u endën rrugëve të vetmuar.
Orët e natës bien si t'u teket
Ne rrimë pezull, si fati ynë.
Në dritën e hënës rrezitet qenia jonë
Me heshtjen e thellë përpi natën e paftuar.
Fryma vjell psherëtimën monolog i bezdisshëm
Si lumenjtë vegimin e shpifur.
Stinët e dashurisë kanë dukje ndryshe
Në vendet përtej largësive,
Lamtumira është erë e ftohtë në çdo stinë.
Sonte shkel gjurmën e tij,
Po ai, ku është vallë?

IKONË PËRJETËSIE
Adem Jasharit

Aty
erdhe për të mos ikur kurrë,
feniks lirie,
udhërrëfyes,
frymë përjetësie.
Aty
linde,
u rrite,
u burrërove,
prapë linde.
Aty
në portat
e kopshtit të lirisë
rojë.

Ti
idol,
ikonë pavdekësie,
flamurtar
prijatar i një mijë betejave.
Ti
i gjallë
na ktheve shpresën,
jetën,
mbete fanar i pafikur
në rrugën e lirisë.

ÇDO SHESH, NJË PËRMENDORE
Zahir Pajazitit

Aty
me buzagaz burrëror
përherë me pamje djaloshare
qëndron vertikalisht.
Aty
në hijen e armës sate
pushojmë,
gjejmë lirinë.
Aty
kënga s'pushon
fëmijët të nderojnë
rreshtim, paradë ushtarake.
Aty
përherë të gjejmë zgjuar
me ballin diell
e gjoksin mal.

Ti
largove vajin e nënave
rënkimin e etërve
lotin e motrave
solle Lirinë.
Ti
deshe dhe u bëre shteg lirie
mbete me pamje djaloshare,
buzëqeshjen ua ktheve fëmijëve...

INDRIT CARA

Kur të pashë, Indrit Cara,
M'u ngroh zemra,
M'u gjallëruan dhe qelizat e thara.

U përqafuam
Atje mes flakëve të luftës
Midis tokës dhe qiellit.

Erdhe dhe shkove
Mes për mes ujëvarës diellore
Veshur me rroba ushtari.

Nuk ecje, por fluturoje
Kaptove tej
Nga malet me borë të Gallushës.*

Prita të ktheheshe nga beteja
Tok me shokët.
Por më kot...
Në gjirin tënd pat shkrirë çeliku i plumbit.

Që nga ai çast
Përjetësisht u skalite në zemrat tona
Ballëtar i sulmit,
Syri i shqiponjës në palët e flamurit.

**Mali ku u ra Indrit Cara, më 31 mars 1999*

VULLNETARËT NGA SHTETI AMË

Nga erdhën këta djelmosha në Kosovë
si të rënë nga qielli
që s'shihen askund dhe dëgjohen kudo !?

Harruan hallet dhe gëzimet,
lanë dasmat
dhe vatrat
me një grusht miell...
Dhe shkuan ...

Për ku kështu?

Në Kosovë
të takohen me qiejt,
atje ku Liria puthet me Diell.

E kurorëzuan mirë e qartë
qëndresën tonë,
shkëlqimin e lashtë e të stërlashtë,
bashkë me vëllezërit e atjeshëm
në Kosovë.

VAJZAT E UÇK-së

O, çfarë vajza pati UÇK-ja,
çfarë vajza,
Flutura !

Vajza vetëtimë.

Dhe djalli vetë frikohej
kur shihte ato vajza
shkreptimë.

Sa herë
burra dhe djem trima
shtangën prej tyre të hutuar !

Eh, ç'vajza pati UÇK-ja,
çfarë vajza,
Dafina fitoresh mbuluar !

TESPIHET E IDRIZ SEFERIT

Dikur një plumb qëlloi Idriz Seferin,
Atë s'e zuri, zuri veç tespihet.
Tri kokrra vrau dhe copëra bëri perin,
Të tjerat u përhapën në korijet.

Dhe për çudi unë endem tutje kodrës
Në Kaçanik rreth Shkëmbit të Skifterit,
Se mbase gjej të fshehura prej kohës
Pak kokrra me sedef të Idriz Seferit.

Ndaj unë ato kërkoj, kur jam në rrugë,
Me një durim vërtet prej arkeologu.
Në trastën time marr me vete bukë
Se shpesh mundohem shkrepave si zogu.

Idriz Seferi numëronte kokrrat
Në perin e tespiheve fildishti:
Sa burra ranë e humbën nëpër kodrat
Sa kraharorë i la të zbrazur shpirti!

Idriz Seferi numëronte dertet
Me kokrrat më të lashta se koha;
Kujtonte lotët që në gjoks i derdhte
E ëma e tij, e bardhë e tij, Kosova...

Dhe ndaj më duhen domosdo tespihet,
Ç'është e vërteta kokrrat e shpërndara,
Dhe po kërkoj në kodrat e korijet
Apo nën plisat ngritur nëpër ara.

Po ku ta dish si vete puna ime!...
Mos vallë i gjetën zogjtë, e larg i shpunë,
Me sqep i hodhën plot me ligjërime
Në Vjosë apo në Drin, a tej në Bunë!

Megjithatë sërish jam në gjurmime...

FUSHË-KOSOVË

Ah, të çlirohej vetëm me vjersha Kosova,
Unë e çliroja i pari, mua lavdia më ndriste të parit.
Me shpatën e vargut si pjepra do prisja gjokse dhe koka
Dhe flamurin lart do ta ngrija në malet e Sharrit!

T'i qeshte Kosovës vetëm nga vjershat liria dhe fati,
Unë do bëja me vargje kërdinë dhe hatanë:
Në Fushë-Kosovë s'do vritej vetëm sulltan Murati,
Do vriteshin katërmbëdhjetë sulltanë,

T'i qeshte Kosovës vetëm nga vjershat liria dhe fati...

Mars 1966

BALADA E TRE TË RËNËVE

Me dhentë ktheheshin nga mali tre kosovarë,
U zunë pritë serbët në gjunjët e Sharrit
Tek era fletët e vyshkura hiqte grykave zvarrë,
Tek vërshenin fijet e holla të barit.

I vranë e qirinjë s'u lanë të ndezur në darkë.
Në vendin ku ranë tek blegërinin dhentë
I frynë serbët qirinjtë me gojët si kacekët në farkë,
I shuan, mos dukeshin të rënët e shenjtë.

Po dhentë gjuhët e tyre me erën e barit
I nxirrnin si flakë qiriri me krye drejt qiejve
Dhe qanin me blegërima në gjunjët e Sharrit
Tek hëna të rënëve u qepste qefinët me fijet e reve,

ndërsa hutini vajtonte në degën me gunga të qarrit.

ATDHEU

Atdheu është dhimbje , është dhimbje.
Një prill i pikëlluar në shpirt.
Atdheu është kryqi , është kryqi
E mban - dhe të mban ty në shpirt.

Atdheu është toka e premtuar.
Ti shkel si një zot dhe s'e ke ndën këmbë.
Atdheu - s'ka fjalë, ka sy të trishtuar.
Vdes dashuria në dashuri që të çmend.

Atdheu është buka e uritur,
Të ikën nga duart e dot nuk të ngop
Endërr dhe ankth dhe shpresë e sfilitur
Me sytë n'errësirë vetveten kërkon.

Atdheu është varr i hapur, është varr.
Një jetë drejt tij shkon me besë që bind.
Në një pikë loti mbyt lotin fatvrarë.
Në një pikë loti lirinë e lind.

Atdheu yt i vogli , i vogli
Ai hyjnori i pavdekshmi si loti.

Fazli Greiçevci 1935-1964

MOS...

Mos këndo pa pasë nevojë për kangë,
se qielli i zemrës mrrolet n'agim,
çdo imtësi jetësore len mbrapa dangë,
kur ti ,o rreze,vegon n'përcllim.

Kur grushti ngrihet n'shejë gjaku,
valvitu n'krah shprese, o dashni-
brigjet le të dridhen nëpër sqota ,që se paku
të kemi flakë t'ngjyrës me motra e vllazni.

Kur n'tallase të dëshirës larg-larg tretemi
mos rënko tokë e mundueme ku lindi besa e dashnija ,
por prore mbaj kujtim synimet që po rrekemi
nëpër hullitë e kohës që të zhduket pabesija.

KANGA E MALEVE

Kangët e juaja të ngrohta dalin
o male t'vendlindjes t'vërshueme me lot e gjak,
ndër jehona t'vrullshme ta skuqi zallin
përleshja e moteve nëpër furtuna me t'zjarrtin lak .

Ndër tingujt e hojeve të dashnisë,
çerdhen e heshtjes e gjeta në krahët tu,
kanga juej, o male, në tela t'sharkisë
përherë ka m'u hazdisë e n'jone m'u shu'.

Kanga e trimnisë u ndez ndër epshe malsore,
të gjithë me lotët e mallkimit tu' ndëgjue ...
ndër shkrepat e bjeshkëve shprushet prore
nji tingull i mburrjes zemra tu' përvlue.

Për kangën e ngrohtë e t'mallshme m'kaplon dashnija,
o male të dashtuna ,t'mundueme në krajata ,
besomni, n'gjiun tuej ushqehem si fëmija
me prrallat krenare, plot vuejtje e shtërgata.

Krejt dallgët e shekujve heshtin nëpër rrudha ,
për hir t'legjendave n'sharki t'jehoj kanga ,
me gjak e eshtna na u pat zanë udha...
dhe lindën kërthijtë me diell n'zemër pa vuejtje e pranga.

MALLI

Sa ambël tingllon fjala NANË!
Zemrën n`etje ma molis,
Tu` pushu` natën pa yj e hanë
Andrra e vokët e dashnis`.

Nanë! Nanë! - amshim përjetë:
Në zemër të tokës po vlon
Për gjijtë Tu shumë janë tretë
Kanga me mall perëndon..

Për Ty e kalli diellin e shpresës
Bile n`andërr të më dëftohesh
Nanë, për troll n`qafim të besës
Ndër jehona pse pikëllohesh?

Nanë, o fjalë e dashnisë sime
Lot i vajit si plumbi m`randon,
Ndëgjo ofshamën plot pikëllime
Malli zemrën ma plagon ...

LIRIA

Liria
Fluturim zogu
Në dritare

Zgjim mëngjesi
Duarhapur

Është
Hënë
Prapa grilave
Liria
Erë gruri
I porsakorrur

Lojë e fëmijëve
Gaz e vaj

Është
Grua
E çliruar nga barra

Liria
Foshnjë kuqërreme
Në parzëm nëne

Si duket oh si duket
Liria

THIRRJE KOSOVËS

Ç'do të bëj unë pa ty
Pa ardhjet e shkuarjet e tua
Do të harroj të flas
Me vetveten

Ç'do të bëj unë pa ty
Pa shikimin në bar
Si t'i ngroh gjymtyrët
Të ngrira akull

Do të më lësh të bëhem plakë
Me dhembje duarsh
Me dhembje eshtrash

Kam frikë kur shkon
Ç'do të bëj unë pa ty
Po nuk erdhe
Do të bëhem gur pragu
Kallkan do të bëhem
Ç'do të bëj unë pa ty

ORA E PARË

Jusufi
Jusufi Kanjushë e verdhë
Jusuf Gërvalla... mungon
Teuta Iliri Agroni Ylli
Fadil Fadil Talla... mungon
Ylfetja Ylfete Humolli... mungon
Shukrija Shukrije Obëtinca... mungon
Kimetja Arsimi Kujtimi
Halimi... Halimi... mungon
Shpresa Besa Kastrioti
Fatmiri Fatmir Kërleshi... mungon
Afrimi Afrim Zhitia... mungon
Vazhdojmë
Valbona Shkurta Gjoni
Xhevati... Xhevati... mungon
Mungon Nesimi Bekimi
Afrimi... Afrim Prebreza... mungon
Mos më sillni
Certifika mjekësore
Prindore policore shtetërore
Thoni vetëm mungon
Me lule do t'ua mjekojmë plagët
Do t'i presim
Do t'i presim
Thoni vetëm mungon
Do të çelin lule gjaku
Ora vazhdon...

DUA TË KËRCEJ VALLEN E OSMAN TAKËS

Ngjeshur në fijen më të hollë të kujtesës
Lëviz me dhimbje nën ullirin plak
Afrohem pranë rrënjëve të tij
Degët e thyera kullojnë gjak...

Lidhur fijet e mallit flokëve të shekullit mizor
Siç lidhi Zerva kokat e burrave patriotë
Në shiritin e zi të historisë
Që ende sot në shekullin njëzet e një
Nuk po lidhen fijet e arsyes
Penjtë e dashurisë janë bjerrë ndër varre.

Ngjeshur në fijen më të hollë të dhembjes
Shëtis njollave të ajrit të murrmë
Ngjyrat janë shpërbërë në koleksion të heshtjes
Në bahçen e bilbilave dëgjoj këngën e Çelo Mezanit.

Eh, ç`më pihet një gotë raki, mendjen ta turbulloj
Dua të kërcej vallen e Osman Takës...
E kostumi është mykur, ka kohë që nuk vishet...

Ku jeni o vëllëzër çamë, eni të këndojmë së bashku
Në sheshin e Adem Jasharit e Zahir Pajazitit,
Fjala më çel nga thellësi e shpirtit.

Na bashkon gjaku, gjuha, kënga, ideali,
Kosovë e Çamëri jemi Një!

AROMË SHQIPTARIE

Sot erdha nga diaspora,
Po festoj të rrojë Kosova.
Sot erdha nga Suedia
Që të rritet Shqipëria.
Do të festoj edhe në Vlorë
Më 28 Nëntor.
Pas një shekulli lëngimi,
Pas njëqind vitesh mërgimi
Isa ka ardhur në vatan
Me kobure e xhamadan.
Aromë të këndshme shqiptarie e blini
Po përhap ti, gjeneral Isa Boletini!
Këtu para teje u përkulën bejlerë e pashallarë,
Hasan Prishtina, Bajram Curri e Ismail Qemali.
Eu, sa i madh qenke sot gjeneral
Sikur bjeshkët e Isniqit me mal,
Me flamur buzë Ibrit e Sitnicës
Zbukuron sheshin e Mitrovicës!
Qenke kthyer e po shikon kah Shala
Majdanit po i dërgon të fala.
Moti kur ti këtu ishe gjallë
Çlirove Peshter e Pazar,
E sot, gjeneral Isa Beu,
Këtu afër Ibrin e paske hendek.
Eu tribun, sa madhështor
Me plis të bardhë, me flamur n`dorë
Si para njëqind vitesh në Vlorë!
E paske hijeshuar sheshin e qytetit
Me shtatoren nga Durrësi i detit.
Aromë të këndshme shqiptarie e blini
Po përhap ti, gjeneral Isa Boletini!

ISA BOLETINI

Moj pranverë e këtij moti
Dëshmitare e këtij loti,
Që del gurrë nga shpirti im
Për Isanë birin tim.

Jam Shqipëria bija jote
Nënë e vjetër tokë arbërore,
Varr për bij nuk po bën
Që dhanë jetën për vatan.

Shkuan dekada, edhe shekuj
Zemërvrarë e shpirtmekur,
Për shumë djem të Dardanisë
Boletinin e Pavarësisë.

SIKUR TË ISHTE
XHEVAT BERISHA

1.
Ah, sikur të ishte sot
Xhevat Berisha me shokë
e t'i gëzonim këto ditë të bardha në Vërri!

Odave të bardha plot dritë
të mbushura me rrezet e lirisë
e telin t`ia këputnim çiftelisë,
gëzimin ta derdhnim në kupë të qiellit.

Me plakun plisbardhë
ta luanim vallen e lirisë
kah mbushullojnë bjeshkët në tupan.

Natën ta bënim ditë
deri në rrezen e parë
të agut të ri.

2.
Xhevat vëlla,
nuk e di si do t'i shkrinim
kujtimet e netëve të gjata
për Kosovën e lirë.

Në Dukagjin e Drenicë
në Kukës e në Vërri
nga një flamur ta flatronim.

Dhe sa herë bajlozi
t'ia ndalte flatrimin
me hovin e Gjergj Elez Alisë
t'ia shpaguanim zemërimin.

3.
Dhe po të ishe sot
cicërimë e vogëlushëve
me abetare në dorë,
shkollën e re do ta gëzonin.

Filiza e pipa të rinj plot
do t'i çelnin Kosovës,
sa mirë do t'i rreshtonim
brezat e lirisë.

4.
Dhe po të ishe sot
Xhevat Berisha me shokë,
nënave tona do t'u thoshim
të na piqnin misërniken e lirisë
në çerep me saçin e bakrit te vatra.

Ujë nga krojet e bardha të Vërrinit të pimë
dhe gjakut tonë t'i japim vrull
në damarë, me vrullin e lirisë.

Me zemër kreshnikësh
kaçakçe bjeshkës përmbi t'i rrimë.

Kullat do të mbushullonin oshtimë
dhe forcë do t'u jepnin
ushtarëve të lirisë.

5.
Dhe po të ishe sot
kur ende na bën furtunë
atdheut e përreth...

Me bacë Salën e gjoksin sa bjeshka,
furtunë Karpatesh
s`do të frynte më në këto anë.

Me shokët e tu
barbaritë do t'i paguanin të gjitha.

6.
Dhe sot, kur i drejtohem lapidarit
më mungon shumë
edhe dëshmitari i kohës,
që t'i mësoja të gjitha
ngjarjet e legjendës.

Dhe Ti, me buzëqeshjen tënde
më thua se i di të gjitha,
unë druhem nga ajo.

7.
Dhe sot, kur ma prekin Kosovën,
këmishën e kuqe të saj
e m'i bëjnë prita lirisë,
me vete them:
Ah, sikur të ishe sot
Xhevat Berisha me shokë!

Atëherë mbushem vrer
e rebelohem,
kërkoj fillin e këtij lëmshi
e i them vetes:
Ruajna zot nga mallkimi i gjakut,
të paktën shpëto Kosovën!

8.
Dhe sot jam mbushur mall
për ty dhe shokët e tu:
Salën, Shefqetin, Hasimin, Alajdinin,
Bekimin, Shahadinin, Ibrahimin,
Nehatin e Naipin
dhe dy pleqtë: Asllanin e Izairin.

9.
Dhe po të ishe sot,
o Xhevat Berisha me shokë,
pushkën do ta linim në frëngji
me grykë kah veriu
e t'i mprihnim penat
e t'i shkruanim lirika atdheut
nga Mollë e Kuqe
deri në Çamëri!

E AFROVE DITËN E LARGËT
Heroit të Lirisë Xhavit Haziri

Para Hartës së Atdheut me shpirt u betove
e nise Ecjen, kur ishim shumë larg Cakut
gjithnjë bëje plane, ndërmerrje veprime
që Nata të shporrej, të shkonim drejt Agut.

Rruga shtruar me gurë flijimesh si Rozafa
Ti ecje nëpër të me Ballin gjithnjë Lart
hidhje pandalur Hapin, bëje tutje përpara
të na afroje Ditën që ishte aq Larg.

Ndër të rrallët Ti arrite te Dritarja e Kohës
e hape atë - të hynin Rrezet e Ndaluara
të shprishnin terrin e Natës njëshekullore
dhe të vinte Dita e Lirisë, ajo e bekuara.

Që atëherë e sot, sot e përgjithmonë
mbetesh një Kumbim, ashtu siç ishe Burrë
Me zërin tënd të nxjerrë nga Laringu i Historisë
Ti jehonë që vetëm rritesh e nuk shuhesh kurrë.

KRISMA LIRIE DHE KËNGË

I.
Në krojet iluzore nuk shuajnë etjen trimat e Drenicës
as i dëgjojnë ninullat politike
të infektuara nga epidemi e përgjumjes.

Në Prekaz të Ulët
Kënga e Trimave kthehet
në Kushtrim:

Jo shtatë ditë e shtatë net, po shtatë vjet
Adem Jasharaj në Log të Qëndresës
për një Luleborë,
për Pragun e Atdheut.

II.
Si sy lugatësh – përgjimi me dylbi nate:
pancirveshurit hiençe i gëzohen ditëmortit.

Pelerinë e errësirtë endet sipër supeve të ditës,
tytat e topave marrin në shenjë Lagjen e Jasharajve.

Zinxhirët e tankeve i ngulen përgjakshëm
në kurriz Atdheut

Yll Afërditën, Agimin a Këngën e hareshme të harabelave
po vënë në kryq snajperët

III.
Ditën e pestë të marsit
po qëllonin granatat e vdekjes,
Kryetrimi ia thoshte këngës
me krisma lirie.

Jo shtatë ditë e shtatë net, po shtatë vjet
në Log të Qëndresës
për një Luleborë,
për Pragun e Atdheut.

- Eu, të lumtë tyta, Komandant Adem Jasharaj,
Gjeneral mbi gjeneralë!

KITARA NË KOMË
Poetit Jusuf Gërvalla

Me shkëndija ardhmërie kompozove një këngë të re
ca tinguj të ardhur nga vringëllima e shpatës së Kastriotit
trokisnin në dyert e frymëzimit.

Kitara po gëzohej për dorën muzikale
që do ta përkëdhelte me nota,
kanarina ushtronte zërin t'ia mbante ison.
Veç Premtoni qe ende shumë i ri të kuptonte altarin e lirisë
e donte dashurinë e babait e jo sofrën e jetës
shtruar me dhembje e mungesë.

Pentagrami po mbushej me vrushkuj notash
nga shtresat e panjohura për të tjerë
të frymëzimit diellor:
këngë me intonacione shprese
gjaku i të rënëve po i shndërrohej në melodi.

Nga pusia mistershëm dorë e ferrtë
qëlloi me plumb
sipër kitarës së stepur dhembja kthehet në elegji,
tingujt e zjarrtë ranë në komë.

Natë kur porta e padukshme e frymëzimeve
hap kanatat dhe kërkon shpirtin e përflakur,
errësirë e korbtë në qiellin e fatit tonë:
me atome të katranta duan ta stërkeqin
klorofilin e blertë të ekzistencës.

Duke ndjekur shenjat treguese të tingujve të dashurisë
Ai ecte një linje me kahe dritësore:
që atëherë e sot vrushkuj shkëndijorë të gjakut mbi kitarë
amshueshëm flakadë –
Urë mbijetese drejt ditës së nesërme.

FILLIM I NJË POEZIE

Them Adem
Dhe nuk kam nevojë
Për asnjë metaforë
Për asnjë krahasim,
Më ngre në qiell
Estetika e Lirisë
Bukuria e gjakut tim.

Shoh Kosovën
Në Drenicë tek merr zjarr
Për t' u ngrohur në janar.

Mbi Drenicë është qielli i lirisë
Dhe aty kam shkruar Adem,
Gjë tjetër nuk them.

Në sytë e lirisë lexoj
Adem, Prekaz, Drenicë...

Në sytë e lirisë
Në qiellin mbi Drenicë
Lexoj Lirinë.

Në lartësinë e qiellit të kaltër
Mbi Drenicë
Lexoj jetëshkrimin e Lirisë,

Në Prekaz, në Drenicë...

MUJË KRASNIQI ËSHTË NJË

Në qendër të qytetit
Një Mujë e ka qyteti im
Vetëm Një si Diellin
Vetëm Një si Lirinë.

I vetmi që nuk pushon
24 orë ballin mbi re.

Përditë e përqafojnë
Fëmijët, nënat e dëshmorëve
Këngët dhe shqiponjat.

Pastaj në ditë festash
Para kamerave, para mikrofonëve
Mbahen fjalët e rastit, duartrokasin.

Seç e zvogëlon përditë
Atdheun e partive politike,
Lirinë seç e rrit përditë

Vetëm Një është Ai
Si Dielli, si Liria, si Flamuri.

Një Mujë e ka qyteti im
Vetëm Një si Diellin
Vetëm Një si Drinin.

FEHMI E XHEVË LLADROVCI

Si fisnikë përmbi
qëndroni në shkëmb,
ku e vërteta
gënjeshtrën tremb.

Me këngë ikët të dytë
në gjakun që qarkullon...
Ju, ne dhe sytë
tek dielli që perëndon.

Mbi flokë një frymë e hollë
në fushën e tharë rrëshqet,
një dëshirë e kapur me dorë
atje në lapidar thërret.

Tek varret që rënkojnë
në ritmet e kujtimit,
dy emra
shtigjeve udhëtojnë.

BACË, U KRY !

Vikamë nga thellësitë e shekujve:
Bacë,
u kry !

Të rënët
në testamentin e lirisë
hedhin firmat e tyre prej gjaku:
Bacë,
u kry!

Të gjallët
mbi supe lart e mbajnë Kosovën,
pengu yt:
Bacë,
u kry!

2010

VARRI I AZEM GALICËS

Kaçak edhe varri,
ilegal i bjeshkëve mbeti,
i shtrirë atje
me një plagë dielli te shtati,
me një ballë hëne tek vdekja.

Varri i tij
shkëmb në kraharorin e bjeshkës,
kurmi i tj
palca e shkëmbit.

ALFABETI I DËSHMORËVE

Ju fëmijë nëse doni
A-në në mend ta mbani
Thoni A, Adem Jashari
Thoni A, Agim Ramadani.

Kur ta mësoni A-në
Mbani në mend në daçi,
Mos thoni A-aeroplani
Thoni A, Abaz Thaçi.

Kur të shkoni te B-ja
Mos thoni bujku a bisha,
Thoni B, Bedri Shala
Thoni B, Bekim Berisha.

Dhe lavdërohet F-ja
Thotë unë jam në flamur,
Jam te Fehmi Lladrofci
Që nuk harrohet kurrë.

Mos thoni H, Hëna
Kur H-në e takoni së pari,
Në mend e mbani më lehtë
Të thoni H, Hamëz Jashari.

Kur do ta mësoni I-në
Mos u thoni I- kuajve lodra,
S`do ta harroni kurrë
Kur thoni I, Ilaz Kodra.

Unë po ju tregoj
Mos thoni nuk e diti
Se me Z të madhe
Është Zahir Pajaziti.

Ju lus fëmijë të dashur
Në qytet e katund,
Këtë alfabet që nisa
Ta çoni deri në fund.

PARA VARRIT TE KOMANDANTIT
Një ushtar i batalionit "Atlantiku"

Larg në Amerikë ishim
Mendjen n`Kosovë kishim.

Në jug t`Europës plakë
Kosova digjej flakë.

Formuam "Atlantikun"
Kaluam Atlantikun.

Të veshur me barot
Kosovës t`i dalim zot.

Rezezat i shporrëm qiellit
Për rrezet e ngrohta të diellit.

Erdha në Prekaz o trim
Edhe sot je komandanti im.

Buza më dridhet në vaj
Mos më qorto pse qaj.

Deri në fund të kësaj bote
S`harrohet lavdia JOTE.

LULËKUQET
Xhevdet Aruçit

Sa herë vjen Qershori
Me gjelbërim n'Kosovë
Dëshmorët e lirisë
Në lulëkuqe i shikojmë.

Lulëkuqet e çelura
Që flasin gjithmonë
Si këto vargje radhë
Për Drenicën tonë.

Në lulëkuqe të lirisë
Zëri i fuqishëm fol,
Dëshmori Xhevdet Aruçi
I Nënës Kosovë.

Havzi Nela 1934-1988

NUSJA E FLAMURIT

Lavdi çikës kosovare
Si nji shqerre, si nji manare.
I del tankut; thotë "ndal!"
Rritet, ngrihet sa nji mal!-

Shih si jam si lulëkuqe,
Lulëkuqe buzëburbuqe,
Jam shqiponja me dy krenë
Fluturova, mora dhenë.

Për Kosovën Republikë
Lëshohem, ngjitem, nuk kam frikë
Jam shqiponja me krah' e fletë,
Lëshohem, ngjitem gjer te retë.

Jam e bukur, drit' e nur,
kuq e zi, jam ba flamur,
Kam fustanin fletë-fletë
Jam shqiponjë e vërtetë.

Nalt mbi tank shqiponja ngjitet
Hapi krahët, po valëvitet
Për Kosovën Republikë
Fluturon e nuk di frikë.

Hapi flatrat, n'ajër u lëshue
Bash si zanë u mrekullue!
Si shqiponja me dy krenë
Fluturoi e mori dhenë!

Manushaqe, lulëkuqe,
Nusja jonë, buzëburbuqe,
Maje tankut me flamur,
Ngjitesh mos me vekun kurrë!

Burg i Spaçit, 1981

THONE ËSHTË PARË PJETËR BOGDANI

Një ditë vjeshte në Prishtinë,
Thonë është parë Pjetër Bogdani,
Me Hoxha Tahsinin, Hoxhë Kadrinë,
Me Pashko Vasën e Negovanin…
Seç kuvendonin për përjetësinë,
Për Stambollën, Romën, Vatikanin
Luteshin për Gjergjin, për Arbërinë,
Argjentën, Antarion, për Zveçanin;
Thonë, mallkonin djallëzinë,
Carin, krajlët e Sulltanin…

Është parë, thonë, Pjetër Bogdani,
Në oborr të namazxhasë,
Ku ia copëtuan eshtrat e zhvarrosur
Qentë llaskucë të kasabasë…
Fërkojnë sytë besimtarët e mpirë
Pas meshës së shenjtë e pas xhymasë:
O zot! Një shqipe e shenjtë, mjekërngrirë,
Buzëqesh nga froni i arabasë..:
- Nuk janë gjë, thotë, qentë e rrugës,
Që shkërmojnë eshtrat e Bogdanit,
Kujdes qentë që kafshojnë tokën,
Qe kafshojnë gjuhën,
Kafshojnë fisin,
Kafshojnë plisin...
Kafshojnë shpirtin e vatanit!

Qofsh i gjallë, qofsh i groposur
Dhe të vërsulen zagarë e qen,
Mos u thuaj: tyt! qenve të zgjebosur,
Por atij që i ndërsen…!
Ai që qentë
T'i ndërsen,
Nga çdo lloj qeni
Është më qen…

Thonë atë vjeshtë me ngricë e brymë
Është rishfaqur Pjetër Bogdani,
Me Hoxha Tahsinin, Hoxhë Kadrinë
E me Papa Kristo Negovanin…
Thonë atë vjeshtë me suferinë
Përkundte hasiania, të vëllanë, hasianin,
Në ninulla, zana e sibila,
Tok me Gjergjin,
Me Pjetër Bogdanin,
Me Hoxha Tahsinin, Hoxhë Kadrinë,
Me Pashko Vasën, me Negovanin…
Seç ligjëronin për Arbërinë,
Për fisin, plisin, për Vatanin.

UDHËTIMI I ISA BOLETINIT PËR NË VLORË

1.
Nëpër male shpejton Drini,
Rend dhe Isa Boletini.
Nëpër natë e shqyen borën,
Në gacë të llullës shikon orën.
Këqyr kah jugu, herë kah Kosova:
"Haj medet, thotë, u vonova...!"
Përmbi vetull e çon dorën
Dhe i duket se shikon Vlorën.
Sheh flamurin si valëvitet,
Ngutet Isa e nuk i pritet.
"Gjallë a vdekë, sot a nesër,
Do të jem në Vlorë patjetër...!"
Plaku i Vlorës i fanitet,
Diçka pret e nuk i pritet.
Dorën plaku shkon në mjekër:
"Do t' arrijë Isa patjetër...!"
2.
Nëpër male dredhon Drini,
Rend dhe Isa Boletini.
E udhëtimi nëpër natë,
Është i lodhshëm, është i gjatë.
Përmes bishash, në borë e mjegull,
Zgjatet nata, bëhet shekull...
3.
Përmes fushe shket Shkumbini,
Rend dhe Isa Boletini.
Mërmërin dhe Drini i vjetër:
"Do t'arrijë Isa patjetër!
Herët a vonë, sot a nesër

Nëntor 1984, "CZ"

KOMANDANT MJEKRRA

Kosova të thirri pranë shpirtit të lirisë:
"Mjaft më nën thundrën e shkaut!"
Dhe ti mbete legjendë e përjetësisë
për lirinë e Kosovës këngë majëkrahut!

Bëre përpara dhe prapa kurrë s'u ktheve
fjala liri më e mprehtë se plumbi ishte
dhe e grise tmerrësisht zymtësinë e reve,
që çdo fëmijë kosovar në sy lirinë të kishte.

U turrën si bisha ushtarët e Serbisë,
lëshuan mbi trupin tënd hekur dhe zjarre,
por ti s'u tunde se nuk tundej mali i lirisë
dhe mbete vullkan që ndezi vullkane.

Kam ardhur i malluar në qytetin me emrin Viti,
kam ardhur pranë syrit që krenarinë ma ndezi
ku drita e lirisë më thërriti, të ndez muzën time të dëlirë
ashtu si ti ke ndezur malet, se vëllezër jemi.

Dhe koha jonë në vite kurrë nuk do të ndalet,
unë erdha sot tek ti vetëm të të them tungjatjeta
dhe solla vargje vëllai të dala prej zemre
dhe solla pak fllad Shqipërie për ty komandant Mjekrra.

Tek syri yt unë kam syrin tim, paralel të dy bashkë,
ti luftëtar, unë poet, shumë të shtrenjtë kemi lirinë
gjaku yt tokës martire të Kosovës i jep vlagë
vargu im i jep dinjitetin shqiptar dhe ty pavdekësinë.

DUKE ECUR NËPËR DRENICË

I thinjur, me vite i thinjur,
në Drenicë, në tokën time
vij për herë të parë.

Këtu mijëra herë kam lindur,
mijëra herë jam vrarë.

E përsëri gjallë,
Mal i Bardhë.

Vëllezër drenicarë,
më thoni ku ta hedh këmbën?
Këtu, në çdo pëllëmbë
gjaku dhe lavdia
shkrirë në një folje, në një emër:
-Flatron Liria !

Në Drenicë vëllezër kosovarë,
më thoni ku të mbjell
zambakun e gjakut tim-
Këngën?
Druaj se mos zgjoj të rënët.

Drenica kumton:
-Ç'pret? Je në tokën tënde,
zgjat dorën.
Gjaku i ushqen rrënjët
Liria i praron kurorën !

2005

PO VJEN SHOTA

Kur kaloi Shota në fshatin tonë,
të gjitha vajzat rendën pas saj.
- Nga një kronikë televizive

Dilni të shikoni, vjen Shota, Azemi
mbi supet e tyre ndezur rri ylberi.

Mbi hark të ylberit tërë ëndrrat tona,
për ta skaj më skaj po këndon Kosova.

Ja shokët e tyre, shihni, u shkrep syri,
n'ato shkreptima vjen merr dritë ylli.

Shikoni ç'gërshet të bukur ka Shota!
Në krah të Azemit rritur nëpër shqota.

Derdhur përmbi shpatull si lastarë shelgu,
nuse kaq të bukur s'ka njohur dyfeku.

Ejani krah Shotës, të rritim gërshetin,
baruti t'i zverdhë , erërat t'i krehin.

Pa u nisën vajzat, doli tërë Drenica,
në gjurmët e tyre, toka shkrepte xixa!

1986

PRANË VARRIT TË DËSHMORIT

Rëndë – rëndë ecën
Kortezhi i gjatë lumë
Pranë varrit të Dëshmorit...

Në ballë
Bij e bija martirësh
Plisa të bardhë
Nënëloken përqafojnë.

Ca pika loti rrëshqasin
Qetë-qetë...
Freskojnë rrudhat e zhuritura
Faqeve të vraguara motake.

Nënëlokja ngre kokën lart
Shtrëngon fort lulëkuqet
Krenare vështron varganin
Me varre rinore...

Oh!...
Sa shumë janë: Ilmiu, Fetahu,
Abdurrahmani, Fisniku, Ruzhdiu...
Oh!...
Skajin s'ua shoh dot
Sytë më janë dobësuar
Nga pleqëria

Por , të parin...
Ja të parin e shoh shumë mirë
Është Ademi
Adem Jashari i thonë!!

Sa hije u ka rreshtimi ushtarak
Dhe uniforma e UÇK-së,
Trimat e nënëlokes!

Më falni, ju lutem
S'dua t'u lëndoj...
E di, trimat nuk vajtohen
Por loti nuk buron
Vetëm nga dhembja,
Unë krenare jam,
Por më kuptoni, ju lutem
Nënë jam!

E ju po heshtni,
Edhe heshtja u ka hije
Krushqit e Lirisë kanë modesti
Edhe disiplinë ushtarake kanë.
E di
Edhe betimin që i dhatë
Tokës që përqafuat,
Tokës që ngjyroset
Me ngjyrë të lulëkuqes.

Po, po, ju kupton nënëlokja,
Ju ushtarë jeni
Edhe në liri
Edhe në histori,
Ushtarë prore do të jeni
O, lum bëfsha për ju!

Prandaj...
Është krenare nënëlokja
Për ju që u bëtë këngë,
Per ju që u bëtë poezi
Për ju që u skalitet në gur
Për ju që u qëndisët
Shqipe në Flamur...

Edhe lapidari në heshtje flet,
Ne jemi këtu...
Këtu ishim edhe më parë
Nuk na vutë re?!
Por, ani...
Ne këtu jemi, këtu...
Të bashkuar si na shihni
Në një rresht të gjithë jemi,
Në rreshtin e idealit
Në rreshtin e historisë
Jemi!

KUMTI
Te sheshi i Komandant Mujës

Pika shiu e vese mbi ty
Si dje lumgjaku në fushëbeteja,
Ëndrrat e vjedhura në rini
Më përkujtojnë vdekjet krenare.

Shtatorja jote zëdhënëse e Lirisë
Mbledh shekujt bashkë si në legjenda,
Qiejt i qëndis si gjerdan ilir
Si jetën që ruan për atdhe.

Pret ringjalljen e Mujit e Halilit
Zanat e Malit të të rrinë mbi krye,
Nëse s'jemi të denjë, nga kënga na përzë
Baladë vdektarësh na bëj!

Kështu si ti Mujë i bronztë rri Çerçizi
Zahiri, Shkëlzeni e Luani
Në rrugë, sheshe e monopate,
Më petka të reja pranverave
Me flamuj mali përvjetorëve
Si pëllumba paqeje kaltërsive,
Rrëbesh këngësh të pakënduara
Frëngjive të kullave me rrasa guri
Një ditë të bardhë pret Lindje të madhe.

Tungjatjeta Komandant
E ty Shqipëri!

TINGUJ ACARI

Sa lindje vdiqën janarëve,
Sa lisa rrëzoi acari i bardhë
E asnjë kokë përulur s'mbeti.

Edhe pse kulla e guri pikuan
S'u shembën, as s'u trembën,
Sa kroje në janar shteruan
E lot s'ka...

Natë skëterrë plot kobe
Se lindjet harruan perënditë,
Tinguj të këputur n'acar
Akull vdekjeje në janar.

Kitarë që dridhet metropoleve
Jusufin drithëron
Bardhoshin rinon
Kadriun burrëron.

Damar i plasur në thellësi
Dhembje qe rrjedh e kullon
Dëshmitar i dashurive t'perënduara
Fluturim kanjushash n'kaltërsi.

Sot u vë fre dhimbjeve krenare
Aureolë pavdekësie
Jusuf, Bardhosh e Kadri!

LARTËSITË

Përulemi para tyre si para perëndive
Shtatore e zbuluar me aq dritë hyjnore,
Asnjërit nga ne ndër mend s'i bie
Të themi një fjalë, të çmallemi me to.

Hijet të zënë pritë mes shembjesh
Mashtrohen ata që pas tyre ecin
Masin kohën e ikur pas lindjesh
Hapat numërojnë nga e para
Si shkallët që çojnë në lartësi.

Fjala e dhënë-plumb e besa e fortë-shkëmb
Vijëzon horizontet e thur elegji
Qëndron krenar në shesh sot
Përtej lartësive rojë nderi je
Shtatore qe s'fle, as engjëll s'je.



Iljaz Prokshi 1949-2007

ÇYÇAVICA

Asgjë s'është harruar
Kanë ikur korbat para syve të mi

As koha e mjegullt nuk është më
As besojnë se Trimi është kthyer
Me një ferman si Skënderbeu
T'ia japë Adem Jasharit
Para kullës të ndodhë betimi

Rrugëve kryq pështpëritin
Shtëpitë akoma digjen
Kohë më kohë diçka ikën

Uji dua të pi si në Epir
Krojeve të Qyqavicës

Ndryshimi absurd mund vdekjen
Tek mbesin vetëm iluzionet
Atdheu im s'më vret

ADEM GUTA

Një emër i madh më shoqëronte,
Dot s'ia shihja as rrudhat në ballë,
Herët në mëngjes vinte më zgjonte,
Trashëgohej nga trungu familjar…
Kurrë s'e kisha parë
E kisha kushëri
Eshtrat i janë tretur,
Varrin nuk ia di...
Emrin e ka të madh
Në fushë të Sremit ra,
Atje në Mramorash,
Thonë një varr ka.

Gjithçka e ndaluar
Ta vrasë harresa,
Të mos dinë për gjyshin
As nipër e mbesa.
Të mos dijë Kosova
Se ka pasur djalë,
Figurë pishtare
Nga trungu kombëtar.
Të mos dijë Shqipëria
Për dëshmorë të Kombit,
Fshehur nga Serbia
Pa gjurmën e varrit…

AMANETI I FUNDIT

Atje te Kodra e Diellit,
pranë Kodrës së Trimave,
ta zunë pritën me rrethim
ata që mijëra prita i kanë vënë në shekuj
Atdheut tim...

Dhe plumbi të mori në ballë e në gji,
ta dëgjova amanetin e fundit, o vëlla Fahri:
-Mos ma vrisni Diellin!
Për gjak të flamurit, vëllezër,
ma ruani diellin edhe në Medvegje e më tej....

Varg mbi varre
marshojnë edhe të rënët në një hap me të gjallët.
Dritë në Kosovë,
te Kodra e Diellit ka mbirë një lulëkuqe,
që s'thahet as në borë...

Prishtinë, 7 nëntor 2000

KOSOVA

Sa herë kam kaluar mbi qiellin tënd, Kosovë,
Midis reve të tua të rënda, gjëmimeve të tua.
Ca pika shiu u rrokullisën nga dritarja e avionit, diç thanë.
(As ato s'mund t'i prek dot, janë përjashta.)
Një vetëtimë që kaloi përbri m'u duk se ma bëri me dorë.

E pra, ky është shiu yt, retë e tua, bubullimat e tua.
Ca sinjale të shpejta, xixëllima mendimi inkadeshente.
Kurse kurrizi i gjerë i tokës tënde vrapon diku poshtë,
Duket e zhduket i zymtë midis zgavrave dhe humnerave të reve.

Largohemi vazhdimisht. Tani ti mbete prapa.
Tani krahu i avionit në qindra copa të pret.

1966

TERRORI NË KOSOVË

E hidhur vjeshtë e këtij viti
Kosovën gjeti nën terror.
Korba të zez mbi të ia mbërritën
Hetues, gjykatës e prokurorë.

Me dhjetë vjet burg, me tetë, me shtatë,
Me dymbëdhjetë dënojnë diku.
Kështu mes jush shekullin ndani,
Dhe mijëvjeçarin ndani ju.

Kështu e prekni historinë,
Mbi supe e mbartni ju sërish.
Prangat në shkollë që i mësonit
Në duar ndjetë befasisht.

Dhe patë se koha e mesjetës
S`qe larg dhe veç në libra s`qe,
Dhe u kthye nata e Prishtinës
Në natë Shën Bartoleme.

U ngritët ju viganë, fisnikë
Me korrektesë e madhështi.
Ngaqë kërkuat Republikë,
U shtypet si në monarki.

Por koha kurrë s`vjen përgjysmë,
Natë e masakrës vetëm s`mbërrin,
Se pas Dushanit car të frikshëm
Rrufeshëm Skënderbeu arrin.

S`kishte dëshmitarë,TV nuk pati
Zinxhiri i tankut kur ju griu,
Por retë e globit veç ju panë
Ndërgjegje e botës te ju mbërriu.

Kështu në vorbull të epokës
U ngritët ju si monument,
Ju që e prekët historinë
Dhe n`histori u kthyet vetë.

1981

EMËR KRENARIE
Ruzhdi Xhuliqit

Ruzhdi trimi i rrallë
Lindur në Marali,
Doli me shokë në mal
Të kërkojë liri.

Luftë e rreptë filloi
Sulme të pandalura,
Në Rahovec luftoi
Me bishat e çartura.

Erdhi lajmi në shtëpi
Trimi dëshmor ra,
Amanet nanës Zelfi
Për mua të mos qajë.

Me dëshirë në UÇK
Unë vetë kam shkuar,
Trupi im s`bëhet rehat
Kosovën pa çliruar.

DRITË RRËZËLLORE
Ahmet Delisë

Kur bora mbulonte
Mbi një metër trashë,
Ahmet Delia vetull kreshtë
Po hidhte një hap.
Eh sëpatë e tij
Vetëtinte tmerrshëm
Mbi koka bishe
Si mbi trungje pishe!
Hyji kundronte lart
Një me shtatë,
Ata më pushkë
Ai me sëpatë.
Dhe hëna bënte çudi,
Nga gjithë ajo forcë
Nga një plak
Gjithë ajo dashuri!
Dhe iknin bishat
Gardhoreve e gjirizeve,
Iknin trenuar
Sikur të mos ishin kurrë.
Eh Islam Ramës plak
I qeshte balli e thembra

Kur bishës nuk i shkrepte
As gjyle topi
As mauzeri!
Përgjëroheshin bishat
Se nuk do ta shkelin
Kurrë më Prekazin,
As ar e vathë nuk do të marrin
Se do ta vrasin veten
Gjallë po të dalin.
Eu, po nata nuk erdhi
Derisa i rashë
Hyjit në konak
Me Murselin çunak!
Ai zvarriste trupat e bishës
Nga shkallët si degëza lisi
I paloste në dengje
Si duaj kashte të prishur.
Eh more bacë Ahmeti
Kur Hyji ta dha bekimin,
Në kullë u tund djepi,
Luleborat u bënë zambakë
E gjaku flamur kushtrimi!

FADIL VATA - AFRIM ZHITIA

Dy degë të një trungu
Lumenj në një det
Lule në një saksi,
Damarë të një zemre
Rrahin për Liri.

Dy koka në një shtatore
Sy të këtij Kombi
Shohin larg e larg.

Një ëndërr lirie
Mision në jetë patët...
- S'është gati, o shokë,
Pritni edhe pak
Liria s'është larg!

Jakup Ceraja 1934-2001

KULLË

Me bukë zemre pret,
Me tytë pushke flet:
Lum kush të do
E hujet t'i njeh,
Mjerë kush s'të do
E hujet s't'i njeh !

Kullë,
Një zog ma ke vrarë,
Një thëllëzë ma ke mbyllur -
Do varre përreth të akuzojnë,
Do përmendore kundruall të mbrojnë...

1971

USHTARI I UÇK-së
Besimit nga Braboniqi

Atdheut i përgjigjet
me trupin e vet,
malit këmbë ngjitet
fushës ecën lehtë.

E ka për detyrë
t'i dalë zot Kosovës,
është vetë pasqyrë
në kulmin e provës.

Jep e kurrgjë s'merr
shpërblim është liria,
nuk duron më terr
e thërret dashuria.

Jusuf Gërvalla 1945-1982

FLETË TESTAMENTI

në zgjimin tim të heshtur të më ngurosin
në flijimin tim të begatshëm të verës
në nisjen time në fillimin tim të ri
në gjumë shekujsh me ndërrime të më zgjojnë
le të më puthë rrezja e qartë ngazëllyese
e druvarit të fjetur në rudinë
myshku le të jetë gjithmonë i blertë mbi gurë
emër të mos ketë e shkronja le të flasë
në gjuhën e vjetër të kafshës së zezë
guaca e kërminj le të vijnë për dasmë
mbi rrasën time
le të shtrihen edhe ata si dy yje
ftohtë le të bëjë verës e verës verë
e me një pikë ujë verdhësisë së barit tim
le t'i mëshirohen

vërmeni atje tek do të tregojë guri për udhën
deri te shtëpia ime bërë me dru e kashtë

le të thyhet çdo pasqyrë që ka ballsamosur
ballin tim e mërrolën e çastit plot mllef
se ja tek po zgjohet er' e re e dashurisë së tokës
se jam i parrezikshëm kaq i pafuqishëm
mumje përfytyrim që krahasohet me rrahun
tek do të më vini përsëri ju pas
le të më lënë të fle qetë si pranë stufe
dimrit të madh të dashurisë sime
nuk do të përpëlitem s'do të rrotullohem
s'do të shplohem natën nuk do të kollitem
me fjalët e mia le të më mallkojnë
në rrasën time atë rrasë të zezë të ftohtë
në duart që i kam prekur le të më lëshojnë
rrjedhës të qetë të fatit që pret
shigjet' e mërisë le të bjerë mbi dhe
në shkretëtirën e moskuptimit le të fiket
kurrë të mos vijnë kur unë nuk i pres
ata që tërë jetën i prita, të dashurit

ç'po flas kështu pash zotin?

LUFTA DHE ARTI

Tutje gjithnjë akull
Këndej gjithnjë zjarr
Unë jam syri i Aladinit
E shoh veten si digjem
në betejën e tmerrshme
të fjalës e të mendimit

Me shenjtëri të mallkuar
me përfytyrimin e qartë
e krijoj
Në mua shushurijnë dete
të qena në ëndërr

S'po flas kotnasikot
Mund t'i merrni fjalët e mia
e të niseni nëpër botë
Unë s'kam guxim
Kuptoj se pa dritën e tyre
Nuk do ta di rrugën nëpër dritë
Janë krijuar prej frenimesh
prej kthesash theqafjesh
dhiaresh të shenjta
zigzage

Unë nuk i shoh yjet
pështjellë në terr
Gjithësia e ftohtë
nuk e ka gji diellin
Sikur të mos e ftohte
ana e errët e planetit

DO TË KTHEHEM, NËNË

Sa fort më mundon
Vetmia, o nanë
E votër braktisa një ditë
N´vendlindje ishte vjeshtë
Tani vonë
Të presin të korrat e brengat

N´mendime më ke tretur
Tani, o nanë
Për birin që të la në vetmi
Shikimi im kah dera, kah dera më përgjon
Trokitje të lehta dëshiron

Kthehu shpejt më ke pasë thënë
Se brengat më kanë molisur
Të presin shokët në varr nën bli
Porositë e babait tënd

Kaluan pranvera dhe vjeshta, o nanë
Që kur të ndjell veç një kthim
Nëse vetë nuk do të mundem
Do t'i them birit tim
Në vendlindje të shtrojë çdo gëzim

Të lutem jeto me shpresa, o nanë
Se dikush një ditë do të trokllojë
Në atë votër ku së pari zëri im jehoi
Andej nipat do të ngrejnë shtëpinë



Jusuf Hykaj 1951-2012

HIMN LIRIE

Thërrasin nënat, thërrasin fëmijët
A ka burrë, a ka djalë mbi këtë dhe
Jemi lodhur gjithë në pritje, gjithë në vaj
A ka burrë, a ka djalë mbi këtë dhe
Të shërojë këto zemra të lënduara
E të etura për liri

Seç u duk tek zbret nga mali një ushtri
Vjen Ademi, Fehmiu e Xheva
Sokoli, Mujdini, Endriti, Afrimi
Vijnë, vijnë, vijnë...
Në front janë rreshtuar

Për lirinë e kësaj toke
Heronj, dëshmorë e martirë
Gjaku juaj aromë lulesh në liri
Vajin, gjëmën, lotin tonë
E larguat përgjithmonë

PROMETEU ERDHI NË KOSOVË

Zeusi gjuante me rrufe vrastare
po Prometeu erdhi në Kosovë.

Diku në mes tokës e qiellit
e hapi shkollën e parë.

Luleyjeve filloi t`ua mësojë
alfabetin e zjarrit
pastaj e puthi në ballë
rrezen e parë të mëngjesit…

E puthi në buzët e çelura si lule
në gjinjtë e gufuar si qumështi
e puthi.

Erdhi Prometeu në Kosovë
siç vjen rrezja e diellit në pranverë
e filloi t`ua thërrasë emrat
nxënësve të tij…

EKSPEDITË NË VEPRËN ARTISTIKE

Forca të mëdha policore
nga të gjitha anët
E sulmuan veprën artistike
Për ta bastisur
Për t'ia arrestuar
Idetë
Mesazhet
Personazhet...

Me thika parahistorike
Po i prejnë
Kapitujt, paragrafët, fjalët, rrokjet...

Personazhet e akuzuara i gjetën
I rrahën
I fyen
E pastaj i arrestuan
Me pranga në duar
Me hekura në këmbë...

Tash po e kërkojnë lapsin
E dorën që e mbajti...

JETË GDHENDUR MBI MERMER

Stina me duart e portës së shpirtit,
këput gjethe klorofili nga hapësira e pambuluar,
aty ku vetulla e dritës në breg horizonti
nga dielli është harruar.

Nga Vushtria
kalldrëmeve rrugën merr poezia,
pas kalasë, urën e gurit kaloj
tek Kulla e Jasharajve
në Prekazin legjendar qëndroj.

-Çohu, Adem Jashari!
Heroikja Drenicë të thërret
Të thërret Afetja, Idajetja, Igballja e Liria,
Besimi e Kushtrimi e të tjerë,
me emra të bukur si jeta vetë…

Ku janë sytë e tu në dhimbje rritur,
Në ëndrrën për liri me gjak ujitur?
Më thuaj ku ta mbjell një lule vargu
për trimat e Prekazit,
që u shuan tek pragu?

Me buzëqeshjen tuaj ujis qiellin
Ëndrrës suaj të zhuritur për liri
Dhe këpus në 22 copa diellin
Që mbi kryet tuaj rojë rri.

Dhimbja djeg horizontin
Duke përzhitur diellin me ajrin
Që heshtur përvëlon
E heroizmin tuaj përjetëson.

Jeta juaj gdhendur mbi mermer
nuk shkoi kot,
Kosova në liri jeton sot!

ASHTI YT PËRMENDORE
Heroit legjendar Adem Jashari

Me ashtin tënd burrëror
janë ngritur monumente në Kosovë,
më të bukura se skulpturat e Mikelanxhelos,
si Liria lule bozhure në ballë.
Retë e zeza me korba Karpatesh
mekeshin para burrërisë drenicare,
kur botën memece trondite
me shpirtin diell të Jasharëve.
Heshtja e ligjvënësve me leprozë
përballë krimeve mesjetare serbe
digjte e shkrumbonte vetveten.
Nga gjaku i burrave kosovarë,
si ndër legjenda e drama shekspiriane,
lindte Adem Jashari legjendar!
Brenda në kullë ndër flokë të argjendta
endnin gratë trimëresha të Jasharëve
pelerinën e Komandantit legjendar,
me emblemën e UÇK-së në ballë.

Brenda kështjellës së Prekazit
nga frëngjitë pashë mijëra dritëza,
flakë skuqeshin dhimbjet në hënë
Baladat shkrepnin vetëtima...
Lotin e mërgimtarit pikova mbi varre
kur krahëdridhur vështroja Drenicën,
te një fjongo dielli ngjyer në gjak
në ballë trimash mbetën sytë…
Edhe zogjtë ligjëronin shqip:
kudo ku rriten trima gjithë nur,
janë prej Kosove, nuk tremben kurrë!



MONUMENTI I LOTIT

Sa lot janë derdhur
për ty nënokja ime Shqipëri,
sikur të kishim mundësi për t'i mbledhur
me siguri do të krijohej një oqean i tërë,
ndoshta oqeani më i madh
në gjithë rruzullin tokësor.
Është loti i brezave, kur pushtuesit panë me sy,
është lot i vashave për të dashurit,
që u arratisën nga aty,
është lot i pleqve
për fëmijët që i lanë në vetmi,
është lot i bijës,
që s'u ndodh pranë në vdekjen e nënës,
është lot i fëmijës,
që rritet pa parë baba me sy.
Janë varret e prindërve,
që u mbuluan pa një grusht dhe të burrit,
është lot im që çan palcën e gurit.
E si kalë i azdisur vrapoj nëpër shekuj
për të qëmtuar brengat e qëndisura në shpirtra,
që pena ime bashkë me skulptorin,
të ngrenë madhërishëm, Monumentin e Lotit.

DIALOG ME ADEM JASHARIN

More praroi dielli, more praroi hana,
Zhuj Selman, more s'ban ma nana...

Kur kënga humbi zërin
Pushka mbeti pa zot
Koha u ndal
Bac,
Nuk u krye!

Ata ikën
Në darkën e dreqit
Me vete morën dhe emrin tënd
Frikë të mos kenë nga terri,
Bac,
Nuk u krye!

Unë amanetin tënd
E kam varur rreth zemre si hajmali,
Nga abetarja mora shkronjat
Për të të shkruar...
Ata po dehen nga gjaku,
Bac,
Nuk u krye!

DY KRENAT E SHQIPONJËS NË FLAMUR

Njëra
skajërisht kthyer majtas,
tjetra
në ekstremin e djathtë.
Në një tendosje të mundimshme qafat,
në një dhembje shekullore të gjatë.

Në njërin sy
vrundullojnë erëra të ftohta dimërake.
Në tjetrin
sërish nga ferrat rënkojnë manushaqet!

E shikojnë të huajt e i thonë:
“ Shqiponjë me dy krena, çudi?!”
Përgjigjet syçelta shqiponjë:
“E si mund të kem unë vetëm një kokë,
gjersa trupi im qëndron akoma i ndarë më dysh?!

Prishtinë, 1973

KRIHEN QIEJT

Sytë e mi të etur për dritë
Vrapojnë me gulç të pinë perëndimin e diellit.
Ç'të bëj sonte me këtë qiell?
I pyeta malet,
Malet e rënda,
Përmendoret ku mbështetën kokën të rënët.
Dhe malet më thanë të marr prush nga yjet,
Ta çoj në vatrat që ndezën zjarret,
Të mos mbeten kurrë pa prush.
E duart i zgjat drejt qiellit sërish
Marr yje dhe vetëm yje,
Të moçmit t'i dredhin nëpër duar si tespihe
Tek çlodhin bastunët e ngrënë
Pranë lulishteve ku liria mbjell trëndafilat.

I pyeta prapë malet e rënda:
Ç'të bëj me dy arushat?
Ato prapë më kujtuan të rënët
Dhe prapë me yje m'i mbushën grushtet,
Po ua çoj syve të porsalindur
Për t'u treguar nga vjen e lirisë udha.

Duart fluturojnë drejt Kashtës së Kumtrit
Për të stolisur gushën dardane,
Për t'i thënë bacë Ademit:
Kurrë nuk do ta lëmë të uritur lirinë e mbramë.
Tani le të krihen qiejt,
Le të bëhen të bukur para hënës.

LIRI

Të shoh në fytyrën e fëmijëve
Të shoh në mirësinë e nënës
Të shoh në burrërinë e babës
Të shoh në dashurinë e së dashurës
Ende nuk të shoh në vendin tim.

Schlüsselfeld, 24.6.1993

ACARI

Kur vetmia të rrethon,
Robëria të bëhet kurorë.

Kur në log thahet rrapi,
Atdheu mbulohet me borë.

Kur një vend mban xhelati,
Krijuesit akulli i mbulon.

Atëherë Bota kthehet mbrapa
Truri i kombit nuk punon.

Mihal Hanxhari 1930-1999

ELEGJI PËR KOSOVËN

Zot, nëse njerëzit s'dinë të shohin sot
Dhe nesër askush s'do ketë më sy,
Shpëto o Zot vetëm sytë e fëmijëve të Kosovës,
O Zot shpëto ata sy të kaltër të peshqve blu
Që flenë në shi dhe ëndërrojnë engjëjt e tu.

Zot nëse zërat e çmendur s'do pushojnë
Dhe tamtamet do përplasen në kupën e qiellit
Dhe klithmat e marra do qeshin e do thërrasin,
Zot shpëto ato heshtje të pleqve të Kosovës
Që flasin me brazdat e baltës plot ujë të vjetër
Ujë nga shiu i parë i botës që njomi këtë dhe.

Zot, nëse s'do ketë më vend në botë ku të lindin nënat,
Oh lëre o zot atë rrugë të gjatë ku nuset e Kosovës
Po lindin yjet e Yllnajës së Mjellmës,
O Zot ato janë foshnjat e tua.

Dhe në s'do ketë shenjë delyzhi ku pirgu do bëhet
Gropë dhe gropa kodër, mbill nëpër rrugët e Kosovës
Dyqind qiparisa, dy mijë qiparisa, dyqind mijë qiparisa
Dhe dy millionë rrape o Zot
Dhe ai do jetë pylli i parë i Lirisë në botë.

Tiranë, prill 1999

RREZE IDEALI

Kur jeta po çjetësohej
Dikujt gjaku po i ngrohej,
Në atë kohë rezistence janari
Udhëtonin dy shokë rreze ideali.

Seç valëviteshin flamujt e gjakut si era
S`iu dhimbej jeta, s`iu dhimbej pranvera,
Kujt këtu kaq bukur i këndoi fjala
Dy krisma lirie Nuhi Berisha e Rexhep Mala.

Po ia masin dhembjet atdheut shokët e idealit
Në bodrumet e qytetit e lisat e malit,
Të pandarë në vitet '80 në ato radha
I ngushëllon e bënë krenarë Jusuf Gërvalla.

Dy fjalë, shokë, amanet po jua lëmë
Pa liri s`ka ditë, ka vetëm natë,
Në luftë me luftën u bënë flakë janari
Flamur e shqiponjë në altar flakadani.

Seç i burgosën e nuk burgoseshin
Seç i vranë e nuk varroseshin,
Le të ngrohë janari e detit t'i trazohet vala
Lindin e rilindin Nuhi Berisha e Rexhep Mala!

NËNË SHQIPËRI

Sa trima ikën syhapur
sa trimëresha nuk i mbyllën sytë
sa heronj nuk i prehu qetësia
sa breza toka nuk i qetësoi
as sot
nuk u bë Shqipëria
dhe sytë nuk i mbyllën dot.

Nëntori erdhi
dhe do të ikën prapë
e prapë do të vijë nëntori i ri
prapë do të bien shqipet si me le
atdhedashësit do të bëhen fli.

Do të biem për ty tokë arbërore
do të biem
deri atëherë
kur të bëhemi një,
do biem për ty
Nënë Shqipëri
Nënë Shqipëri!

SOFËR HERONJSH

Do të mbledh në një sofër heronj
ashtu rënduar me plumba në trup,
si u copëtua Shqipëria t'u tregoj
pa Kosovë, Iliridë e Çamëri në trung.

Do t'mbledh trimat e Libohovës
bashkë me të Drenicës e Dukagjinit,
burrat e Malësisë dhe Maleshovës
tok me të Shkodrës, Shkupit e Ulqinit.

Në një sofër që flet vetëm shqip
në shekujt që psherëtijnë me kilometra,
t'u flas për gllabërimin e pacipë
për krahëprerën shqipe me dy krena.

Në sofër të heronjve me të bardha ëndrra
buka, kripa dhe zemra kurrë nuk sosi,
si atëhere dhe sot, mbi gjak gjëmon kënga
për kombin e Shqipes, që hasmi kurrë s'e mposhti.

Me të bukurat lule nga Kosova,
borzilok prej Shkupi dhe çaj nga Epiri,
trëndafila Shkodre për Ju mblodha
në sofrën bujare me fisnikëri Iliri.

Amanetin e trimave koha s'e tret kurrë
shqiponjat fluturojnë mbi tuajat varre,
vijnë t'ju flasin, t'ju shohin si dikur
të gjejnë forcë për Shqipërinë hallemadhe.

TE RRASA E ZOGUT NËN RRASHTË

Dëshmorit Kolë Mirdita

1.
Dashuria për Tokën
Amën e saj e kishte
Atje ku lindte e perëndonte
Ylberi i hershëm.

Ua tregoi rrugën
Në agun e jetës
Dhe sa bukur u mbështollët
Me petkun e tij shumëngjyrësh.

I dhatë fjalën gurit
Një ditë jo të largët
Të takoheni në Koshare
Te Rrasa e Zogut,
Te ai Gur i Gjakosur
Dëborën ta shkrinit.

Po atje Majë majës
Rilindur kishin edhe shumë ylberë të tjerë
Dukeshin sikur fluturza,
Dashurinë për Rrënjët e së Bukurës
E kishin të vjetër.

2.
Atje nën shkëmbinj, te Rrasa e Zogut lart
Kurrë nuk do të flejë gjarpri që jetoi aq gjatë.

E thyet acarin, në kufi shkritë dëborën
Rrënjëve të së Bukurës ua sollët Vlorën.

Shumë kohë më parë me Agimin
Rrashtës së Tokës ia patët dhënë premtimin.

Në Kosharen Legjendare te Rrasa e Zogut
Bukur i dhatë dritë Shpatit dhe Logut.

3.
… Do ta lidh
Tënden plagë të gjerë, ndezur me gjak shpirti
Dhe, prapë –
Në qoftë se ato plagë pikojnë
Në trastë do t'i mbledh kujtimet,
Mbi varrin Tënd mermer
Do të vë buqeta lulesh të bardha.

Mbuluar me ndriçim agimesh
Që do të rilindin
Tëndin Emër!

LEGJENDË NDËR BREZNI

Hape krahët si shqiponjë
Albanikut i dole zot,
Sot u bënë gjashtë vjet
Andej Llapi është tubuar
Në kullë lirinë për ta festuar.

Rruga jote rrugë e lavdisë
Ademi, Syla e Remi pllakën zbulojnë
Mijëra vetë sot vdekjen tënde lakmojnë.
Albaniku krahëhapur të gjithë i pret
Derën e madhe ti ua ke çelur vetë
Andej heroikisht re për të sotmen liri
Nderi dhe lavdia shkëlqejnë mbi ty,
Ishe Oso Kuka i Llapit,legjendë ndër brezni.

FLAKADAN I LIRISË
Dëshmorit Haziz Tolaj

Nëpër dritën e shkëlqimit tuaj
Mësuam si ngroh dielli,
Nëpër ditët e bardha
Ti mbete lulëkuqe
Me syrin kah qielli,
Mbi lapidarin e atdheut,
Haziz i nënlokës.
Me shkëlqimin e syrit tënd
Na ndeze dritën nëpër mote
Në Prizren e Kosovë të agojë ditë e lirë.
Sa bukur po të rri kënga
Në gojën e Lirigëzonit tingulli i lirë
E vogëlushëve ballartë u lexohet ëndrra.
Ti flakadan i etjeve të mëdha
Pishtar drite majë Koshareje, Aziz baba!
Me amanetin tënd do t'i ushqejmë brezat
Si ta duam lirinë,
Si ta ruajmë atdheun.
E pushkën tënde
Do ta stolisim me lule në muze,
Vargjeve të poetit do të zgjohet
Këngë e brezave, Haziz o vëlla!
Në shaminë e nënëlokes, nuses e fëmijëve
Ti përherë do të mbetesh
Këngë e dhimbjeve krenare,
Lulëkuqe e Kosovës, Haziz o trim!

HARUN ALIU

Kreshnik Haruni u frymëzua
Idealin ta ndjekë pa pushim,
Për liri e atdhe u flijua
Jo për marrëveshje pa çlirim.
Në Ohër shkau kish mashtruar
Se do të jepte "të drejta",
Haruni nuk ish dorëzuar
Ai e dinte ç'është e vërteta.
E dinte se sllavi s'ka besë
Se për liri kemi një shpresë.
Goditi fort dorën gjakatare
Në luftën çlirimtare
Deri në fund e flijim
Një jetë të tërë për ribashkim.

MBI FRËNGJITË E TRIMËRISË
Skërdilajd Llagamit – Komandant Shpendit

Familjes Llagami i ra biri,
Shpirt i bekuar, luftëtar më i miri,
Që u ngrit mbi frëngjitë e trimërisë
Për të ribashkuar tokat e Shqipërisë.
Skërdi fluturon mbi qiellin e Arbërisë
Si Shpend që ka thyer vargonjtë e robërisë.
Udhën drejt lirisë e përshkoi
Edhe kur plumbi i armikut e qëlloi.
Mbi male Skërdi edhe sot jehon
Ortekun e armikut ndalon.
Kufomën e pushtimit gropos
Gjithë shqiptarët armatos.

SHQIPONJA

E shohim
herë
në Gjeravicë
herë në Korab

i afron largësitë

Një sy në Shqipëri
tjetrin në Kosovë

i afron lartësitë

I sheh bashkë
Ilirinë dhe Dardaninë

shikimet shgjetë

Një krah në Korab
tjetrin në Gjeravicë

Ne dhe shqiponja
shikimin e kemi të përbashkët.

HASAN PRISHTINA

Në lartësi të zgjuar
portret i kombit
-Hasan Prishtina

Një sy në Kosovë
tjetrin në Shqipëri

Rruga e shikimit
tej kufijve të etjeve
të tokave të ndara
nga atdheu ynë i lashtë

Në arkeologji
të dashurisë
përmendore e yjeve
-Hasan Prishtina.



MIRËNJOHJE DËSHMORËVE

Në sytë tanë
varret tuaja

Në shikimet tona
përmendoret tuaja

Në zogjtë tanë
kushtrimi juaj

Në zemrat tona
gjaku juaj.

LUGINA E PRESHEVËS

Dashuria e ndrydhur
pritja i afrohet pritjes

krah i lidhur i Kosovës

Dhembja jonë
ka edhe sy

Lugina e Preshevës dhe Kosova
rrugën dhe stinët
i kanë të përbashkëta

Nuk jemi larg
jemi afër

Luginë e Preshevës
-luginë e pikëllimit tim.

LUFTËTARËVE TË LIRISË

Për pak më shumë ajër është djegur zemra jonë
Bash si zogjtë që duan dritë qielli,
Po vandalët deshën të na përpinë
Të na merrnin dhe këtë hise dielli.
Toka jonë e përpirë mes heshtjes
Për trimat e lirinë gdhend monumente.
Zoti dhe kombi ju dha fuqi, o luftëtarë
Botën rrenacake ta hidhnit në humnerë.
Ju perden e zezë na hoqët nga syri lotmbushur,
Vdekje tradhtarëve që kurrë s'e kuptuan!
Bota për ne pambuk veshëve kish vënë
Shqiptarët t'i mbyllnin në kafazin e pranguar,
Po bota e shkieve u përmbys, rrokullis si gur.
Ne nuk lypëm as copën e bukës
Jemi në tokën ku gjyshi mbolli grurë
E s'jemi fajtorë se duam diellin e bukur.
Ne kemi një qiell e s'duam shurdhëri
Kemi ndërgjegjen që ju trima na zgjuat.
Mes kroit të bjeshkës duam të flasim shqip
Në djepin e foshnjës ninullën e gëzuar.
Pushka juaj trimërore ishte shpresë e rizgjimit
U zhduk mëshira bastarde e gënjimit.

BALADË E PRINCIT TË PAVARËSISË

Heroit të Kombit Isa Boletini

Po vjen larg prej Mitrovice, ndalka vrapin mbi Tamiz
Po trokon ai hap ndër vite, na zgjon ëndrrën për lirinë.

Plis i bardhë po i sjell borën, që thinj malet, fushat, detet.
Ka një këngë për Kosovën, që ia zgjoka amanetet.

Ka ca dallgë që sjell nga Vlora, ku flladitet Pavarësia
Le të sjellë gjëmime koha, jo nuk shuhet shqiptaria.

Vjen një hap që zgjon lahutën, po zgjon malet ngjyrëgjaku
Ta dëgjojë mbarë Europa si flet Isa fjalëbajraku.

Brezi i tij me dy revole, gjoksi tij me dallgë bese
Nëpër vitet madhështore, urtësia mund tërmete.

Vjen nga Ibri si plis bjeshke, nuk e tremb lugat i zi
Lavërtar - o pas parmende, po sjell farë për mbrothësi.

Mjegullon Tamizi netëve e gjarpëroka nëpër ura,
A s'e di Londër me mbretër se të kanë ardhur burra?

Ulet prapë në gjunjë e hesht e flamurin puth ngadalë
Shumë rrugë ka lënë pas krahësh e sot shiu i ftoh ballë…

Kujton trimat systralli, ardhur larg - o nga Preveza
Kujton sonte Malo Burrin, mjekërthinjur si legjenda.

Dhe mes borës merr filizin, që merr jetë nga palcë e tokës
Kapedan Isë Boletini fjalë të re i thotë Europës:

"Kur t'i humbë diellit rrezja dhe kur hëna të mos ndrisë
Do na gjeni në bedena, në shërbim të Pavarësisë.
Do na gjeni tok bashkuar si dy duar që shtrëngohen
Do na gjeni gjunjëzuar pranë një varri e një shkronje."

TUPANI I FJALËS GËRVALLIANE
Heroit të Kombit Jusuf Gërvalla

Emrin e ka Kosovë
dhimbja jote uragan, o poet jetëkëputur!
Emrin e ka "telnajë"
ajo udhë me hapa të pahedhura në kohë.
Do të flakadonim nga mot
fjalën dhe ehon e gjoksit të bukur
Dhe për ty do të thurnim
të gjithë një qiell të ri, pa u tutur nga shqota.

Shkronjat e përgjakura
u bënë male të larta malli e trishtimi në tela kitare,
Qielli u bë Kambanë
që tash sa mote për ty lëshon e lëshon piskama.
Kanë hapur dyert kullat
për vargun qelibar e të pathënë, bash si farë e re brazde.
E qepallat e gjumit
shumë herë për ty nuk ua mbyll as dita, as muzgu, as nata..

Pemët të flasin lumnueshëm
kur fëshfërijnë mbi to lule e gjethe lisash.
Nënëloket ta përcjellin
ninullën e jetës, ani pse u bëtë vrik burra.
E këngët e tua të kristalojnë
mbi plagët e trimave si fllad rudinash.
Lodrat ta përcjellin
Mortin si dasmë ku vallja po duket si gurra.

Të ujëvarojë
pikëloti i motrave dhe i nënave mbi sofrën e shtruar.
Lum toka që ta lartoi
mbi Drenicë këngën dhe ëndrrën sydëlirë!
Për ty do ta gjejmë
lulen e fundit të truallit lirietur, gjoksstralluar,
të ta vëmë tek mermeri
i bardhë si testamenti i pavdekësisë.

Vjeshtat vjeshtojnë
në Deçan e Gjakovë ku dëgjohen kaherë ortiqe,
nipërit kanë kohë
i ringrejnë kulmet, oxhaqet, odat.
Ylberofsh miku ynë
në shpatet bjeshkatore gjer në Çamërinë me ethe,
kitarën le ta marrin
zogjtë e pëllumbat për të kënduar nëpër votra.

E molisja mos na breftë
shkëmbin dhe djepin e djalit.
Shkronjat e këngëve
dhe abetaren e trimave kurrë të mos na shitojnë.
Amanetet të kthehen
në gjëmime tupanësh a në një brazdë të ngrohtë ugari,
e në theqafjen e fundit
le të bjerë zezona që frymën një ditë ta faroi.

PREKAZI I KRENARISË

Në përvjetorin e madhështisë së dehur
Prekazi i krenarisë së pamposhtur arenë zgjimi
në themelet e urave,
uratë e shenjtëruar për agun e trëndafiltë
me hirësi të shpalosura.
Kullat simfoni të ndezura epike
me qëndresë të rrallë mitike.

Në fokus Bardi Adem Jashari
Perlë në përjetësi të kohëve me pelerinë hyjnore
që bartë lashtësinë e rrënjëve
thellësive të zemrës,
përherë në cep të krahut me pagëzimin e përtërirë.

Bac i vrullit në pikturime,
legjendë e paepur në përballime
me vështrimin rrezatues të theksuar
për frymim të derdhur melodik
anë e këndë Kosovës,
trinës së trashëguar.

Marsi i harkut frymëzues
oshtimë me shkrepëtima
mbi kurora malesh të dëlira
etjen për ta shuar
me dashuri të ndezur shpirti.

Vargut sonetikë me rima purpuri
ëndrra e eshtra heronjsh prush
çmendur nga flakërimi
me vrulle të pashuara guximi
për këndet e plagosura të atdheut
nga ngufatjet e përdala.

Në tela sonate 63 qirinj drite
flakadanë përmasash të derdhura
lartësive brilante të etnisë

Nata e Zjarreve në Prekaz
pelegrinazh i pëlcitur
mprehur hovesh të rrufeshme,
baladë e thinjur hapërimeve
në nderim brezave sfidues
që rrëke derdhën gjakun
me rrjedhën e kohës për të ecur,
thërrmon vetminë e kaptuar nga thellimi
mbi gjurmët e ruajtura
dhembjen e djegur nga përmallimi.

VRASJA E POETIT
Kushtuar Jusuf Gërvallës

Të vranë, he i qëlloftë moti
ata njerëz më të zinj se nata!

Kur të mori plumbi parë
u dogj një pishë në majë të Sharrit.
Kur të mori plumbi i dytë
doli nga varra një tufë pëllumba
dhe u nis fluturim për Pejë.
Kur të mori plumbi i tretë
gjaku yt pikëloi mbi botë
- mbrëmë vranë Jusuf Gërvallën!

Kur të dalin gjethet e reja
do të ulet qyqja në degë të blirit
por s'do të thotë: "kuku Jusuf!"
ti nuk je baba i pa djalë
as nuk je vëlla i pa vëlla.

Sot je vëlla me ata që s'vdesin,
je vëlla me brezat që vijnë,
se gjakun tënd ia fale diellit!
Të vranë natën, he i qëlloftë moti,
pa i puthur edhe njëherë fëmijët,
pa e mbaruar vjershën e re,
pa i mbushur dhe njëherë sytë
me re e zogj që vijnë nga Jugu,
pa kafshuar edhe një mollë Peje...
Agimi që shkrepi mbi dëborë
kishte kuqëlimin e gjakut tënd.

TESTAMENTI I LOTIT
Të pagjeturve

Në natën bizantine pa hënë
ne jemi plaga më e re
e Gjergj Elez Alisë,
kur hienat korbzeza
na rrëmbyen me dhunë
në prag të Shtëpisë.

Na ka mbetur vetëm shpirti
midis robërisë dhe Lirisë
midis Jetës dhe vdekjes.

Sot imazhi ynë
varur në grilat e Kuvendit
është odiseja jonë.

Në ritualin e Pritjes
testament i lotit
lëbyrur nga dielli
lagur nga shiu.

Le të ndizen qirinjtë
të ngrohet shpirti
në dritën e Lirisë,
kur zemra ka dhimbje
për eshtrat e humbur.

Ëndrrat e trishta
në pentagramin e mallit,
në ritualin e Pritjes.

Nuk duam të jemi
mjet kusuritjesh
në sofrën e djallit.

Liria nuk bën tregti
as me robërinë
as me vetveten
as me hijen tonë.

Ne nuk jemi të humbur
jemi në themelet e Lirisë.

Të humbur janë ata
që ende jetojnë
në iluzionin e imazhit
të vdekjes sonë.

TË KËRKONIM, KOMANDANT
Ismet Jasharit - Komandant Kumanovës

Të kërkonim nëpër male
nëpër shkrepa e livadhe
të kërkonim te Drini në Lumbardh.

Të kërkonim në Kaçanik, në Karadak
nëpër male gjithkund në Gallap,
të kërkonim në Deçan, në Junik
në Grykë të Carralevës, në Dukagjin.

Të kërkonim maleve të Berishës
bashkë me dëshmorët e Drenicës,
të kërkonim në Grykë të Llapushnikut
majave maleve të Pashtrikut.

Të kërkonim, Komandant, o sa të kërkonim,
për ty në Malishevë fjalë - besë kishe gjithkund.

Të kërkonim, të kërkonim natë e ditë,
të kërkonim aty në konak në Luzhnicë,
të kërkonim në Therandë, në Shirokë,
të kërkonim gjithkund në Kosovë.

Të kërkuam shumë e dikur të gjetëm
të thamë, o Komandant, kjo është Kleçka,
kjo është Kleçka me djemtë e lirisë,
në ballë u prin ti, o vigan, o Hero,
në ballë u prin ende në altarin e Lirisë!

KURORË BURRËRIE
Agim Ramadanit

Loti për ty s'ka shterur kurrë
Tek ne mbete kurorë burrërie
Gjaku yt theu kufij me gurë
Ishte më tepër se një radhë ushtrie.

Kosharja ishte për ne apokalips
Atje shtigjet e pashkelura u bënë pre,
Ushtarëve ua mposhte çdo frikë
Luftëtarëve iu bëre fole.

Ah, ti trim mbete pishë ndër mote
Me ty krenohemi të gjithë shqiptarisht,
Sa hije të kanë ty ditët në përvjetore
I dhe kuptim jetës sonë dhe shumë dritë.

Stolisur e ke flamurgjakun në përjetësi
Që nga shtatorja çdo ditë na përshëndet,
Sa mjeranë u treguan armiqtë shpirtëzinj
Kur menduan se lirinë mund ta vrisnin përjetë.

O Zot, a mund të vritet ky ideal,
A mund të shuhet kënga e rinisë së gëzuar
Nga ata që lanë pas vetes dhimbje e gjak,
Nga ata që mendojnë veç për popuj të pushtuar.

Ndal thirrre, ndaluni se ka një fund vrastar,
Mos i vrisni foshnjat në përkundje!
Ata që vrasin lirinë janë të mjerë, barbarë,
Ata që lënë djerrinë janë të mallkuar përjetë.
Ke qenë dhe sërish AGIM do të mbetesh
Ndër breza si yll i rrallë kurrë s'do të tretesh.

KOMANDANT LLESHI

Po vjen krisma maleve tona
Pushka kris, toka thërret
Mal më mal shkon jehona
Pushkë e trimit godet rreptë.

Lart atje në shpate, brigje
Në rresht presin ca ushtarë,
Vjen ngado një frymë lirie
Grykë më grykë e mal më mal.

Komandanti ballargjendtë
Djemtë në radhë i numëron
Dhe pa rroba e pa ngrënë
Vendit tonë i dalin zot.

Dhe fytyrës i bie drita
O, sa shumë qënkan rreshtuar,
Nëpër male zënë prita
Frika sot qenka larguar.

U hutuan armqtë barbarë
Pozicionet duke lëshuar,
Tmerr i vdekjes i ka marrë
Këta korba të sterruar.

Sa shumë malet po gjëmojnë
Nga po shkon Komandant Lleshi,
Këngë lirie po këndojnë
Për atë trim yll ndriçojnë.

ATA QË NUK VDESIN

Nëse më pyetni:
Dëshmorëve të Kombit nga u erdhi fuqia?
Unë ju tregoj.

Nëse më pyetni:
A luftuan ata për emër a për Liri?
Unë ju tregoj.

Nëse më pyetni:
A u shkrua për ta në histori kapitull i ri?
Unë ju tregoj.

Nëse më pyetni:
Kosharja, Loxha, Prekazi e Gllogjani
a janë djepe trimërie?
Unë di t'ju tregoj.

Nëse më pyetni:
A jetojnë dëshmorët
e një datë të lindjes kanë?
Unë ju tregoj.

Në Parajsën e Pavdekësisë
jetojnë dhe do jetojnë gjithmonë.

NDERI I KOMBIT
Sali Çekut

Sa më duhen sonte shkronjat
Të rreshtoj vargje lirike
Për dëshmorin nga Kosharja
Mikun e fëmijërisë jetike.

Se për trimin do të thur këngë
Për atë trim të tokës sime,
Sali Çeku, burrë i shqipes
Shkel kufirin me një hap.

Natë e shurdhër heshtjen plas
Bubullima e nëntëmbëdhjetë prillit,
Hëna lëmon fytyrën e bardhë
Si të ish vesë e trëndafilit.

Vesa puth buzën plasur
Me kristalet e rrapit të lashtë,
Gur i ndarjes me helm mbushur
Lajmin nënës kush t'ia japë.

Rrudhë e ballit si hulli
Rreze dielli bie në sy
E në shtat filizi gjallë
Mugullon si bar në livadh.

Miku im diell herak
Një datëlindje ruan nën rrap,
Për Lirinë e Shqipërinë.

SHKUNDULLIMË
Rexhep Malës

Në nismëm e jetës
Krismë bëre me fjalën
Kur botërisht munde frikën.
Atëherë duartrokitën ëndrrat
Zemrat trokitën në portën e mbyllur
Të atdheut të nëpërkëmbur.
Ti Rexhep Mala
Zbërtheje enigmën shekullore
Me fjalen tingëllimë
E veprën bubullimë.
Detyrën atdhetare e mbaroje
Pa kurse e diktate
Në takime legale me shokët
Zgjidhje nyjat me dinjitet
Për brezat e ardhshëm testament.
Ti shkrive natën në ditë
Për t'u dhënë luleve ngjyrë
Me Nuhiun krismën bëtë jehonë
Atdheut i vutë kurorë.
Shkundullimë ndër mote
Fjala e vepra jote!



LISI
Metush Krasniqit

Kurrë nuk fole për vete
Virtyt kishe
Dashurinë e trimave,
Përherë hape udhën e fatit
Për tokën e lirë.
Çdo ditë e burgut tënd
Lindte nga një flamur
Që ngrihej në ballë.
Gur më gur bashkove
Për të ngritur kala
Në këto troje të lashta
Të tokës Arbërore.
Bacë Metush,
Jetën e bëre mal me këngë
Malin lis mbi lisa
Atdheun plis mbi plisa.

ZAHIR PAJAZITI

Lindur rritur në Kosovë
Në Malësi të Gallapit
Si sokol djaloshar
S'del kush hapin t'ia ndalë.

Lindur rritur shqiptar
Nga familja atdhetar,
Për trimëri s'i del kush para
Me besë burri shqiptar.

Ai Miloshit po i çon fjalë
Mos gabo e prek shqiptarë,
Mos ço dorë, as shuplakë
Pushka ime të djeg flakë.

Pret një javë e pret shumë ditë
Shkau zullumin s'po e ndal,
Trim Zahiri si petrit
Merr grykëhollë i del në pritë.

Ktheje kryet o shka i zi
Për ty sonte kam ardhë n'shtëpi,
As të ha, as të pi
Veç ta shoh atë ballë të zi.

Zahir trimi, djalë dai
Fort grykëhollën kish mjeshtëri
Si rrufeja me vetëtimë
Në ballë shkaziut po ia shkrin.

Ai grykëhollën kish shok
Me guxim i doli zot.

NGJITJE NË HISTORI

Kur ra Muri i Berlinit
Ai ishte gati katërdhjetë vjeç,
Ajo shumë më e re ishte
Diçka e re po lindte në mes.

Frynë erërat e stinëve
E nisi të shembej pushtimi,
Në Atdheun tim lufta pat nisur
Shumë vjet më herët.

Ademi, Luani, Zahiri
Muhameti e Afrimi
S'bënin fjalë me barbarin,
Veç me tyta pushke.

Fehmiu e Xheva
Iu ngjitën historisë,
Unë porsa u burrërova
U bëra ushtar i lirisë.

Ata marshonin kudo Atdheut
Me diellin e lirisë në sy,
Kur kujtonin se kanë vdekur
Ringjalleshin në dritë.

BALADË PËR HEROIN
Isa Boletinit

S'ka rëndesi në e panë
Kur kaloi Grykën e Llapushnikut
Kërceu matanë Fushë - Mollën,
Ai tashmë çante natën
Vetëtimë e bubullimë.

Pakkush si Ai atëherë
Ia ndiente gjëmën Atdheut,
Kur lakuriqët e Natës fluturonin
Midis të gjallëve.

Ata qenë zgjuar një çast
Hije e flakë rreth varreve,
Ofshamat mbyteshin në dhimbje.

Përjetësia i merr në gji
Dritësorët,
Një Zot e di
Kur do të zgjohen të gjallët.

TRE LISA
Dy vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës

1.
Ti Jusufi ynë ke mundur të jetosh sa De Rada
Sa Noli ynë i madh ke mundur të ligjërosh
Edhe kushedi sa çështje do të këndonim nëpër shkolla
Me dy lisat shokë: Kadri e Bardhosh.
Por dashuri magjike lidhët me Kosovën
Marrëveshje të ngrohtë bëre Ti dhe Ti dhe Ti
Të zgjohen të fjeturit
Lart të ngrinin kokën
Ju tre të dashur, ju kurbanë të rinj.

2.
Dhe nisën themelet e Kullës në këto anë
Si në kohë të lashta, si në kohë mitike
Një „Dans macabre“ bëhet ritual pagan
Tre lisat bëhen viktimë prometeike-
Tre lisat që flasin prore me zjarrmi;
Pse na deshi Kosova na mori në gjinj-
Pse na deshi Kosova na mori të rinj
Të qetë për të fjetur në tokën stërgjyshore
Për t'iu thënë voglushëve: “Vjen pranvera fëmijë”
Lisa të pamposhtur të Tokës arbërore.

DRENUSHA E PLAGOSUR

Mirë se vjen, o mall i hershëm
Edhe pse me kujë e gjëmë
Zbuar nga çetniku ethshëm,
Del ju pret kjo toka Amë.

Zbathur, lodhur, uritur, çjerrë,
Ballin lart, dhembje e paparë,
Djegur flakësh, plumbash prerë,
Veç pse jeni kosovarë.

Ah, o mall i prushëruar,
Mall që na përndrit të parët,
Sekush me ca dhe në duar
Nga varret ku flenë të vrarët.

Rresht i gjatë që s'ka të sosur
Nëpër udhë të lemerisë,
Ah, drenushë e plagosur
Të pret tokë e dashurisë!

TË VDES I BUKUR

Ç'ma shëmtoi të bukurën kjo jetë
e mote nën ankthe më mbajti strukur,
Jam zgjuar nga përgjumja e dal në çetë,
Të vdes i bukur.

Paçka se bota më do flakëzbehtë
T'i shtrohem hasmit që vret për të më zhdukur,
Flak gurin e Sizifit e dal në çetë,
Të vdes i bukur.

Kam pritur aq gjatë një ligj të drejtë
Me shpresë se vjen, po kund s'është dukur,
Bëj ligjin e Zotit dhe dal në çetë,
Të vdes i bukur.

LUFTËTARI I PANJOHUR

Hapen portat e ditëve
dhe njerëzit zbresin në rrugë,
ata që nxitojnë për në stacionet e autobusëve,
ata që ecin të qetë si të papunë;
ata që shkojnë në takim me njeriun e dashuruar;
ata që ulen në kafene
e pinë lëngun e halleve;
ata që ecin kuturu,
pa ditur se ç'do të bëjnë;
ata që shpresojnë se kjo ditë diçka të bukur do t'u sjellë;
ata që s'dinë të lumturohen me pasurinë që kanë;
ata që futen në ministri
e derën e veturës ua hap bodigardi;
ata që rrëmojnë në kazanet e plehrave,
ata që dita u fal një buzëqeshje më shumë;
"Luftëtari i panjohur"
që ngazëllen pa fund,
nën ritmin e jetës së lirë të njerëzve
të këtij vendi…

HOMAZH JASHARISHT PËR PESË MARSIN

1
Kujdes, në parakalim shenja e Prerjes së Epokës
është ajo e Rinjohjes jasharisht.
Para se të marshonte vdekja, ai tha:
do të ketë më pak rënie e më shumë foshnja.
Më shumë fëmijë për luftërat e ardhme,
më pak korba që hanë sytë e luftëtarëve.
Më pak kohë të sertë e hapje të pakufi
të Gjirit të Dashurisë për të gjithë.
Është Kënga e Falënderimit Mëngjesor:
Faleminderit, Kosovë,që nuk vdes kurrë!
E gjallë për Teutat dardane e për Gjergjin e Arbërisë,
të sotmin e të nesërmin.
Jasharisht, liria ligjëron për gjakimet, shpresat,
e di cili është Qëllimi Ynë Më i Lartë.

2.
E lexon dhe e ndien mahnitshëm Plagën e Thellë
të së kaluarës, ende të valë.
Qenien e Plagosur në Palcën e saj të shpirtit,
të bjerrë nëpër ravë të huaja.
Ta dish, këtë ua kemi borxh Jasharëve
dhe Polemit të therur nëpër mijëvjeçarë.
Pa u larguar, së pari kërkoje cili qenka
Hamza Kastrioti në mesin tënd.
Edhe kur vuajmë pafundësisht a kur përgjakemi
për Kushtrime dashurie e lirie.

3.
Kur vjen në Kosovë, te secila fjalë shqipe dëgjon
zjarrin e gjallë të kryengritjeve.
Te secili shtegtim, si një marshim,
sheh flakën e trimërisë deri në vetëmohim.
Nëse dëshiron t'i shfletosh librat tanë të moçëm,
aty parakalojnë betejat e lashta.
Gjithë ajo terratisje e thellë gjiri,
ai mjerim e pikëllim i pafund që ta ha shpirtin.
Ajo hidhësirë loti, ai helm shpifjesh,
pelerinash të zeza a prangash shkretëtire.
Ai mort e mot durimmadh njerëzish durimtarë për
këtë Ditë që vjen Amshueshëm.

POPULLI I DI TË GJITHA
I
Populli i di të gjitha di të flasë di të heshtë

Kur flet
Gurëve të varrezave u hyn shpirti dhe lëvizin
Midis flamujsh dhe rrëmetesh
Ushtojnë sheshet
Bien daullet
Të nisurave iu shfaqen fundet
Sundimtarët janë të qetë

Kur hesht
Si gryka malesh kapërdin rrufetë
Mes dhëmbësh kërcëlluar i shkreptijnë vetëtimat
Gjëmimet i ndrydh në vete
U thotë fjalë të urta i qetëson
Durimin e vet e krahason me të malit me borë
Sundimtarët s'i merr gjumi

Populli i di të gjitha di të flasë di të heshtë

II
Populli i di të gjitha di të jetojë di të vdesë

Herët në mëngjes
Hukat duart të mos i bien përthonjsh nis punën
Te kroi te shelgu pret të bukurën belkëputurën
Bën dasmë gëzimin e ndan me të gjithë

Shtëpinë e mbush me fëmijë
Brez më brez
Shpie kujtimin
E shkon në luftë
Thirrja për liri të atdheut i hyn drejt në histori
Me vete merr armën trastën këngën
E s'pritet e s'ndalet
Veçse në fitore dhe përmendore
Liria s'pret
Duhet për çdo çast

Populli i di të gjitha di të jetojë di të vdesë

III
Populli i di të gjitha di që ka mik që armik

Hap derën e shtëpisë
Ndez zjarrin shtron sofrën
E në sofër bukë kripë e zemër
E ruan për ditë të vështirë
Ia mban besën

Ai e di se edhe uji fle po armiku s'fle
S'ia harron shprehinë e vjetër
Shpatë e zinxhirë farkon për të
Njësoj shikon prapa si përpara
Rreziku që i bie ndesh është një herë rrezik
Rreziku prapa shpine dy herë

Populli i di të gjitha e di që ka mik që armik

IV

Populli i di të gjitha e di që ka cub që hero

Në një mijë ngjyra
Të lyhet e të ngjyhet
Në një mijë fytyra
Të shtiret
Ai cubin e njeh
E hedh në pleh

Në përmendore që ligjëron historinë në shesh
E vendos heroin e vet
Në këngë trimërore
Në metafora
Në fjalë të urtë në konak
E në gjak përjetë

Populli i di të gjitha e di që ka cub që hero

1989

ESE E VOGËL PËR LUFTËN

Lufta është provim pjekurie në shkollë lirie
Kalojnë ata që bien dhe që nuk bien
Të paepurit dhe dëshmorët kalojnë gjithmonë
me sukses të shkëlqyeshëm
Aty ku bien ata vazhdojnë hijet e tyre
Gjithë dritë dhe shkëlqim
Në luftë edhe vetë lufta jep provim
Zakonisht kalojnë të drejtat dhe të padrejtat bien
Kur të padrejtat fitojnë
Luftërat vazhdojnë
S`ka luftë të mirë dhe të keqe
Të gjitha luftërat janë vrastare
Luftën e vërtetë e bëjnë luftëtarët
Luftën e keqe vrasësit
Oh sa koka të mbjella me varre
Luftëtarët qëndrojnë
Vrasësit ikin
Shkrumb e hi lënë pas
Luftërat mbarojnë por nuk përfundojnë
Shprehia për të vrarë nuk harrohet shpejt

Ç`vrasje të çuditshmen në pikë të ditës
Në mes të natës
Qyqarët që nuk kanë shkrepur asnjë plumb në luftë
Vrasin të tjerët
Vrasin dhe miqtë e vet
Liria skuqet nga turpi skaj më skaj atdheut
Lufta mëton të jetë një art
Por arti më i lartë është gjithmonë të ngadhënjesh
Fitoren të kumtosh ngado
Popujt në luftë heqin qafe dikë
Të tjerët që u bien në qafë i njohin më vonë
Atëherë shihet qartë
Kush ka luftuar për liri
E kush për prapanicë të vet
Më e mira është gjithsesi që lufta tymos ketë
Fjala luftë të hiqet nga çdo fjalor
Të harrohet

Por armiqtë a të harrojnë
Varreve të mira lufta për liri
Nuk përfundo kurrë

LAMTUMIRË

Këmbësorët lanë pas atdheun
Shtëpinë duke qarë
E majin me lule nëpër shi.

Sirenat e trenit binin si kambana
Lajmëronin vdekje të rënda,
Vagonët mbingarkoheshin
me njerëz fatesh të ndara .
Në mes tyre
S'mund të udhëtoj më kah vetja,
As di a mund të kthehem sërish
Në shtëpinë time të vjetër.

Lamtumirë atdheu im i bukur
T'i lë peng varret e prindërve e fëmijëve,
Paçin fat t'i shpëtojnë luftës !

LULËZIM JAKUP JASHARI

Veshur malet me petkun e burrnisë ndër mote,
Plumba, gëzhoja, zjarr, gurë e borë rëndojnë mbi supe.
Mijëra vjet kështu trojet tona të lashta
Veshur me petkat e përjetshme - armë lufte.

Veshur lisnajë e Kosovës me plisa të rinj
Si Lulëzim Jashari që syrin ia plas shkaut.
Do të mbijë një mijë vjet ky lis e refren baladash
T'i prijë nëpër udhë mikut e vëllait.

Shtruar rrugët me gjurmët e shekujve
Kullë e Jasharëve çelur do të mbesë
Me gjurmët e burrave nëpër mote
Kjo udhë me udhëtarët e lirisë.

Veshur sytë e nënës me mallin e pritjes
Më i vogli i shtëpisë të vinte i pari,
Ndoshta më i bukur dukej udhëtimi nëpër male
Në pranverë më i blertë vjen lastari.

Veshur sytë e motrës me ëndrrën e qeshur
Nëpër udhët e Batllavës të duket i bukuri vëlla,
Do të presë një mijë vjet të kthehet Ai,
Dhëndër lirie në dasmë.

Në kuvend burrash Kosove matet trimëria
Nuk hesht dyfeku e as ëndrra djaloshare ,
Në Shalë të Bajgorës, Qafë e Kaçanollit,
Deri te Tabet e Llapashticës ku ra.

A thua s'e di nënëmira që ai ka ardhur në Batllavë
Dhe motra s'u beson syve që vëllanë para syve ka,
Në gjithë pranverat e Kosovës Lulëzim Jashari
Fytyrën e vet djaloshare la…

AI U BË DIELL
Adem Jasharit

Ai zbriti me lirinë
Te varret e Krushqve
Një plagë e një dhembje
Folën me valët e lumit

Ai kishte bërë betimin
E thërriste kushtrimin

Atdheut I tha
Merre jetën time
Liria i duhet Kosovës

I heshtur rrinte mbi çati
Derisa zjarri i vlonte në gji

Me një këngë kreshnike në odë
Matej koha mes dy zjarreve
Një plagë e një dhembje
Folën me qiellin
Ai u bë diell
Derisa të jetë dielli...

MIKU NË MES NESH
Agim Ramadanit

Edhe ata ecën, ecën, ecën
Po ku veni o burra
Burrat kanë vdekur pas shtatë konaqesh

Hëm, sa çudi
Në këtë përmotshmëri si sillet fati

Vallë ka ende kuaj të zinj
Për t'na e shirë lamën
Ose të vritemi që të dy

Medet më the
Merre këtë zemër dhe falja dheut
Derisa është i etur për liri

Mos harroni
Njeriu lind një herë
E një mijë herë mund të vdesë për atDhe
Megjithatë nuk mjafton edhe kjo

Shikoni burra diç në sy fëmije
Si sytë u lodrojnë në liri

Ore burrat kanë vdekur
Dhe tani druri i fatit lulëzon
Mbi varre njomëzake

Asgjë nuk më mbeti
Veç të thërras edhe njëherë
Agim
Ooo, Agim
Dëgjon trimi ynë

Përderisa njeriu një herë lind
Nuk është pak të vdiset një mijë herë
Për atDhe

Shiko, Agim
Fëmijët vallëzojnë
E në mesin e tyre ndrit Ti

VITALI
Adem Jasharit

Ti sikur s`më njeh
Unë jam Ti,
Ky është portreti Yt
Punuar me ngjyra Atdheu.

Mos u frikëso
Që dukesh i thyer në pasqyrë.

Ti ke ecur nëpër shekuj
Mbi Tokën e Djegur,
Erdhe Guri në rrokullimë
Andaj s`më njeh.

Mos u frikëso nga Plagët e Lirisë
Mbi Dardaninë e thinjur,
Ti ishe VITALI
Komandant i Ushtrisë Ilire.

TOKA E DJEGUR
Atyre që na falën Diellin

Mbi tokën e djegur mbi supe
Koka e gjakosur
Shtrëngon mendjen
Ngul Sinorët e Atdheut.

Me plisat e dheut të kuq
Gatuan bukën e sosur,
Mbi visoret e përgjakura në qiell
Shtron sofrën e djegur
Me lotin e fëmijëve të uritur.

Mbi tokën e djegur
Shqiponjat mbi varre
Lexojnë emrat që heshtin.
Kulla shtrëngon lotin në qepalla
Kafshon dhembjen
Bashkon gurët e vatrës.



Rexhep Elmazi 1938-1978

DRITA NË VATËR

Me buzë si peshku
sikur don të fërshëllejë një melodi
u fryn nëna
krandeve në vatër
për t'i rrokur flaka
për të gatuar...

Ajri puth gacat
nëna rri gërmuqur
gacat bëhen gjak...
flak'ron rrezja!

- Bir pa shih si mori vatra dritë!
lëshova stuhinë e frymës
gacat i bëra gjak
e gjakun rreze.

Kështu vatra fituaka dritë!

ATYRE QË NA FUSIN NË BORXH

1
dora e djathtë e tyre
është guri më i rëndë i dheut
aty buka dhe çiftelia
kanë erën e tyre
prej prakut kur largohesh
dëshiron të kthehesh sa më parë
frymën e tyre dhe peshën
për t'ua ndier

gjëja më e shenjtë e dheut
është fjala porosia e tyre
edhe lulet bëhen të bukura
pse rriten mbi shpinën e tyre të fortë...
nëpër tokë rrashtat i keni
dhe në abetare fytyrën,
vallë mos kështu menduat të rroni
bashkë me tokën
të cilën e deshtët aqë shumë ?

grumbull gurësh
grumbull rrashtash
këto janë shenjat
që emrin ta apin, o vendi im !

2.
gjallërojmë mbi katin më të lartë
mbi retë në fqinjësi me diellin
mbi shpinën kockat dhe sytë tuaj
dhe shpesh harrojmë këngën që kënduat
sakaq dridhet toka nën këmbë
platforma pahitet n'erë
mendja na mirret në këtë lartësi të shkretë
vetëm atëherë ju kujtojmë dhe na bien ndërmend
se jemi duke rrojtur mbi të vdekur e të harruar
mbi ju që çoheni herë - herë dhe dilni
jo si lugat e si fantazmë por si kundërpeshë
me disa shenja pothuaj arkaike
na përkujtoni at këngën në kor të kënduar
dhe sapo t'ja marrim izon kësaj kënge të lashtë
ju zhdukeni në çast sikur mos t'ishit kurrë
na lini duke bërë pyetje
duke fërkuar sytë

vërtet më nuk jeni mes nesh!
por edhe si të vdekur rroni
baraz me ne

ATO QË S'NDAHEN

Njeriu i do rrugët e veta
sepse ato janë kujtimet e tij

Njeriu i do hapat e vet
sepse ata janë forca e tij

Njeriu i do sytë e vet
sepse ata janë qielli i tij

Njeriu i do këngët e veta
sepse ato janë vatra e tij

Njeriu i do fushat e veta
sepse ato janë buka e tij

Njeriu e do djepin e vet
sepse ai është vendlindja e tij

Shumë dashuri bëjnë një të madhe
me mua me ty me tjetrin

SHQIPE ISHE, SHQIPE JE
Fazli Greiçevcit, Medalja e Artë e Shqiponjës

Shkunden malet, thërret Drenica
Flamurasi u vesh me të bardha,
Vjen një zë, o nga Prishtina
Krejt Kosova i doli para:

Uroi zëshëm tërë Drenica,
Hero Kosove, mësues Fazlia!

Thërret Kosova, thërret Shqipëria
Gjithandej le të shkojë nami,
Lum Atdheu, lum Drenica
Për kësi trimi, për kësi djali!

Ballë për ballë Kosovë – Shqipëri,
Shqipe e Artë, mësuesi Fazli!

Shqipe ishe, Shqipe je
Lart mbi qiellin e Atdheut,
Shqipe e Artë përmbi re
Përkrenare e Skënderbeut!

Gjithë uron e tërë Drenica,
Shqipe e Artë, poet Fazlia!

Shqipe e Artë mbi Flamur
Shkup e Shkodër, Çamëri,
Ishe e je Shqipe, o burrë
Djep Drenice, shpirt Shqipëri!

Gjak Kosove – Atdhe Shqipëri,
Shqipe e Artë, mësuesi Fazli!

Fli i qetë Hero i Kosovës
Simbol shqipe mbi flamur,
As Kosova, as Shqipëria
Nga zemra s'të heqin kurrë!

KUSHTRIM I ADEM JASHARIT

Lartëso ballin
Shtrëngo pushkën
Merr me vete
Zjarrin, bukën...

Shpejto burrë
Me besa-besë
Për Shqipëri
Në daç me vdekë!

(Kush s'të bashkon
Kosovë, Ty Nënë,
Tokë për varr
Mos me i dhënë!)

Atdhe i të parëve
Fole Shqipesh,
Nder e djep
Pushkë kreshnikësh.

Një Shqipëri
Me toskë e gegë,
Trung ilir
Me shumë degë.

(Kush nuk vdes
Për Ty, moj Nënë,
Tokë për varr
Mos me i dhënë!)

Lartëso ballin
Trim me fletë,
Për Bashkim
Eja me vdekë!

Në shtëpi të vet
Shqiptari i huaj,
Këtu Zot e fe
Janë bërë rrëmujë.

(Kush s'të do
Shqipëri Ty krejt,
As s'do fëmijët
Prindërit e vet!)

Përpara trima
Një gjak jemi,
Një Shqipëri
Atdhe kemi!

Vëllezër të Arbrit
Gjithë sa jemi,
Shqipëri kishim
Shqipëri kemi.

(Kush të bën hile
Shqipëri, o Nënë,
Helm prej gjarpri
Në ballë m'i dhënë!)

Nder kombi
Udhë Bashkimi,
Në grykë të pushkës
Matet trimi.

Nxito burrë
Me besa-besë,
Për Shqipëri
Të bashkuar përjetë!

(Kush nuk vdes
Për Ty, moj Nënë,
Turpi i botës
Ka me zënë!)

Kush tek ti, Shqipëri
Godet pas shpine,
Është tradhtar
Soj prej shkine.

Bashkim-bashkim
U shenjtërove:
S'ka Shqipëri
Pa djep Kosove!

Riza Lahi 1950-2013

BASHKËBISEDIM I TENDOSUR
Luftëtarit Nazmi Ukëzmajli

- Sa s'e ke parë djalin, o mixhë?
- Ka vite pa e parë... Ka vite e muaj...
- A të ka nisë para djali, o mixhë?
- Çdo muaj, por jo-jo këta dy-tre muaj!

-Yt bir këtë radhë s'të nisi para
Se bleu fishekë, se bleu granata...
- Po, mirë, mirë ka bërë Nazmiu, or bir
Liria nuk vjen pa fishekë e pa granata!

- Po... djali im është në Gjermani.
- Jo, djali yt ka ardhur në Kosovë.
- Pse s'erdh më parë të shihte t' ëmën?
- Se deshi të shtinte më parë për Kosovën!

- E, pra, vini mend këtij rafali që shtie,
Mbaje veten, bacë Xhemshir Ukëzmajli...
- Ju jep baca zemër... Ju mbajeni veten
Se jam baba i dëshmorit Nazmi Ukëzmajli!

TRIMAT NË LLAUSHË

Mbushur Llausha me të blertën
E pikëlluar në pranverë,
Njëzet mijë burra mësuesin
Përshëndesin edhe një herë.

Lamtumirë, o Halit Geci,
Prin Drenica luftëtare,
Njëzet mijë burra për ty
Të qoftë e lehtë toka shqiptare!

Dikush shtrëngon grushtet fort
Dikush lot po nxjerr nga pak
Dikush mërmërin:
"Halit, s'më del shpirti pa marrë hak!"

Po…nga mbinë këto tri maska,
Mos i prunë majat e Sharrit,
A mos amanet i nxori
Kjo lëndinë nga fund i varrit?

Fshehur si miu mes turmës
Sytë shqyen katërsh UDB-ja,
Maskat britën shqip:
"O popull, është krijuar UÇK-ja!"

Kosova, nënë e burrërisë
S'është mësuar faqen me koritë,
Loke, ka ardhur dita ime
Për nder tënd sot pushkë me qitë!

"Burra, lirinë kush s'ta falka
Nuk bëhet dasma pa dash,
S'ka le ai që tremb Kosovën
Ta puthsha grykën, o kallash!"

Mbas tri maskave, tre palë sy
Që shkrepëtijnë, o si baruti,
Mezi i mbajnë maskat këta burra
Muja, Rexha e Dauti.

Një prej nesh të zbulohet
Kuvendojnë trimat për pak
Dhe Dauti i Dukagjinit
Përmbi turmë maskën flak.

Moj Llaushë, kurrë s'je tronditur
Për kaq gaz në ditë t'varrimit,
Përqafojnë dy maskat e tjera
Dautin e Haradinit

"Unë…e njoha atë që foli
Me atë zë që bubullon,
Këngën "Kreshtat e Kosovës"
Veç ai burrë tjetër s'e këndon.

Këngën "Kreshat e Kosovës"
S'e këndon kush me çifteli
Si ai trim me Beqë Gashin
Mujë Krasniqi emri i tij.

Në daç me këngë, në daç me fjalë
Në daç me pushkë, a me sakica,
…Por një ditë ra Mujë Krasniqi
Trim…nga ata që lind Drenica.

KOSOVA TË RROJË

...dhe qielli tymos dhe dheu shkrumbos
Një shpend kobzi vajton mbi Shqipëri.
Kosova u dogj, u bë shkrumb e hi
E loti u tha kur trimi u vra,
Në varr të paditur, i therur, i mbytur.
Dhe motra gërshetin var mbi oxhak,
Shkel mbi duvak e niset merr hak.
E foshnja këlthet tek shpirtin tret
Në ujin e valë që zien në kazan.
O serb dushman, u djegsh në katran
E syri të plastë e gjiri t'u thaftë!
E zë pëlcet dheun jehona e të parit
E zgjohet nga varri e s'vdes kosovari.
Jo s'mund t'i fundosni e t'i syrgjynosni
E gjirin s'e thani se nusja pret djalin,
Ky vend do të këndojë, KOSOVA do të rrojë!
...dhe qielli tymos dhe toka shkrumbos,
Një shkabë krenare gris honin e zi
Simbol i Lirisë për ty SHQIPËRI!

Enkelanë, 1999

MOS GËNJEHET KUSH
TË SILLET RRETH LIRISË

Zjarr digjet qielli mbi Drenicë
Mes këngës së djepeve lindur për liri,
Mes luleve që mbinë nga hiri i shtëpive,
Vaditur me gjak - simbol i historive.

Ngrin sumbull e lotit varreve të nemitura,
Ku heshtin foshnja e plaku, oh sa gjak, sa gjak!
Mos gënjehet kush të sillet rreth Lirisë
Se Adem Jashari ngrihet e merr hak!

Prekaz, gusht 2014

MBULOMË ME FLAMUR

Rrugët e mia janë shtruar më lulëkuqe gjaku,
I veshur dhëndër për Shqipëri sot po vdes te pragu.

Për mëmëdhe po vdes, oj motër, pash nënëloken
Ma mbulo trupin më flamuriin kuqezi në ballë!

Motër, flamurin e Shqipërisë me dorën tënde qëndise
Në kokë mbaje një shami të kuqe dhe vishu shqip.

Sa bukur kur të shoh në këtë veshje shqiptare,
Unë sot po vdes për ty, motër, por ti më gjen në varre.

Po vdes duke kënduar këngën në malet e Shqipërisë
Për tokën e Arbërisë, për tokën e përgjakur të Lirisë.

Sot unë po shkoj, por ju lë një amanet të gjallë
Këtë gjak e këtë varr këtu, o shqiptarë!

Të ruani varret e të parëve që ranë martirë për Shqipëri,
Unë po vdes motër, më mbulo më flamurin kuqezi.

Te varret ka shumë energji për Liri,
Shumë të rënë dëshmorë për Shqipëri.

Rruga ime shtruar me njolla gjaku të trimave,
I veshur dhëndër i Shqipërisë sot po vdes për mëmëdhe.

PSALM PËR TË RËNËT

Yllimtarë
Po ngjitemi me Shegën këtë të diel përshpirtjeje
Në Olimpin e Vendlindjes murgë
Po vijmë me të psalmit uratë
Për mërgimin tuaj në yllnajë

Yllimtarë
Perënditë i lëshuan Olimpin
Vdekjes suaj prej drite
Ngjalljes suaj prej zjarri

Yllimtarë
Fesligeni mbi varre
E dritësimi i psalmit të Shegës
Do t'ju heq hidhërimin
Se dhe ajo rrjedh nga fisi i brinjës së diellit
Se dhe ajo me ushtë shpoi kohën e korbit

Yllimtarë
Unë, Bardi i Vendlindjes
Nga errësirë e varrit jua ndiej drithërimat
Zërin e ëndrrave, psherëtimat
Ju dëgjoj se si dënesni në terr
Se si këndoni mëngjeseve me vesë
Jua njoh erën e dheut dhe të kthjelltët e qiellit
(Se jeni vetë gjithësia e lirisë)
Dhe ju shoh se si kalëroni ditëve të burbujta
Në të kremtet e bardha të Vendlindjes.

SHQIPËRI

Zonja Mëmë e perëndive, Shqipëri
Të mëgjunjem për qumështin e gjirit
Për mëkimin e brezave që nga Ilioni
Për Dardanin që rriti zemrën në dashurinë tënde
Kur stërgjyshja Elektra bënte dritë në qiell
Mbolle në ne ylberin me rrënjë parajsore
Emrin tënd prej shpese huazove nga Zojsi
Pastaj ia bëre blatë Ezmerinës sime
Mëma jonë me hire, Shqipëri
Çove Lekën e Madh të pushtonte botën
E t'i vinte breroren tënde prej dielli
Zdorgje Kleopatrën në përrallën e Nilit
T'u krijonte kohëve Hënën e Dashurisë
Ringjalle Jezusin e varrosur
Në zemrën përvëlimë të Madalenës
Mëma jonë me trille, Shqipëri
Nganjëherë veten hëngre
Nganjëherë të shprishën të egrit mëtues
Qyshdo që të jesh ne të duam
Nga një pranverë në lulen e marsit tjetër
Se ti varrose në pëqi krejt hyjneshat
Për të zënë vetë fronin e Kryezonjës
Dhe njëlloj mbetëm ne, bijtë e tu
Herë Solomonë të urtë si zotat
Herë fëmijë të prapë që vrasim zogjtë
Mëma jonë fatpadalë
Mëma jonë e yllimshme
Shqipëri

ATDHEU

Atdheu është tokë e mbjellë me kafka dashurish
Ku në rrënjë lulesh brezat dhiatën mbëltuan
E nga farë e tyre zgjohen çdo pranverë
Sa të kapërcejë Qerrja e Diellit mbi lëndinë

Atdheu kish lindur Gjergjelezë
Që me bjeshkën e plagëve të Arbrit në shtat
Ruajtën qashtëroren këmishë të Motrës
E nëntë mijë koka ranë në Albulenë
E nëntë përrenj gjaku rrodhën në Prizren

Ky mëmëdhe pati dhe Nora dëlirbora
E Penelopa që thurën Besën në avlëmend
Dhe natë e ditë i mbajtën ndezur Shqipërisë
Të virgjrin zjarr në vatër

Atdheu ka dhe një Kalë Shqipëringrënës
Që netëve pa hënë rrëzon Rozafatin
Mugjeve ky moshtër kullot fushëtirave të Mortit
Dhe në asnjë të premte s'e gjen varrin e vet

Atdheu çdo prill na pastron gjakun
Me rremba ylberesh të Perëndisë së Diellit
Atdheu vizaton feniksin në fanitjen tonë
Dhe në atë ekstazë ringjalljeje dashurinë shumëzon

SAGË PËR DESHMORËT E ÇYÇAVICËS

Ata nuk kanë mundur të lindin
Të gjithë për një ditë
Të bëjnë mrekulli trimërie në mot me stuhi
Dhe mos të rritën t'gjithë në djepa t'shpuar

Ata dukeshin me flatra e befas s'mund të kapeshin
Vetëm kur ka festa e këngë të Gjergjit tek këndonin
Se merrnin fuqi nga orët e mira nga zana të malit

Ata mbase kaluan nëpër çeli të burgut e nuk pranuan
Vdekjen e as të gjitha torturat
Sa vite dergje e sa vite plagë trupi

Ata mbeten heronj përtej ndjesive përtej nirvave
Ata shkuan në përjetësi
Pa e gjuajtur armikun pa e thirrur në emër
Dhe e mbajtën fjalën se një Ditë të Madhe
Kosova do të Kremtoj Lirinë e pritur gjatë

Ata nuk linden të gjithë për një ditë e as nuk ranë
Përtej mjegullnajave të tejmanit, por në Fushë Betejë

Atje ku është fundi i Barbarisë
Në Çyçavicën Dardane

KOMANDANT LLESHI
Fjala e fundit e Ridvan Qazimit

Zotërinj të historisë
zotërinj të Luginës,
unë fjalën e mbajta
gjaku ynë të mos thahet.

Mes heshtjes e pritjes
fjalën armatosëm,
që Pushka e Preshevës
të dëgjohet Europës.

Zotërinj të luftës
zotërinj të historisë,
o do të jemi të lirë,
o lufta jonë s´ndalet.

Miq , vëllëzër , popull
të gjallë dhe të rënë,
unë fjalën e mbajta
Lugina të jetë e lirë!

MOLLA E K U Q E
Trimit popullor Heto Kokaj

1.
Mollë e Kuqe - mollë me gjak
Tri Serbia - ty t´kanë hak,
Mollë e Kuqe - mollë me fletë
Krejt Toplica tharë ka mbetë.

Zogu i shqipes - kah fluturon
Shqipja shqip veten këndon,
Pikë e gjakut, mollë ku ra
Pemë e tokës kund s´është tha.

Bjeshkët tona s´janë veç dushk
Bjeshkët tona janë plot pushkë,
Mollë e Kuqe - mollë me fletë
Trojet tona - keq kanë mbetë.

Heto Kokaj - trim me nam
Zaptuesit serbë kudo i vranë,
Kjo Kosova - s´ është pa trima
Trohat e bukës i bën vetima.

2.
Burgu i Nishit - një Kafkë-kullë
Tokat tona shumë i ka rrudhë,
Besa e burrave dhënë përherë
Më urdhëron të rroj me nder.

Në Kosovë plot janë kullat
Brez pas brezi luftojnë burrat,
Në mesnate - në terr të zi
Molla e Kuqe shfaqet në sy.

Mezi erdha - o trim i madh
Unë jam Molla e tharë, e ndarë,
Heto Kokaj Mollën pvet
Pse kjo hënë veç hyn e s´flet?

(Është hënë burgu, o im vëlla
Shih Serbia s´i na ka nda)

Burgu i Nishit - burg i zi
Vret me pranga trimat si ti,
Burgu i Nishit liri ndëshkon
Vret me pranga Kosovën tonë.

3.
Heto Kokaj në këmbë është çuar
Gurët me gjak i ka mbuluar,
Bjeshkët tona s´janë veç dushk
Bjeshkët tona kanë dhe pushkë.

Motër e gjakut - pse po qan
Plagët e tua i kam n´çdo anë,
Në Kosovë kur lind djalë
Kah Mollë e Kuqe e puthin në ballë.
Mollë e Kuqe - mollë me gjak
Ty Serbia shumë t´ka hak!

Oj Kosovë, Kosovë e luftës
Në luftë kam lindur, në luftë po vdes,
Buzët tokës iu kanë tharë
Pa luftuar dhe gjak pa marrë.
Ah Toplicë... Jeni Pazar,
Plagët tuaja i kam varr!

Burgu i Nishit thërret "pomoq"
Heto Kokaj Nishin dogj,
Heto Kokaj thyen qelinë
Flakë për flakë me xhandarmërinë.
Heto Kokaj dhe Gjelo Guri
Ranë në luftë - të rrojë flamuri!

KULLA E TRIMIT

1.
Ka dalë diell mbi Prekaz
E ka vënë buzën në gaz,
Në Drenicë s´hyhet me sy
Tahir Meha këqyr n´dylbi.

Ushtri e serbit po vjen zi
Vjen me tanke e me ushtri,
Duan lirinë gjallë me lidhë
Po qëndresa udhën s´mbyll.

Tahir Meha një dardaniot
Pushka e tij s´flet veç sot,
Plumbi i tij vret një Dodek
S´jepet kulla për pa vdekë.

Plumb i dytë vret një Milan
Hyri vetë ai qen n´nishan,
Pikë e gjakut ku ka ra
Pemë e tokës kund s´është tha.

2.
Nebih Meha thërret Tahir
Të lumtë dora, o im bir!
Tahir Meha shkreh në ´iç
Ne në luftë s'jemi të ligj.

Dielli shndrit mbi Prekaz
Tahir Meha qesh me gaz,
Babë e bir ngrenë një këngë
Babë e bir vrasin një gjëmë.

Të lumtë zemra, o azgan
Kështu luftohet për vatan
Ndal o serb, o serbomadh
Kthehu prapa nga ke ardhë!

Qysh kur ishte Pellazgjia
Unë jam këtu n´tokat të mia,
Tahir Meha pushkën mbush
Do të ketë zjarr edhe prush!..

ANATOMIA E PRITJES

Më 1878
Patëm dhënë besën
Se kurrë nuk do të lejojmë
Që korbat
Të na grisin ëndrrat.

Më 1912
Atje... afër detit Jon
Patëm thënë
Se... Gjithsesi... një ditë
Do ta qepim
Lëkurën e grisur të ATDHEUT.

Më 1945
Shumëçka u bisedua
Por minjtë e fushës
Na i hëngrën gishtat
Në hapsane pritjesh.

Më 1999
Gjymtyrët në helmeta i shndërruam
Në shpinë vizatuam hartën e atdheut
E në gjoksin e Adem Jasharit
Rrëzëlleu DIELLI i përflakur.

Më 2008
Historia pësoi metamorfozë,
Anatomia e pritjes u shndërrua
Në nuse me Duvak të kuq
Dhe ADN-në e RRËNJËVE

NË ARBËRI KA SHUMË FURTUNË

Në Arbëri këto ditë
Ka pasur shumë furtunë
Dhe ka rënë skorratinë e kuqe.

Në gishtat e Penelopës
Kishte lëshuar shtat pritja,
Pandora hezitonte të hapte kutinë
Tinëzisht...

O Zot,
Kur do të ndalet
Ky shi i kuq
Mbi kulmet e kullave !

FEHMIU DHE XHEVA

Xheva me atë shtat
Bash si Shotë Galica,
Me Fehmi Lladrovcin
I thërriste Qyqavica.

I donte Kosova
Dhe krejt Dardania,
Me ta sot krenohet
E gjithë shqiptaria.

Ata sot shndrisin
Dritë në Përmendore,
Me shtatin e hedhur
Pamje madhështore.

Ju që na treguat
Rrugën e lirisë,
Jeni dy legjenda
Në faqe të historisë.



AMANETI I TRIMIT
Heroit Bekim Berisha

Kurrizit të kërrusur të jetës
Kerkonim burimin e së vërtetës
Aty diku mes nesh dhe fatkobit tonë,
Aty ku ka zënë e dergjet frika
Në shtratarkivolin e durimit.

Po a pyetëm veten ndonjëherë
Derisa rrokët armët ju,
A na ka hije të jetojmë si mumie
As të gjallë as të vdekur,
Me veshët tanë prej elefanti
E me zemrën prej miu,
Ku çdo ditë na ka gërryer zemër e tru thiu.

E strukeshim shpesh ashtu si të shkretë
Pa guxuar as të merrnim frymë
Nga padrejtësitë dhe barbaritë e pushtuesve.

Dhe bartnim, bartnim, bartnim
Ashtu kodër pas bregu,
Arkivolin tonë në krahë
E qefinin në kokë.

Nga frika prej mjegullave gjigante
Mbështetur në asgjë prej drejtësie

Asgjëja këmishë jona e përditshme
Një këmishë plot me zdrale jete
Na pati zënë frymën, na pati ngulfatur.

E ne s'guxonim as të mendonim
Se një ditë patjetër duhet të ikim prej saj
Si prej dreqit.

Dhe, për çudi, unë ende i thosha vetes njeri
Edhe atëherë kur ashtu nuk mund të isha,
Ish diçka që të gjithë neve na vriste vazhdimisht.

Por më në fund ju dëshmorët e Atdheut
Na mësuat rrugën,
Që frikën tonë ta mbyllnim në arkivole
Dhe ta dërgonim në varreza
Para se të shkojmë edhe vetë përgjithmonë.

POETIT JUSUF GËRVALLA

Nëpër vrimë të gjilpërës përbirohej poeti
Merrte strisho nga Zotat e fluturonte në Olimp
Dhe kthehej në vendlindje pa u prishur moti
E binte për të pushuar pas luftës me rrufetë.

Lart ishte Olimpi
Poshtë ishte Humnera,
Poeti në mes
Rrëfente kah është dera.

Lart një jetë njerëzore
Mes një luftë mizore
Poshtë një jetë shtazore
Bashkë me shtojzovalle.

Poeti hidhte valle
Tundte e shkundte mal e det,
Me buzëqeshje diellore
Brumoste vargun e vet.

Me thinjat e vargjeve të poetit
Edhe sot lyhet e ngjyhet jeta,
Bien e ngrihen teori
Zihen gënjeshtra e të vërteta.

ISHULLI I DHEMBJES

Në barkun e çartur të atdheut
Dergjë e ligë u derdh,
Pikon loti i mallkimit.

Trimat u bënë përmendore,
Po liria u përthye
Në antiteza njerëzore.

Mllefi i mbledhur derdhet
Në mijëra drithërime
Për lirinë e gjymtuar.

Kërkojmë udhë të reja
Pak dritë e urtësi
Për t'i dhënë jetës kuptimësi.

E ishulli i dhembjes pret
Pret dorën e dritës
Për t'i hapur portat.

SHI I VAKËT MBI FYTYRËN E BRONZTË

Provoj të them diçka
Edhe të flas
Edhe të përshëndes,
Bronzi vetëm më shikon
Përtej meje hedh mendimin,
Ku ta zë unë atë
Ta sjell pranë bustit
E t'i them
Ja, mendimi im
Fol!

Sytë e bustit vetëm më shikojnë
Kushedi se çfarë thonë,
S'kam çfarë të bëj
Ja, lotët e mi
Vëri në sytë e tu!

Fytyrën e bustit
E rrihte shi i vakët,
Por mua më përvëlonte...
PA ZEMËRIM...

Mos u zemëro
O dheu i kësaj toke,
Pse shumë herë
Je vendosur e zhvendosur
Mbi varret e njerëzve që vetë i rrite.

Së paku tash gëzohu
Se do eshtra
Po të kthehen në gjirin tënd,
Është herët
Apo shumë vonë...
Edhe kështu është madhështi
Se tani tapitë po të forcohen.

Ti, tokë e gjakut dhe e lotit
Ti, tokë e dhembjes dhe e krenarisë,
Të erdhën
Isë Boletini në Shkodër
Në Isniq e në Mitrovicë,
Sali Gjuka e Bedri Pejani
Në Pejën e Haxhi Zekës,
Hasan Prishtina aty ku duhet
Në Prishtinë.
Të gjithë këta të erdhën në bronz
Edhe të tjerë do të vijnë...

Dhe sot
Eshtrat në tokë
Sikur në këmbë janë ngritur
Shikojnë...
Edhe ata festojnë
Por me frikën dhe etjen
Për përqafimin tonë.

Mos u zemëro
O dheu i kësaj toke,
Sot...
Të gjithë në rrugëtim
Kah Vlora janë,
Me zemër në Pejë e në Prizren
Edhe në Shkup e Preshevë,
Në Janinë e tek Molla e Kuqe,
Edhe në Plavë, Guci e Çamëri.

Se
Janë këta eshtra që nuk harrojnë
Janë eshtra që flasin e nuk mashtrojnë,
Por prehjen e qetë e duan
Mendjen dhe zemrën të bashkuar
Kështu toka do të jetë më e plleshme
E me histori në dorë.

Edhe sot
Sa rrugëtim i dhembshëm!
Por
Mos u zemëro
O dheu i kësaj toke...
Kemi edhe shumë rrugë për të bërë,
Vitet dhe shekujt
Me vete janë duke bartur
Një fener të vjetër drite...

NDEROJMË EPOPENË

Nga Vlora po vijmë
këto ditë behari,
të kujtojmë bashkë
Epopenë Jashari.

Nëntëdhjetë e teta
marsi në të hyrë,
derdhi mbi Jasharajt
predha me zinxhirë.

U ndez flakë Prekazi,
Drenica në flakë,
kulla e Jasharajve,
Flamur e bajrak!

Një luftë e paparë
sa çuditet bota,
po luftojnë Jasharajt
si Azemë e Shota.

Në Kullë të Jasharajve
po rreh zemër Kosove,
një legjendë e rrallë
shkruhet përmbi troje.

Trim Adem Jashari
djalë që s'e bën nëna,
aty derdhet gjaku,
aty buron kënga.

Vijmë nga Labëria
nderojmë epopenë,
gjakun për Lirinë
dhe për Mëmëdhenë!

SHOTA

Ra nje shkëmb nga malet
Dhe në të gdhendem trimërinë tënde,
Me fytyrën e ëmbël dhe të ashpër si të Kosovës,
Me duart mbi dhjetëshe si të Kosovës,
Me dashurinë dhe urrejtjen si të Kosovës,
Me kokën lart si të Kosovës,
Shotë Galica!

1971

UÇK

Frëngjisht – Rambuje,
Shqip – UÇK !
Në këte muzg shekulli
Vjen e më shfaqet si triumf i agimit,
UÇK-ja,
Koburja e Kosovës si e Isë Boletinit!
Frëngjisht – Rambuje,
Shqip – UÇK!

KOSOVA, ZEMRA E TIJ

Aty ku unë piva kafe vjet,
Këtë pranverë ty të vranë.

Mos ishe ti që në klub më servire kafenë,
Ai që përmendsh dinte Kadarenë.
Mos qe poet që më pe thellë në sy
Tek mbrëmja e kaltër na mbulonte aty?

S'e di këtë, po tjetrën e di
Se për lirinë ti fale jetën,
Se kur të vranë e gjoksin ta çanë,
Në vend të zemrës, Kosovën gjetën.

1999

SI KRUSHQIT NE S'U NGRIMË
Baladë e vjetër dhe e re

Kaq vjet me mall në zemër
larg njëri-tjetrit rrimë,
unë pres si Kostandini
ti pret si Doruntinë.

Po ti do vish drejt meje
dhe unë do vij te ti,
ti del nga toka e kuqe
unë dal nga guri i zi.

Dhe do takohen bashkë
të gjallë dhe të vdekur
dhe do fërkojnë sytë:
-“Sa shumë kemi fjetur” !

Kaq vjet larg njëri-tjetrit
si krushqit ne s'u ngrimë,
unë pres si Kostandini
ti pret si Doruntinë.

UDHËTIM PËR NË KOSOVË

Ne bënim rrugë dhe iknim larg,
malet e Sharrit varg e varg.

Më folën shqip, u fola shqip,
zemrat si vela nderur në zgrip.

Dhe shushurinte Drini i Zi:
-Eh , Shqipëri, moj Shqipëri...!

Ne bënim rrugë dhe iknim larg,
fshatrat e Dibrës varg e varg.

Fshatrat e Sharrit varg, kurorë,
një vetëtimë ma bën me dorë.

Dhe shushurinte Drini i Bardhë:
-Ti që po vjen, Mirësekeardhë!

NË PREKAZIN HEROIK

Në Prekazin heroik
Dhembja të ligështon
Krenaria të forcon, or mik.
Sa ju kam lakmi
Rënien në altar
Heronjtë e mi
Të hedhur në Pavdekësi.
Ku ka vdekje më të mirë
Se të flijohesh vetë
Që të tjerët të jenë të lirë,
Jua kthefshim më të mirë
Or mik!

Nata e zjarreve

GJAKU GJAKUT I PËRGJIGJET
Dëshmorit Indrit Cara

Zog i qiejve Indrit
Ag Lirie në Kosovë,
Liria të thërriste Ty
Rrugët të bëheshin dritë.

Atdheu thërriste fëmijët e vet
T' ia mësonin fluturimin qiellit,
Tokë e ashpër, luftë e gjak
Shqipet fluturuan lart.

Liri e Kosovës ia thërriste gjakun
Kujtime fëmijërie rrugëve të Kavajës,
Në kufi diell Indriti
Fushë e male ndriti.

Majë Gallushës në Pagarushë
Më 26 prill '99
Nata u ça në mes
Indriti ia fali buzëqeshjen.

Ah amaneti i betimit
Sa hije i kishte trimit!
Gjaku gjakut i përgjigjet
Në Kosovë çelën lulëkuqet.

KURORË PËRJETËSIE
Dëshmores Hyrë Emini

Ç' brengë ta trazonte shpirtin
Udhëkryqeve të Atdheut?
Ç' tmerre të panë sytë
Kur shkelje sinorët e mallkuar?
Ç'dashuri ta ndriste shpirtin
Nëpër rrugën e Lirisë,
Me hapin e drenushës ?
Ç' peshë kishte fjala
Ç' burrëri arma , motër!
Hyre ëndrrave të fëmijëve
Me melodinë e këngës
Dashurinë e gjuhës.
Vesë e mëngjesit
Lot lirie në sy
Dielli që po lindte.
Fresku i Jezercit
Dhe erë e barotit
Neredimja, Presheva, Tetova...
Në Gostivar vure kurorë
Në vellon e përjetësisë
Me krushqit e lirisë.

FLAMUR LIRIE

Tahir Gashanit

Si vigan bregut ngjitej
kodrës, fshatit gur mbi gur,
Liri thërret Tahir Gashani
çlirimtar zemër flamur.

Një tufë drite në bebëza syri
shkrep në heshtje e merr fushën,
për t'ia hequr atdheut natën
kurrë nga dora s'e lëshon pushkën.

Tokën tash ngroh një diell tjetër
ledhaton prajshëm puhia,
përmendoreve nëpër sheshe
madhështinë ua shton Liria.

Përmendorja e 13 dëshmorëve në lagjen Gashani të Qëndresës, Drenicë

NËNAT PYESNIN TRIMIN

Rrudhej e skuqej natyra
Gjetheve u ndërrohej ngjyra,
Pëlciste nga krismat Këlcyra.

Fortesa mes qiellit e tokës
Përzihej me flakë e barot,
Tri ditë ndeshur me barbarët
Lufta s'pushonte dot.

Trimat ku mbetën - pyesnin nënat
-Matanë Kalasë së Fushë - Mollës
Kanë zënë pritat petritat
Djalëria krenare e Kosovës.

Mes nesh Fehmiu e Xheva
Shqipe të Shqiperisë,
Kalasë po ia hapin portat
Ndriçon rruga e Lirisë.

Ademi e Hamza a erdhën
Të parët e UÇK-së,
-Shpejtojnë rrafshit të Vojsës
T'i ndihmojnë Ilaz Kodrës.

Për trimëreshën Antigonë e Hakiun
Sa plumba shkrepët rrebesh
Si u hodh mbi shkaun Sejdiu
Ajeti fytafyt si u ndesh?

Dhe toka digjej në zjarre
Dhe hiri ngjethej në varre,
Me treqind martirë e dëshmorë
Fortesa vuri kurorë!

KOKËN LART
Dëshmorit Ismet Prokshi

Atje poshtë Kalasë
Me trupin zvarrë,
Si vigan vërsuleshe
Mbi armikun gjakatar.

Kokën lart mbaje
Edhe kur të lidhën me zinxhirë,
Ideali të jepte zemër
Dashuri e kësaj toke.

Çerçiz i moteve ishe
Në udhën e lirisë,
Shqiponjë e qiellit arbëror
Ante i Dardanisë.

KITARA E LIRISË
Jusuf e Bardhosh Gërvallës

Gurgullimë e Lumbardhit
Kalon zhurmshëm nëpër Dubovik,
Kërkon frymën e këngës me kitarë
Duke pëshpëritur një lutje të moçme.

Kanjushat e verdha s'ndalën
Fluturojnë mbi Dukagjin,
Në Dubovik marrin mallin
Me zjarrin që djeg përbrenda.

Janari i acartë me borë të përgjakur
Në një skaj të Shtutgardit
Nuk mund t`i ngrijë telat e këputur,
Ata bien e zgjohen kumbushëm
Me këngën e Lirisë në kitarë.

KRUSHK I LIRISË
Fahri Fazliut

Zgjohesh me rrezet e para
Mbi pllakën e mermertë,
Përgëzon trojet e Arbrit
Në amshimin e gjatë.

Nëpër logun e eshtrave
Kosova lule e gjakut,
Si një kandil i ndezur
Ndrit në sytë e zgjuar.

Ti krushk i këngës së gjatë
Vjen me erërat e lirisë,
Pëllumbat lozin vallen
Qiellit të etur për ty .

Zgjohu nëpër klithjet e stinëve
Ta dëgjosh emrin në prillin e kuq,
Puthe Kosovën dhëmballëve të Arbrit
Flamuri i lirisë ka emrin tënd.

PËRTEJ VDEKJES

Kosova ime
Unë pashë
si digjej fjala,
zjarret të ngrinin në horizont
si diej të ftohtë akulli.
Zërat e akullt ecnin në rrugë
Statujat e munguara
midis njerëzve statuja.
Bota
Lexonte heshtjen
me zë të lartë…
me buzëqeshjen ndër duar.
Kosova
me varret më të bukur se shtëpitë
mërmerit ngadalë..
Ju të vdekur të gjallë
për ku nxitoni?
Përtej vdekjes
matanë jetës,
kush mund t'ju presë…?
Nga vini ju të gjallëvdekur
me ecjen e thyer
me fjalën e vrarë,
ju të vdekur të gjallë
mbështjellë me qefinin e heshtjes sonë!

TË PUTH KOSOVA IME

E dua Kosovën
E dua
dhimbjen e saj prej guri
E dua
dritën prej ënderrash
ndërsa buron
mbi shpresën tonë të përgjakur...
Kosovë,
ti dashuria dhe dhimbja ime
prej ajri, drite dhe qiejsh,
hedhur mbi supet e mi
si balada zjarri .
Kosovë
ti dashuria
dhimbja ime prej shiu
dhe rrufesh përvëluese.
Mbi malet e bardha
si aedë popullore
ku këga mbetet lart
si një aureolë dielli.
Të puth Kosova ime
Ti zemra ime
Dashuria ime
Dhimbja ime
Malli im
Mëngjesi,
mesdita
dhe mbrëmja ime e fundit....

BASHKËKOHORE

Vështroj zogun
si digjet i dehur
në këngën e vet
ndër duar,
mbaj rruzujt përvëlues të lotëve…
Kam fjetur
në shtratin e dhimbjes
mbi xhamat e thyer të heshtjes…
KOSOVA për mua
ende mbetet një fjalë e palexuar…
Është ende e palexuar dhimbja fisnike
dhe emrat e martirëve të KOSOVËS.
Të palexuar janë
zërat e fëmijëve në agun e lirisë.
Është ende i palexuar
zjarri i shpirtit të KOSOVËS…

NËNË, M'I RUAJ URATAT
Dëshmorit të kombit Kolë Mirdita

Nënë –
A po m'i ruan uratat
Se Kosova ma ruan Emrin !

Shpirti më rritet në një Kopsht tjetër
Veten e dhashë në Rrasë të Zogut,
Brengë kam vetëm lotin Tënd
Dhe rrudhat e ballit të Babës Ndrecë.

Një Engjëll më ka sjellë kumtin
Disa eshtra më mungojnë në varr,
Por ndihem i plotë përmbi
Kupën e Qiellit.

Me mall në sy për Pragun e Konakut
Pyes: a janë rritur nipërit e mbesat
A janë gjelbëruar shtigjet e fëmijërisë sime,
A i ka ende të freskëta mëngjeset Ranoci im?

Dëgjoj zëra se shokët janë rritur e burrëruar
Disa kanë marrë rrugë mërgimi
E disa vajtojnë lirinë e Kosovës.

Oh, sa do të doja të kthehesha
E të çmallesha një çast me familjen time,
Të shtegtoj lirshëm
Brenda Atdheut tim !

SI SHKOHET NË KOSOVË
baladë

- Ti, kalë i bardhë, Pegasi im,
si shkohet në Kosovë, tregomë!
Malli më ka marrë pa qenë kurrë.

- Përtej varrit të atit tënd
varret e tjerë u rritën dhe u bënë male.
Pas maleve ka varre prapë si retë
nëpër luginë.
Shtegtojnë varret në qiejt e ulët
dhe ta ngatërrojnë udhën.
Avionët kthehen pas të hutuar
nëpër mjegull nate.
Karvanët e veturave janë kthyer në shkëmbinj
si kuajt e krushqve në mallkimin e lashtë.
O Zot! Dardhat dimërore dhe mëllenjat
janë bërë fushë me ofshama
të gjuhës sime!

- Ti, yll blu i fatit mbi ballë të Atdheut,
si shkohet në Kosovë, tregomë!
- Kur të kesh një plagë tjetër të re në trup,
ndiq udhën e rrëkesë së gjakut,
që gjithmonë arrin para meje
dhe më pret atje - gurgullimë jete.

Marr dy pishtarë të shuar dardanë,
i ngjyej në gjakun tim
dhe ndriçoj udhën. Ndizen krahët,
flakët bëhen flatra,
unë bëhem shqiponjë prej dheu
dhe ndiej ciklonet e stepave
si duan të ma brejnë emrin prej guri.

LEGJENDARËT
Dëshmorëve të lirisë

Dua të rend mbi këtë tokë, të vrapoj
kaluar nëpër vite mbi kalin e bardhë
në çdo cep të atdheut tim të dashur të shkoj
me legjendarët të kuvendoj si gjysh i lashtë.

Të mos ndalet kurrë, kurrë troku i kalit tim,
të mos lodhet asnjëherë nga pesha e rrugës
mbi shpatulla të mbajë pa u lodhur historinë,
që legjendarët me gjak shkruan mes luftës.

E di, do t'i gjej legjendarët kudo nëpër atdhe,
në çdo rrugë, shpat mali e nëpër mijëra sheshe,
populli që i lindi i përjetësoi në mermer
me bëmat e tyre thuri këngë të pavdekshme.

FIS I KASTRIOTIT
Shaban Kastratit - Palluzhës

Shtatë kohë njeriu kam masën
Dhe kam mall të takoj njeri,
Prej fisit të Kastriotëve vij
Dhe Fis ma thonë emrin
Fis Kastrioti.

Këtej gjej edhe gjurmë gjaku
Gjurmë hiri e ashti më përfton
Dhe pasthirrma kohësh, epokash.
Këtu gjej shpirtin e Bacë Shabanit
Se ende kalëron me allçin në trok
Deri në log të mejdanit merr vrapin
E ndalet majë pirgut të Lirisë.

Shtatë kohë njeriu kam masën
Vringëllimë shpatash, shkrepje pushke
Dhe kushtrim bacëloku më mban gjallë
I fismë me gjakun dhe plisin epokave
I derës së Kastriotëve më kujtojnë.

Me kushtrimin betejave ballë kuçedrës
Dhe amanetin e Bacë Shabanit
Shtatë kohë njeriu ngritëm Kulla në Arbëri
Dhe i dhamë rrugë lirisë deri në pafundësi.

ADEM JASHARI

Kur nisën themelet e lirisë
Gjithë udhët e tjera kishin marrë fund,
Orakull drite po vinte.

Mes shkreptima pushkësh e deshën
E deshën edhe në logun e burrave
Edhe në kullën e pritës e të dritës
Edhe në natën e skëterrës u duhej
Edhe aty ku jeta matej me vdekjen.

E deshën se i deshi si Lirinë
Po ai ishte vetë liria
Adem Jashari.

PAS YJEVE TË LIRISË
Tahir Sinanit

Tri kohë jetë t'i kishe
Nuk do të mjaftonin
T'ia nxjerrësh vlerën
Rrënjës katrore të dritës,
Për një shpirt në eksil
Nga Molla e Kuqe
Deri në Prevezë e Çamëri.
Çuditërisht në këtë shekull
Të iku pegasi i mallit
Pas yjeve të lirisë.

KURORA THURIN VASHAT
Dëshmorëve të kombit

Më . . . 999 mote rënkimesh
lot gjaku e dhembje e zjarrtë malli,
atje ku me shekuj shqipet ngritën kullat
fluturimin e lirë donin,
qielli të përmbyste barbarët
bajonetat e tyre të përskuqura
Me gjakun e njomë të fëmijëve.
Lotët e nënave, mallkimet e gjysheve
vrer trishtimi derdhën mbi armikun.
Fundi i këtij shekulli çeli ditën e re,
lulëkuqet e freskëta vaditur me gjak.
Kurora dëshmorëve iu thurin me mall
vashat me fytyrë fushe e sy qielli,
atje nga lind e perëndon dielli.

HARTA ILIRE

Në hartat e çara të historisë
shtrihen copërat ilire,
kafshuar nga gjarpërinjtë e gjakut.
Të tmerrshme qenë zgjimet e kombit,
të thyera imazhet e dritës
shkretëtirave të djegura të etjes.
Mos ma zhdukni gjeografinë, o katilë,
as harqet e urave që lidhin miqësi!
Për një fron nga Londra ... Parisi
në konkurset e Europës u tkurr fisi.
Në lot e gjak notoi Kosova
Dibra... Tetova mbetën në lutje
Shqipëria tretej në hijen e vdekjes.
O ju që kuptoni gjuhën time,
ma falni hartën e lashtë të lavdisë,
ku këndonte bukur Iliria!

SYTË E DËSHMORËVE
Vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Kadri Zekës dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për (I)LIRI

Ata nuk ranë therorë
Që ne -
Vetëm t'u këndojmë këngë
E t'i përkujtojmë në festa e ditëlindje…

Kështu –
Të ndjekur
Të përbuzur
Para shqelmit të huaj
Në tokën tonë!

Andaj -
Të gjithë të kemi kujdes
Kudo që të jemi
Në vetmi
Apo së bashku
Në çdo frymëmarrje-lëvizje tonë…

Se - sytë e dëshmorëve na përcjellin
Se - shpirtrat e tyre na vështrojnë ,
Nëse rrugën e tyre s'e vazhdojmë
Na akuzojnë
Na mallkojnë
Na dënojnë…

Ata dhe kjo Tokë - (Z)emërjonë
Lirinë dhe Ribashkimin Kombëtar meritojnë.

Ata nuk ranë
Vetëm sa për të rënë…
Ata amanet të madh na kanë lënë.
E ne
Ç'po bëjmë?
Ç'po veprojmë?
Për Çështjen -
Për Mëmëdhenë…

A kështu çohet në vend amaneti i dëshmorëve?
A kështu fitohet Liria?
A sërish po kthehet kohë e horrave
Apo nga mospuna jonë -
Po shpërblehet armiku, tradhtia!

O VËLLA I DHEMBJES KRENARE
Shokut tim FAGRE

Edhe andërr prore po të shoh
ashtu sikur unë të njoh:
me zemër të pastër e fytyrë engjëllore
Ty o vëlla, që i ngrite vetes përmendore
… dhe bisedojmë plot dashuri e mall
e Ti më thua: "Nuk kam vdekur -
ende jam gjallë!"

Po… Ti gjallë je
dhe rreze krenare ndër rreze ke mbetur;
kujtimi yt në ne,
o vëlla, kurrë s'ka për të tretur!

Prandaj, ne nuk qajmë… Nuk vajtojmë
as farefis… të gjithb jemi krenarë;
edhe zogjtë e malit i lusim të këndojnë
mbi varrin Tënd plot lule-beharë…

Se Ti u bëre flamur QËNDRESE
Bashkë me LULET e para të PRILLIT,
se Ti u bëre RREZE shprese –
simbol i DRITËS së agimit…

O VËLLA i vuajtjes e mjerimit!
O VËLLA i DHEMBJES KRENARE!
O VËLLA i këngës legjendare!
O VËLLA! O VËLLA! O VËLLA!...

Burgu i Nishit, 1965

MOS JE YLBER MBI UJËVARË

Liri, e shtrenjtë sa s'ka
Që kurrë s'po mund të të takoj,
Që kurrë fati s'më ra –
Njëherë të të përqafoj...

Oh, u linda, u rrita, u moshova
Nën robëri... gjithnjë i etur për Ty(!);
Prejse u bëra diç të di me shpirt të gjakova
E lot, e djersë, e gjak... më pikuan (Z)emër e Sy...

Po, po... gjithnjë të k-ë-r-k-o-v-a
Me Shpirt (Z)emër e Sy
Thellë... shumë thellë të përjetova
Dhe ende, medet... s'të pashë Ty...!

Ah, LIRI, LIRI! Më thuaj si je?
Vallë, si dukesh në të parë?
A veç në qiell rri...? A zbret ndonjëherë ndër ne?
Mos je Y-L-B-E-R... mbi U-J-Ë-V-A-RË...?!

... O, vetëm Shpirtrat e Rilindësve...
Dëshmorëve...Dritë për Ty,
Vetëm zemrat e mërgimtarëve... dhembje... lot... mall...
Të përfytyrojnë... të shohin edhe më të bukur se je...
(Z)emër-Shtat-Sy...
Oh, ty Mbretëreshë e bukurive, (I)LIRI, më e bukur

se çdo fantazi...
se çdo andrallë... !

Rochester, NY Amerikë, dhjetor 2004



Lasgush Poradeci 1899-1987

Do të vijë një kohë, kur do të vemë në dasmë e do të urojmë:
Mos e pifshim këtë gotë, po të mos bashkohemi me Kosovën!
Dhe do të vemë në vdekje e do të ngushëllojmë :
Mos e pifshim këtë gotë, në mos u bashkofshim me Kosovën!
Do të vijë një kohë, kur dollia do të fillojë me këto fjalë:
Mos e pifshim këtë gotë, në mos u bashkofshim me Kosovën!...

TË HUMBURIT

Një rrjetë plastike është vendosur vertikalisht në disa mbështetëse delikate e mbi të janë fiksuar shumë fotografi të të zhdukurve në luftën e Kosovës për liri.
Disa prej tyre qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre e disa në muze në qytete e fshatra të Kosovës. Fotografitë janë prej letre e shumë të lehta, aq sa një fllad i lehtë i bën ato të lëvizin. Por dhe hapat e njerëzve që kalojnë aty pranë trondisin këto fotografi. Fotografi burrash, grash, fëmijësh e të rinjsh, shumica të bukur e të qeshur. Bukuria dhe qeshja e tyre s'ka të bëjë me pjesën e tyre estetike. Është ndriçimi i lirisë, ashtu si dielli tek del nga maja e maleve, lëshon rrezet e para të agimit e gjithçka ndriçon, madje qesh. E dielli ndriçon edhe fotografitë e të zhdukurve, por nuk është i zoti t'i gjejë varret e tyre, vendet ku kanë humbur.
Ah ky diell, sa shpresëdhënës, jo vetëm për të zhdukurit! Ata njerëz kohë më parë lëviznin e luftonin midis njerëzve... Por sot ata janë as të vdekur as të gjallë! Janë si ushtarë të panjohur. Fotografitë e tyre tunden dhe nga fluturimi i një zogu të lirë, edhe kur rrezja e madhërishme e diellit përmeson midis pemëve e godinave të larta. Ata njihen nga njerëzit, por nuk gjenden gjurmët e fundit të tyre.
Ç'fat i madh për të humburit e "The losts", telenovelë amerikane e Hollivudit! Të humbur, por shihen çdo ditë nga miliona njerëz në gjithë botën. Është një fiksion artistik, ashtu si në filma...

Liria ka çmimin e saj, por ka dhe çmime që nuk mbeten statike, por lëvizin, e lëvizja vjen prej saktësimit a korrigjimit gradual të numrit të të zhdukurve të Kosovës.
.Regjisori prishtinas Dibran Fylli në librin e tij "Prekazi brezni trimash" jep këtë çmim të lirisë: "Vrasja e 13.000 civilëve, djegia e 1000 vendbanimeve, shkatërrimi i plotë i 104.000 shtëpive, 214.000 shtëpi të shkatërruara e të plaçkitura, mbi 2000 dëshmorë të UÇK-së, dëbimi me dhunë i 1.000.000 qytetarëve etj." Çmimi i të zhdukurve kërkon të jetë me shifra, ndërsa shifra është fluide. Në sallat nga më të ndryshmet konferenca trajtojnë problemin e këtij çmimi. Në kalendarin e festave dhe të përvjetorëve të Kosovës ekziston dhe Dita ndërkombëtare e të zhdukurve, që ka një datë fikse 30 gusht. Fjalime të bukura do të ligjërohen nga burra e gra të veshura po aq bukur. Ndërkohë fotografitë e të zhdukurve tunden vetvetiu, pa asnjë lloj shkaku. Tunden e përkunden si në një gjumë të gjatë, por edhe sikur bisedojnë me veten e me njerëzit e tyre të dashur.
Natyrisht, kjo nuk ndodh vetëm në Ditën ndërkombëtare të tyre, më 30 gusht, por çdo ditë. Ndoshta fotografitë e njërit prej tyre, disave prej tyre, ndoshta të të gjithëve, nuk do të jenë më aty një ditë.
Ndoshta!

Durrës, 2014 **Fatmir Minguli**

KURORË E LIRISË

Këngët për dëshmorët kanë patur e kanë një pasaportë universale. Duke legjendarizuar bëmat e trimave, ata na janë bërë edhe më të afërt, edhe më hyjnorë. Kujtesa që ne kemi e do ta kemi për të rënët është një lloj himni që i bëjmë lirisë së ëndërruar. Antologjitë janë pjesa më e ndritshme e identitetit poetik të një kombi. Në to është fytyra e qëndresës që secili poet kërkon t'ia tregojë botës.

Bota e madhe që, për fat të keq, ende ka luftëra, ka plumba dhe ka varre të pambuluara, duhet të ndiejë edhe vibrimin e shpirtit liridashës të shqiptarit.

Antologjitë për dëshmorët mbeten në radhën e parë të nderimit. Ato i kanë të gjitha në faqet e tyre shkronjore: dhimbjen, dashurinë, kolektivitetin, optimizmin, lavdinë, mesazhin e forcën.

Kur nisa të shoh vargjet e para të zgjedhura për këtë antologji, së pari shpreha mirënjohje për autorin e saj Dibran Fylli. Dibrani është mjeshtër i fjalës artistike. Është regjisor dhe aktor. Është një gjeratore emocionesh, që i shpreh disa herë në sofrën e urtisë së tij. Dibrani nuk fal për atë majë gati hyjnore. Dibran Fylli në këto 15 vitet e fundit ka dërguar te çdo shqiptar dhe në mbarë botën jehonën e veprës së dëshmorëve shqiptarë.

Këtë e ka bërë në dhjetë libra për dëshmorët, ku do të veçonim "Prekazi brezni trimash", në shtatë gjuhë. E ka bërë këtë në 200 fotot e tij origjinale nga ditët e lavdishme të UÇK-së, ku ishte edhe vetë luftëtar me armë në dorë. Ishte plagosur rëndë në Betejën e Llapushnikut më 1998.

Pas lufte qe burgosur katër vjet. E ka bërë atë me 400 orë xhirime unikale, ku ishte vetë operator, vetë regjisor, vetë aktor, vetë intervistues dhe vetë i intervistuar.

Edhe vetë Heminguei i madh do t'ia kishte zili për seriozitetin, aftësinë, sakrificën, pasionin e dashurinë për kombin e tij, pa të cilën asnjë artist nuk mund të marrë lavdinë e merituar.

Dibran Fylli ka bërë filma për dëshmorin Skënder Çeku, për Nebih e Tahir Mehën, Arben Halitin e Avni Zhabotën, Mehedin Morinën, Faruk Elezin e 24 dëshmorët e Jezercit, për Fehmi Ramën e Milaim Krasniqin, Hasan Prishtinën dhe për beteja të mëdha si ajo e Koshares. Me këto vepra kaq dinjitoze ai ka shkuar edhe matanë oqeanit, në Nju-Jork, që t'i tregonte këtij kombi të madh se farë çmimi kishte liria për kombin tonë të vogël, për Kosovën e pamposhtur.

Dibran Fyllit, artist, regjisor e krijues shumëplanësh, me ndjeshmëri e ide të reja, do t'ia kishte zili çdo vend i Europës.

Tani kur të gjithë jemi bërë robër të paqes , asnjëherë nuk është e tepërt të gdhendim kujtesën për të rënët tanë.

Më intrigoi një majë e lirikës amerikane të shekullit XVIII, Uollt Uitmani, që ishte e mbeti një poet bleror, poet i Pranverës dhe i Lirisë. Natyrisht, ai kishte shkruar edhe për të rënët e kombit të vet. Në kryeveprën e tij me një emër simbolik, që të kujton edhe përjetësinë e dëshmorëve me idealin e tyre, ka një poezi kur ai një tufë lule, në vend ta dërgonte mbi një varr dëshmori, ia jep me bujari një këngëtari, një poeti, meqë ata kishin ngritur në art luftën e sakrificën e atyre që rizgjojnë heroizmin.

Poetët e gjithë kohëve duhen nderuar për këtë mision, që ata i kanë dhënë poezisë së tyre. Historia e lashtë e shqiptarëve është në të njëjtën kohë edhe histori e të rënëve.

Liria ka qenë përherë sfidë e jetës, e mbijetesës, shumë më e fortë se varfëria, se shkronja e munguar. Nuk është rastësi që mermeri i maleve tona, graniti dhe balta të jenë bërë buste, lapidarë e monumente për të rënët.

Madje edhe populli, kur ende nuk kishte mësuar asnjë shkronjë, bënte këngë për trimat. Nuk mund të jetonte as lahuta pa trimat e të rënët. As çiftelia, as vallet e trimave nuk mund të jetonin kaq gjatë pa trimërinë e tyre. Edhe lahutën do ta ketë krijuar shpirti liridashës i popullit tim.

Nuk mund të kishte kreshnikë pa lirinë e munguar dhe pa tingullin monumental të lahutës, të çiftelisë e të lodrës, as të atij fyelli magjik, që ishte porta e parë e simfonive të rralla në botë. Ata ishin tingujt e parë, pas të cilëve drithëronin sa e sa shpirtra lirikë dhe epikë.

Nuk mund të kishte Zana pa Shota, kaq të shumta në tokën tonë pas sa e sa shekujsh. E nuk kishte rëndësi se ku binin, se ku kishin varrin, në kishin rënë në këmbë apo në prag të shtëpisë. Toka ime krijonte Homerët e saj, duke shoqëruar jehonën e heroizmit të trimave me ëmbëlsinë e ninullës, me urimin mbi rrathët e djepeve, që ata fëmijë të së ardhmes t'u ngjanin trimave të rënë dhe me toponimet e reja që u krijuan si kujtesë më e saktë e trimërisë së tyre.
Poezitë e kësaj antologjie kanë të përbashkët Mirënjohjen e të gjithëve. Shiheni gjeografinë e saj të autorëve, janë nga të gjitha trojet tona. Janë të të gjithë brezave, poetë e poete. Ata kanë tharmin e heroizmit, dashurinë e gjithë kohëve.

Një komb që vlerëson poetikisht të rënët, ka vlerësuar shumë më mirë vetveten. E në këtë Europën tonë, ku flitet përherë për pacifizëm, të mos harrojmë se edhe ajo u ka thurur kurorën më të artë dëshmorëve të saj kudo që kanë rënë.

Ne kemi nderin të themi me zë të lartë se trimat e trimëreshat tona në Kosovë, në Shqipëri e në trojet iliride nuk kanë rënë për të pushtuar një vend a një komb tjetër, por në tokën e tyre. Europa duhet të na respektojë edhe më shumë për këtë fisnikëri që kemi patur dhe kemi.

Dëshmorët tanë, ashtu si të gjithë botës, pa dyshim kanë vetëm ditëlindje. Këtë e thonë edhe vargjet më të zgjedhura të poetëve tanë.

Tiranë, 2014 **Namik Selmani**, shkrimtar

MONUMENTI POETIK I ATDHEUT

Zbuloja së mirës vlerën!
Ndero gjakun e shenjtë!
Ngreje një kupë lirie!
Pija jetës dashurinë!
Matu me madhështinë e maleve!
Bëhu rojë e atdheut!

Kjo është porta nëpër të cilën hyri në gjeografinë e atdheut autori i antologjisë "Lulëkuqet e lirisë" Çdo shesh, një përmendore, Dibran Fylli.

Derisa Plaku i urtë në pikëditë, me një qiri të ndezur, kërkonte Njeriun, autori regjisor, poet, dramaturg, skenarist e luftëtar Dibran Fylli hapi portën e gjeografisë së atdheut dhe thirri muzat arbërore për të kënduar këngën e lirisë, të krenarisë e nderimit për dëshmorët.

Poetët bashkuan penat, frymëzimet, vargjet e rimat për të krijuar simfoninë e lirisë, një gjirmë plot prushimë dashurie e nderimi për flijimin e dëshmorëve të kombit.

Të bësh një antologji poetike të historisë e gjeografisë së atdheut, s'është edhe aq punë e lehtë. Ajo bashkon tokën me qiellin, dritën me diellin, fushën me bjeshkën, kroin me lumin, lumenjtë me detin, fjalët me këngët, dhimbjen me dashurinë, gjakun me shenjtërinë, nderimin me lavdinë...

Antologjia "Lulëkuqet e lirisë", Çdo shesh, një përmendore është një himn i lirisë, që vjen nga parzma e gjithë atdheut, ku secila gjymtyrë e tij është një monument

Amaneti i dëshmorëve të lirisë

Autori i kësaj antologjie sikur synon një cak të dritës, një përjetësim hyjnor të dëshmorëve të kombit: Në secilin shesh, në secilën këngë, në secilën zemër - një përmendore!

Pra një përmendore për secilën krismë të lirisë dhe të atdhedashurisë, nga një monument në secilin shesh të gjeografisë së atdheut, si një kushtrim e amanet i të parëve tanë.

Të bashkuar me këngën e dhimbjes krenare, të lavdisë e krenarisë kombëtare.

Nuk mund të ketë nderim e shpërblim më të çmuar sesa t'i ngresh përmendore gjakut të derdhur, pushkës çlirimtare, idealit e rënies biblike të dëshmorëve të kombit. Kjo vepër e shenjtë u kurorëzua në UÇK-në historike.

Autori Dibran Fylli synoi të ngrejë piramidën poetike të madhështisë së historisë sonë kombëtare, si dëshmi e sakrificës e atdhedashurisë. Ai ka stolisur monumentin e lirisë me poezitë nga gjithë gjeografia kombëtare.

Mesazhi poetik i antologjisë është hyjnor: të vdesësh për atdhe, është lavdi!

I kërkova jetës liri, ajo ma dha pushkën

Thuhet se guximi është fillim i çdo zbulimi.
Të guxosh, do të thotë të veprosh e të krijosh diçka të re.
Të kesh guxim, do të thotë të ecësh përpara, shtigjeve nga ia ke mësyrë, në cakun e idealit.
Të kesh guxim, do të thotë ta mundësh frikën, e kjo është burrëri.
Të marrësh guximin e krijuesit për të hartuar një antologji poetike, duke bashkuar historinë e gjeografinë etnike në vargjet e mbi 120 poetëve cep më cep atdheut, kjo është sikur të bashkosh këngën me gjakun e pushkën, me lirinë, lavdinë e krenarinë kombëtare, duke ngritur në çdo shesh nga një përmendore të kujtimit, nderimit e amanetit të dëshmorëve.
Sot Kosova është e lirë, në epokën e re, ku shumë sheshe të fushëbetejave kërkojnë përmendore të lirisë. Sepse, po u harruan dëshmorët e familjet e tyre, e shkelim të djeshmen, e kafshojmë të sotmen dhe e mallkojmë të nesërmen!

Po e deshe jetën, dashuroje!

Duke lexuar qindra e mijëra vargje të mbi 120 poetëve në këtë antologji nga e gjithë gjeografia etnike shqiptare, përjeton ndjesitë poetike për nderimin e admirimin e dëshmorëve të lirisë dhe lavdinë e krenarinë për ta. Aty kumbon amaneti i tyre, me mesazhin e qartë: të çmosh e mbrosh lirinë dhe të luftosh skllavërinë me guxim e sakrifica, është trimëri e lavdi e përjetshme.

Aty sikur kumbon edhe urtia:
Tjetër është ta duash lirinë e tjetër ta derdhësh gjakun për të.
Tjetër është t'i besosh Zotit e tjetër të veprosh sipas bekimit të tij.

Thirrja e kësaj antologjie për dëshmorët është thirrje e vetëdijes dhe e moralit tonë kombëtar për vlerat e Luftës çlirimtare dhe dëshmorët e saj.
Në antologjinë "Lulëkuqet e lirisë" - Çdo shesh, një përmendore" sikur shkruan epigrami:

Po deshe ta çlirosh atdheun, guxo!
Po deshe të bëhesh hero, lufto!
Po deshe lirinë, sakrifiko!
Po deshe ardhmërinë, krijo!
Po deshe jetën, dashuroje!
Po deshe atdheun, nderoje!
Po deshe njeriun, çmoje!

Kur të ndodhë një ditë gjithë kjo, në të gjitha sheshet e atdheut tonë do të farfurijë mrekullia me kurorën e lavdisë dhe të krenarisë kombëtare.

Drenicë, janar 2014 **Riza Greiçevci**, shkrimtar

DIBRAN FYLLI



Dibran Fylli lindi më 29.9.1956 në fshatin Açarevë të Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Mitrovicë. Para diplomimit në Shkollën e lartë teknike, për shkak të rrethanave të kohës, detyrohet të largohet nga Kosova dhe të vendoset në qytetin e Lubjanës. Atje regjistrohet dhe diplomon në Akademinë për Teatër, Radio, Film dhe Televizion (AGRFT), drejtimi i regjisë.

Në Kosovë kthehet më 1993 për t'i vazhduar aktivitetet e tij dhe për t'iu bashkuar radhëve të para të UÇK-së.

Është pjesëmarrës i shumë betejave, por Beteja e Grykës së Llapushnikut për të është më e veçanta, ku edhe plagoset.

Gjatë luftës ka botuar veprat: "*Argumente-Drenica dikur dhe sot*", Tiranë, 1998 dhe "*Të fala nga Stambolli*", poezi, Tiranë, 1998.

Dibran Fylli është themelues i Trupës Artistike Ushtarake (TAU) "Hamëz Jashari" të UÇK-së, i manifestimit "Ai është gjallë" (tash "Epopeja e UÇK-së", 5, 6 e 7 mars, e njohur si "Nata e zjarreve", i Festivalit Folklorik "I këndojmë lirisë" në Klinë, më 6-8 qershor) dhe i shumë aktiviteteve të tjera kulturore.

Dibran Fylli ka botuar këto vepra letrare:

"*Ai është gjallë*", poezi, Prishtinë, 2000,
"*Sharkia e Drenicës*", 2005,
"*Edhe kjo është pjesë e jetës*", roman, 2005,
"*Ditari i Tafrruk Tafrrukucit të Tafrrukajve*", komedi-humor, 2006,
"*1365 ditët e jolirisë*", poezi, 2011,
"Prekazi brezni trimash", kronologji në shtatë gjuhë, 2012,
"Hasan Prishtina-stërnip i Abdullah Veliqit", monografi, 2013,
"*Tahir Meha - 5 breza pushke lirie*", kronologji shqip e anglisht, 2014.

Antologjia poetike "Lulëkuqet e lirisë" - *Çdo shesh, një përmendore*, për lirinë dhe dëshmorët e kombit është vepra e tij e njëmbëdhjetë.

Dibran Fylli është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Autori jeton dhe vepron në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

Abdullah KONUSHEVCI

Kur vritet biri i madh.....7
Dhe ikim, ikim, ikim.....8
Skicë për elegji.....9

Abdullah TROSHUPA

Vajzë a djalë s'ka rëndësi.....10

Abdyl KADOLLI

Zjarret e Drenisë.....11
Tahir Sinani.....12
Kapedani i Gallapit.....13

Abit HAZIRAJ

Jehuan kodrat e Llaushës.....14

Adem DEMA

Afishja e katërt e poetit.....15
Afishja e fundit e poetit.....17

Adem ZAPLLUZHA

Një nënë dhe një përmendore.....19
Hapat e mi prej uji.....20

Agim DESKU

Rri me vargje Drenice.....21
Emër lirie.....23

Agim RAMADANI

Diçka e nëmur para bjeshkëve.....24
Kur të kthehem.....25
Në mungesën time.....26
Liria.....26

Agim SHEHU

Baladë lirie e Kosovës.....27

Agim VINCA

Liria.....31
Vdekja e luftëtarit.....32
Grykë e Kaçanikut mbuluar me borë.....33

Agron SHELE

Mes dëshmorëve të kombit.....34
Kosovë, lule gjaku.....35

Ajet SHALA

Amaneti i çlirimtarit.....36

Albina IDRIZI

Ballë për ballë me tokën.....37

Alisa VELAJ

Kitara.....40

Arsim HALILI

Gjemba shekulli.....41
Në mes të kufijve.....42

Asllan QYQALLA

Shtegtim përjetësie.....43

Avni DEHARI

Amaneti i shokëve 44
Dëshmorëve.....45
Shaban Palluzha.....46

Bahri FAZLIU

Para dëshmorit.....47
S'mund të ndahem nga lufta.....48
Të gjallëve.....49

Bedri TAHIRI

Përbetimi.....50

Bedri ZYBERAJ

Baladë bashkëkohore.....52
Epigram për një elegji.....53

Behram HOTI

Identiteti.....54

Bilal XHAFERRI

Kosova.....57

Brahim AVDYLI

Lagjja e trimave.....59
Dëshirë e vetme e luftëtarit të lirisë.....60

Çun LAJÇI

Tringa.....61

Daut GUMENI

Prekaz 1999.....62
Më ndihmoi fati.....63

Delvina KËRLUKU

Në betejë.....64

Dibran FYLLI

Ikonë përjetësie.....65
Çdo shesh, një përmendore.....66

Dilaver GOXHAJ

Indrit Cara.....67
Vullnetarët nga shteti amë.....68
Vajzat e UÇK-së.....69

Dritëro AGOLLI

Tespihet e Idriz Seferit.....70
Fushë-Kosovë.....72
Balada e tre të rënëve.....73

Fatos ARAPI

Atdheu.....74

Fazli GREIÇEVCI

Mos.....75
Kanga e maleve.....76
Malli.....77

Flora BROVINA

Liria.....78
Thirrje Kosovës.....79
Ora e parë.....80

Fehmi BERISHA

Dua të kërcej vallen e Osman Takës.....81

Fetah BAHTIRI

Aromë shqiptarie.....82

Ganimete THAÇI

Isa Boletini.....83

Gëzim AJGERAJ

Sikur të ishte Xhevat Berisha.....84

Hajdin ABAZI

E afrove ditën e largët.....88
Krisma lirie dhe këngë.....89
Kitara në komë.....91

Hajdin MORINA

Fillim i një poezie.....93
Mujë Krasniqi është Një.....94

Haki MORINA

Fehmi e Xhevë Lladrovci.....95

Halil QENDRO

Bacë, u kry!.....96
Varri i Azem Galicës.....97

Halil XANI

Alfabeti i dëshmorëve.....98
Para varrit të Komandantit.....100

Hamdi ALIU

Lulëkuqet.....101

Havzi NELA

Nusja e flamurit.....102

Hydajet HYSENI

Thone është parë Pjetër Bogdani.....104
Udhëtim i Isa Boletinit për në Vlorë.....106

Hyqmet HASKO

Komandant Mjekrra.....107

Ibrahim GANI

Duke ecur nëpër Drenicë.....108
Po vjen Shota.....109

Ibrahim SKËNDERI

Pranë varrit të dëshmorit.....110

Idriz BERISHA

Kumti.....113
Tinguj acari.....114
Lartësitë.....115

Iljaz PROKSHI

Çyçavica.....116

Isak GUTA

Adem Guta.....117

Ilir BALILI

Amaneti i fundit.....118

Ismail KADARE

Kosova.....119
Terrori në Kosovë.....120

Ismet KRASNIQI

Emër krenarie.....122

Ismet TAHIRAJ

Dritë rrëzëllore.....123

Isuf SHALA

Fadil Vata - Afrim Zhitia.....125

Jakup CERAJA

Ushtari i UÇK-së.....126
Kullë.....127

Jusuf GËRVALLA

Fletë testamenti.....128
Lufta dhe arti.....130
Do të kthehem nënë.....131

Jusuf HYKAJ

Himn lirie.....132

Kadrush RADOGOSHI

Prometeu erdhi në Kosovë.....133
Ekspeditë në veprën artistike.....134

Kozeta ZAVALANI

Jetë gdhendur mbi mermer.....135

Kozeta ZYLO

Ashti yt përmendore.....137
Monumenti i lotit.....139

Leonora BUÇINCA

Dialog me Adem Jasharin.....140

Lirim DEDA

Dy krenat e shqiponjës në flamur.....141

Lumo KOLLESHI

Krihen qiejt.....142

Martin ÇUNI

Liri.....143
Acari.....144

Mihal HANXHARI

Elegji për Kosovën.....145

Mahir MORINA

Komandant Coli.....146

Mehmet BISLIMI

Nënë Shqipëri.....147

Migena ARLLATI

Sofër heronjsh.....148

Mikel GOJANI

Te Rrasa e Zogut nën rrashtë.....149

Milazim F. KADRIU

Legjendë ndër brezni.....151

Mirvete KABASHI-LEKU

Flakadan i lirisë.....152

Monika BOTOSHANI

Harun Aliu.....153
Mbi frëngjitë e trimërisë.....154

Muhamed KËRVESHI

Shqiponja.....155
Hasan Prishtina.....156
Mirënjohje dëshmorëve.....157
Lugina e Preshevës.....158

Musa OSMANI

Luftëtarëve të lirisë.....159

Namik SELMANI

Baladë e Princit të Pavarësisë.....160
Tupani i fjalës gërvalliane.....161

Naxhije DOÇI

Prekazi i krenarisë.....163

Ndoc PAPLEKA

Vrasja e poetit.....165

Nebih BUNJAKU

Testament i lotit.....166

Nehat JAHIU

Të kërkonim Komandant.....168

Nehat RAMIZI

Kurorë burrërie....169
Komandant Lleshi....170

Neki LULAJ

Ata që nuk vdesin....171
Nderi i kombit....172

Nexhat REXHA

Shkundullimë....173
Lisi....174

Nexhmi DIBRANI

Zahir Pajaziti....175

Nezir PROKSHI

Ngjitje në histori....176
Baladë për Heroin....177

Nuhi VINCA

Tre lisa....178

Pano TAÇI

Drenusha e plagosur....179
Të vdes i bukur....180

Piro MINGULI

Luftëtari i panjohur....181

Prend BUZHALA

Homazh Jasharisht për pesë marsin....182

Qerim UJKANI

Populli i di të gjitha....184
Ese e vogel për luftën....187

Rabije BYTYÇI

Lamtumirë....189

Rajmonda MALEÇKA

Lulëzim Jakup Jashari....190

Ramadan MEHMETI

Ai u bë diell....192
Miku në mes nesh....193

Remzi LIMANI

Vitali....195
Toka e djegur....196

Rexhep ELMAZI

Drita në vatër....197
Atyre që na fusin në borxh....198
Ato që s'ndahen....200

Riza GREIÇEVCI

Shqipe ishe, Shqipe je....201
Kushtrim i Adem Jasharit....203

Riza LAHI

Bashkëbisedim i tendosur....206
Trimat në Llaushë....207

Rozeta KRESTE

Kosova të rrojë.....209
Mos gënjehet kush të sillet rreth lirisë.....210

Rudi BERISHA

Mbulomë me flamur.....211

Rushit RAMABAJA

Psalm për të rënët.....212
Shqipëri.....213
Atdheu.....214

Rrahim M. SADIKU

Sagë për dëshmorët e Çyçavicës.....215

Rrustem GECI

Komandant Lleshi.....216
Molla e Kuqe.....217
Kulla e trimit.....219

Sabile KEÇMEZI-BASHA

Anatomia e pritjes.....222
Në Arbëri ka shumë furtunë.....223

Sadie ISMAILI

Fehmiu dhe Xheva.....224

Sadik PËRVETICA

Amaneti i trimit.....225
Poetit Jusuf Gërvalla.....227

Safete REXHEPI

Ishulli i dhembjes.....228

Sejdi BERISHA

Shi i vakët mbi fytyrën e bronztë.....229

Sejmen GJOKOLI

Nderojmë Epopenë.....232

Skënder TEMALI

Shota.....233
UÇK.....234
Kosova, zemra e tij.....235

Sulejman MATO

Si krushqit ne s'u ngrimë.....236
Udhëtim për në Kosovë.....237

Shaqir FONIQI

Në Prekazin heroik.....238

Shefqete GOSALCI

Gjaku gjakut i pëegjigjet.....239
Kurorë përjetësie.....240

Sheremet PROKSHI

Flamur lirie.....241
Nënat pyesnin trimin.....242
Kokën lart.....243

Sherife BERISHA-THAÇI

Kitara e lirisë.....244

Shqipe HASANI

Krushk i tokës nënë.....245

Vasil TABAKU

Përtej vdekjes.....246
Të puth Kosova ime.....247
Bashkëkohore.....248

Vilson CULAJ

Nënë, m'i ruaj uratat.....249

Visar ZHITI

Si shkohet në Kosovë 250

Xhavit GASA

Legjendarët.....252

Xheladin MJEKU

Fisi i Kastriotit.....253
Adem Jashari.....254
Pas yjeve të lirisë.....255

Zejnepe ALILI-REXHEPI

Kurora thurin vashat.....256
Harta Ilire.....257

Zeqir GËRVALLA

Sytë e dëshmorëve.....258
O vëlla i dhembjes krenare.....260
Mos je ylber mbi ujëvarë.....261

PASTHËNIE

Fatmir Minguli - Të humburit.....263
Namik Selmani - Kurorë e lirisë.....265
Riza Greiçevci - Monumenti poetik i atdheut.....269
Dibran Fylli.....273

...kur m'i shihni lotët në sy
mos kujtoni se jam ligështuar.
Kur më shihni duke qeshur
mos mendoni se jam gëzuar.
Kur flas me vetveten
mos pandehni se jam çmendur.
Flas me të pavdekshmit,
i dashuruar në vdekjen e tyre...

d.fylli

Dibran Fylli
LULËKUQET E LIRISË
Çdo shesh një përmendore
Antologji poetike

Shtëpia botuese “Meshari”

Formati 21 cm

Tirazhi 500 copë

Shtypi “Lena Grafik”
Prishtinë, 2015

Katalogimi në botim - **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Fylli, Dibran
Lulëkuqet e lirisë : *Çdo shesh, një përmendore/*
Dibran Fylli. – Prishtinë : *Meshari*, 2015. – 290 f. ; 21 cm.

Biografia e autorit f. 273

ISBN 978-9951-8889-0-5

Antologji poetike

LULËKUQET E LIRISË

ÇDO SHESH NJË PËRMENDORE



Botimin e librit e ndihmoi:

ALTRADE
www.altrade-ks.com

Antologjia poetike
"Lulëkuqet e lirisë - Çdo shesh një përmendore",
u përurua nga LSHK, më 8 qershor 2015, në kuadër të Festivalit ndërkombëtar të poezisë "Drini poetik"

Ligjëruan:

Mr. Vilson CULAJ

ANTOLOGJI PËR LULËGJAKET E LIRISË

Dibran Fylli, *,,Lulëkuqet e lirisë – Çdo shesh një përmendore"*- antologji poetike, SHB ,,Meshari *",* Prishtinë, 2015.

Diku në librat e jurisprudencës shkruan: *,, Quod non egzist in actes non est in mondo.*(Çka nuk është e shkruar nuk ekziston në këtë botë). Heronjtë mund të lartësohen përmes kujtesës sonë, ndjesisë, fotografisë, pikturës, skulpturës, duke i përjetësuar në mermer, por edhe në letër.
Këtë linjë artistike ka ndjekur edhe regjisori e shkrimtari ynë Dibran Fylli, i cili përmes librit poetik antologjik "*Lulëkuqet e lirisë"* u ka ofruar lexuesve mbarëshqiptarë një tabloid gjithëpërfshirës për figurat poetike e heroike të popullit tonë ndër shekuj, pa përjashtuar asnjë krahinë, moshë as ide.

Me këtë antologji si një buqetë lulesh artistike përfaqësohet bota poetike dhe heroike e popullit tonë. Librit i paraprin një moto çelës e autorit: ,, *prushin e tingujve të këngës së pavdekshme e ruajtën në bërthamën e shpirtit, ata nuk i prek vaji i nënave as rënkimi i etërve , madhërisht rininë e tyre e mbyllën në shtigjet e lirisë "*.
Më pas hapet sipari i kësaj antologjie me vargjet e Naim Frashërit: ,, *Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emrin shqipëtar "* për të përfunduar me testamentin e lirikut më të madh shqiptar Lasgush Poradeci për bashkimin kombëtar. Në këtë antologji këndojnë të gjallë e të vdekur: poeti hero për heroizmat e heronjve dhe poeti i gjallë për poetin hero të rënë për liri.
Ky komponim i antologjisë është art më vete dhe shumë meritor nga vetë autori i kësaj antologjie, i cili shprehet se ,, *për të rënët për liri, varri nuk është fjala e fundit* ", por përndritje e rilindje në epokën e re të lirisë.
Gjithë ky angazhim krijues i ka marrë autorit dy vjet kohë. Falë edhe penave të arta të krijuesve anembanë arealit shqiptar, ky libër ka arritur nivelin e duhur ideoartistik për t'iu ofruar lexuesit tonë si një lloj literature kulturore kombëtare.
E veçanta e kësaj antologjie të Dibran Fyellit është se poeti përplotëson heroin, ndërsa heroi përplotëson poetin. Këto vargje patriotike të krijuesve tanë formësojnë idealin kombëtar e estetik se mbi gjakun e heronjve shkëlqen lavdia, ndërsa sakrifica është vetë populli. Janë këto dy vlera të përbotshme e fisnike: heroizmi dhe poezia, që krijojnë dinjitetin artistik të këtij botimi.
Autori ka ndjekur linjën alfabetike të përfaqësimi të autorëve në këtë antologji, pavarësisht vlerave dhe moshave të tyre. Këtu janë përfshirë 123 poetë nga mbarë gjeografia shqiptare, ku secili në mënyrën e vet ka kënduar me admirim e nderime për bëmat e flijimet e heronjve dhe dëshmorëve tanë.

Aty janë përfshirë gati të gjitha periudhat historike, me figurat tona kombëtare për të ardhur deri te liria e sotme.
Ky libër i dhimbjes e krenarisë sonë kombëtare është testament i lirisë për brezat e sotëm e të ardhshëm, se liria është e shtrenjtë dhe shenjtë.
Deri në antikitetin e vonë, dijetarët e antropologët mendonin se në gjakun e njeriut gjendej shpirti dhe se kur ai derdhej, shpirti lartësohej në qiell. Edhe sot mund të themi lirisht se gjaku i derdhur për liri i këtyre dëshmorëve është bërë hyjnor dhe shpirt i lirisë së Kosovës.
Është ky edhe mesazh universal se ideali i çdo shqiptari është që një ditë të jetojë me të drejtën e vet historike si komb I bashkuar.
Autori i këtij botimi ka kryer një obligim moral ndaj bashkëluftëtarëve të tij, por ende s'e ka përfunduar misionin artistik me vepra të tjera të frymëzuar nga palca e lirisë.
Kjo antologji poetike është botuar me një qasje shumë serioze, falë edhe kontributit të disa figurave tona letrare.
Ky botim vjen te ne i përgatitur bukur artistikisht e teknikisht dhe funksional estetikisht për receptuesin mbarëshqiptar.

Më në fund, urojmë autorin dhe botuesin për këtë vepër dinjitoze dhe falënderojmë të pranishmit për vëmendjen e tyre.

Prishtinë, 8 qershor 2015

Abdyl KADOLLI

PËRJETËSIMI POETIK I LIRISË

Antologjia poetike *"Lulëkuqet e lirisë- Çdo shesh një përmendore"* e autorit Dibran Fylli është botim i sivjetmë i SHB "Meshari" të Prishtinës.

Është kjo një lirikë atdhedashurie , ku janë përfaqësuar 123 poetë nga Shqipëria etnike dhe diaspora . Antologjia përmban gjithsej 207 poezi të disa brezave letrarë që nga Dritëro Agolli deri te Monika Botoshani etj. Autori ka ndjekur rendin alfabetik të përfaqësimit të poetëve me nga 1-4 poezi.
Në fillim të këtij projekti autori është motivuar për përjetësimin poetik të dëshmorëve të Luftës së fundit çlirimtare, por më pas është zgjeruar me të gjitha ato figura kombëtare që kanë krijuar kurorën e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare.
Antologjia hapet me himnin e Naim Frashërit për Shqipërinë dhe mbyllet me një përbetim të Lasgush Poradecit për bashkimin kombëtar. Ndërmjet këtij prologu e epilogu frymon poezia bashkëkohore për lirinë, dëshmorët, simbolet kombëtare dhe atdheun.

Antologjia është pagëzuar *Lulëkuqet e lirisë*, që simbolizon gjakun e dëshmorëve, flijimet sublime dhe dritën e lirisë së atdheut. Poeti Agron Shele e quan "*Lule gjaku që pikon historinë* ".

Historikisht është dëshmuar se liria i ka rrënjët në gjak, ndërsa ne përjetuam edhe një herë se pa flijime të mëdha nuk ka liri kombëtare e dinjitet njerëzor.

Shumica e poezive në këtë antologji i kushtohen Kosovës, si lulëkuqe e trimërisë dhe vatër e qëndresës kombëtare nën pushtimin e gjatë sllav.

Bilal Xhaferri quan Kosovë gati gjysmën e atdheut të pushtuar:

"Me ndarje dhe nënndarje gjeografike
Me ndarje dhe nënndarje historike."(Kosova)

Në këtë polifoni poetike bashkëtingëllojnë zërat e klasikëve tanë modernë me zërat më të rinj të moshave e gjinive të ndryshme, duke krijuar simfoninë e lirisë dhe hartën e atdheut.

Është kjo poezi e ndjesive lirike:dhembshurisë, trimërisë e krenarisë.

Disa poezi kumbojnë si himne e ode, monolog e dialog me heronjtë, disa si elegji, psalm, baladë e epigram, ndërsa disa si rapsodi popullore .

Kjo antologji është një sagë për vertikalen e historisë sonë të re, martirizimet, Epopenë e UÇK-së dhe fushëbetejat e saj të lavdishme . Ka shumë poezi për Komandantin legjendar e komandantët e tjerë dhe për dëshmorët e rënë në të gjithë cepat e atdheut.

Aty këndohen edhe figurat e Rilindjes kombëtare, martirët e qëndresës dhe lajmëtarët e lirisë. Ato janë këngë betimi, kushtrimi e testamenti të dëshmorëve të lirisë.

Poeti Pano Taçi e karakterizon kështu aktin e dëshmorit:

"*Flak gurin e Sizifit e dal në çetë,*
Të vdes i bukur ."(Të vdes i bukur)

Ndërsa poeti Hajdin Morina e krahason luftëtarin "*Si Dielli, si Liria, si Flamuri*"(Mujë Krasniqi është Një).

Aty gjejmë mitin e atdheut me simbolet e panteonet kombëtare, si altar,djep, kështjellë, krenari, lavdi, urti e shenjtëri.

Aty ndrit ideali i lirisë si muzë frymëzimi, ëndërr, dritë, diell, ylber, sy, lulëkuqe, si mundje e frikës dhe ngadhënjim mbi vdekjen:

Poeti Daut Gumeni këndon:

"*hyjnë vizitorët të shërohen*
Nga frika e vdekjes" (Prekaz 1999)

Liria çmohet e shtrenjtë dhe e shenjtë: lot, djersë, gjak, therori, blatim, baladë, feniks.

Poetja Flora Brovina e përjeton lirinë si fluturim zogu, zgjim mëngjesi, erë gruri, lojë fëmijësh, grua lehonë…

Ndërsa poeti Zeqir Gërvalla e identifikon Lirinë me Ilirinë.

Edhe mesazhi artistik i kësaj antologjie poetike është nderimi i këtij gjaku të shenjtë dhe përjetësimi i veprës sublime në kujtesën kombëtare, si një monument në kurorën e lirisë.

Janë këto këngë të lirisë për idealin që fluturon nga Mollë e Kuqe deri në Çamëri.

E veçanta e kësaj antologjie është se aty këndojnë edhe vetë poetët dëshmorë, që nga Fazli Greiçevci e Rexhep Elmazi deri te Jusuf Gërvalla, Bahri Fazliu, Havzi Nela, Agim Ramadani etj.

Antologjia është e pajisur edhe me pasthënie, me foto e vizatime të shumta.

Ajo është një monument poetik i lirisë dhe testament i idealit të shumë brezave.

Autori Dibran Fylli ka dhënë deri tash edhe shumë sprova letrare e dokumentare, si luftëtar lirie, poet, prozator, aktor, regjisor etj.

Antologjia "*Lulëkuqet e lirisë*" ishte një borxh nderimi i poetëve tanë për lirinë e shtenjtë dhe ajo do të jetë një dhuratë e bukur për bibliotekat tona, për nxënësit e studentët tanë.

Prishtinë, 8 qershor 2015